

Vehbi KADRIU

# Gjuha shqipe



## **Gjuha shqipe 4**

**Botues:** MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË  
SË VERIUT Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

**Autor:** Vehbi KADRIU

**Konceptoi strukturën e tekstit dhe u kujdes për zbërthimin didaktik:**

Rita PETRO  
Natasha PEPIVANI

**Recensentë:**

Ajten HAJDARI QAMILI  
Hatixhe TOPALLI  
Saliqe MIFTARI

**Kryeredaktore:** Natasha PEPIVANI

**Redaktore:** Ervisa PALOKA

**Redaktor profesional:** Refail SULEJMANI

**Lektor:** Medina MEHMETI

**Rregullimi grafi k dhe teknik:** Evgenija PAVLLOVA – ARS STUDIO

**Kopertina:** Eva KUKALESHI

**Ilustruese:** Ledia KOSTANDINI

**Shtypi:** EVROPA 92 - Koçan

**Tirazhi:** 7121 kopje

**Vendi dhe viti i botimit:** Shkup, 2022

Me vendim për miratimin e tekstit mësimor në lëndën Gjuha shqipe për klasën 4 nr. 26-1464/1 të datës 18.10.2022 i miratuar nga Komisioni kombëtar i teksteve mësimore.

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:811.18(075.2)

KADRIU, Vehbi

Gjuha shqipe 4 / Vehbi Kadriu ; [Ilustruese Ledia Kostandini]. - Shkup : Ministria për arsim dhe shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022. - 147 стр. : илустр. ; 28 см

ISBN 978-608-273-144-5

COBISS.MK-ID 58611973


## HYRJE

I/e dashur nxënës/e,

Do takohemi përsëri si miq të vjetër. Tani Ti je më i/e rritur, nuk ke më vështirësi të lexosh, i kupton mirë tekstet që lexon, flet dhe shkruan më mirë dhe më saktë.


Në tekstin "Gjuha shqipe 4", Ti do të hysh edhe më thellë në magjinë e leximit. Do të takosh personazhe të shumta të njohura (nga librat dhe filmat), si dhe personazhe të panjohura, që shumë shpejt do të bëhen edhe ata miqtë e tu të pandarë. Në çdo mësim Ti do të gjesh një çelës magjik, me të cilin mund të hapësh një nga një portat për të hyrë në botën e bukur të gjuhës shqipe. Ti ke shumë e shumë për të mësuar, por çdo pjesë që do të mësosh, do të ta rëndojë Thesin tënd të fjalëve. Nëse do të ushtrohesh mirë, do ta kesh më të lehtë për të shkruar një letër, për të mbajtur ditar, për të përshkruar shokun a shoqen tënde, për të treguar bukur një ngjarje a një film, për të shpjeguar një pikturë apo për të zbuluar magjinë e peizazhit të natyrës.

Si kurdoherë, edhe në këtë libër, ne jemi përpjekur të qëndrojmë afër teje dhe të mos harrojmë se Ti rritesh bashkë me tekstet tona.



## PËRMBAJTJA

Dita e parë e shkollës	8
Pushimet verore	11
Një diskutim në klasë	12
Diskutimi dhe biseda	14
Sinonimet	15
Antonimet	16
Cikli jetësor i bimëve	17
Tri gëzimet	18
Vajza e kopshtarit	20
Ani pianistja	23
Hyrja-zhvillimi-mbyllja	25
Përshkruajmë shokun/shoqen e klasës	26
Rregullorja e klubit “Miqtë e mirë”	28
Një mik i madh: Fjalori	29
Është fat të kesh një shoqe si Fatbardha	31
Letër revistës për fëmijë (letra formale)	32
Letër shoqes (letra personale)	33
Revista për fëmijë – të drejtat dhe përgjegjësitë	34
Gjuha e nënës	35
Poezia në dialekt	37
Dialektet e gjuhës shqipe	39
Gjuha standarde shqipe	40
Kur bie shi	41
Vjeshta	42
Përshkruajmë tingujt dhe ngjyrat e vjeshtës	44






# PËRMBAJTJA



Emrat e përgjithshëm e të përveçëm	45
Gjinia e emrit (mashkullore dhe femërore)	47
Gjinia asnjane	49
Imazhe dhe tinguj	51
Kur të shkosh, lum dreri	52
Pëllumbi i bardhë	53
<b>Thirrjet dhe mesazhet</b>	<b>54</b>
Numri i emrit	55
Ushtrime për gjininë dhe numrin e emrit	57
Agimesha e ngjuar në shtatë shpella	58
Teatri i shkollës: Gjiganti prej akulli	60
Përgatitemi për shfaqje	62
<b>Thirrja-ftesa</b>	<b>64</b>
Mbiemri i nyjshëm dhe i panyjshëm	65
Gjinia dhe numri i mbiemrit	67
Përshtatja e mbiemrit me emri	68
<b>Teatri dhe kinemaja</b>	<b>70</b>
Princeshë Ardita	71
Të dymbëdhjetë muajt e vitit	74
Ndërtimi i përrallave - hyrja dhe mbyllja	77
Përemrat vetorë	79
Folja	80
Si bëhen urimet	82
Zogu dhe djali	83
Një peizazh dimëror – Gjuhë	85

## PËRMBAJTJA

Peizazh. Dantellat e akullit	86
Shkruaj një poezi	87
Kohët e foljes në mënyrën dëftore	88
Folja në kohën e tashme	90
Drejtkrimi i foljeve në kohën e tashme	91
<b>Arinjtë polarë</b>	<b>92</b>
Patatet e ziera	93
Jemi të ndryshëm	95
Ata janë si ne	96
Të ndihmojmë fëmijët në nevojë	97
Pranvera. Qershizat	98
Jam mik i zogjve	99
Përshkruajmë pranverën	100
Çdo mëngjes përshëndes nënën time	101
T'i mbrojmë pemët	103
I gjithë faji i fshatarit (tregim për mbrojtjen e mjedisit)	104
Kujtoj qenin tim	105
<b>Përshkruaj kafshët</b>	<b>107</b>
Sporti dhe koha e lirë	108
Tregimi realist dhe tregimi fantastik	109
Plani i veprimtarisë	110
Fuqia e Mujit	111
Llojet e fjalisë	113
Fjalitë dëftore dhe pyetëse	115



# PËRMBAJTJA



Fjalitë dëshirore dhe nxitëse	117
Dheu është flori	118
Fjalë të urta	119
Fjalitë me të cilat shprehim emocion	120
Pjesët kryesore të fjalisë. Kryefjala	122
Gjëgjëza	124
Liza në botën e çudirave	125
Kallëzuesi	128
Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën	129
Luani dhe dhelpira e mençur	130
Fabula	131
Shenjat e pikësimit	132
Shkronja e madhe	133
Çfarë i ndodhi kameleonit?	134
Princesha-mollë	135
Rosaku i shëmtuar	137
Shenjat e pikësimit në dialog	139
Shenjat e pikësimit në fjali	140
Vjersha	141
Në panairin e librit	142
Libri elektronik dhe enciklopedia	144
Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit	145

## ■ Dita e parë e shkollës

Shkuan si në ëndërr ata tre muaj pushimesh në fshat!

Sot të gjitha rrugët gëlonin prej fëmijëve. Të dyja libraritë para shkollës ishin mbushur me nëna dhe baballarë, të cilët blinin çanta, libra dhe fletore. Përpara shkollës po grumbulloheshin aq shumë njerëz, saqë roja mezi e mbante të lirë portën që të kalonin nxënësit.

Papritur ndjeva dikë të më hidhte dorën mbi sup. Ishte mësuesi im i klasës së tretë, gjithnjë i qeshur, me flokët e tij të kuq e të shpupuritur, që më tha:

- Pra, Enrik, u ndamë përgjithnjë?

E dija fare mirë këtë gjë, ama fjalët e tij ishin si gozhdë në zemër.

Hyra brenda me shumë mund. Aty ishin plot zonja, zotërinj, gjyshe dhe gjyshër, duke mbajtur fëmijët në njërën dorë dhe në tjetrën dëftesën e notave. Ata mbushnin përplot katin e parë dhe shkallët, duke krijuar një gumëzhitje të tillë, saqë të bëhej sikur ishe në teatër. Drejtori gjendej mes disa nënave të bëra vrer, ngaqë nuk kishte më vende për fëmijët e tyre. M'u duk se mjekra e tij ishte disi më e bardhë sesa vitin e shkuar.



E pashë sërish gjithë kënaqësi korridorin, me të shtata dyert e klasave, ku kalova për tre vjet gati të gjitha ditët e shkollës.

Pashë se disa shokë ishin zgjatur, disa ishin shëndoshur. Në katin e parë kishte fëmijë të klasave të para që nuk donin të hynin nëpër klasa. Disa ia mbathnin prej bankave; disa të tjerë, me të parë prindërit të largoheshin, ia krisnin të qarit. Atëherë prindërit ktheheshin pas për t'i qetësuar.

Në orën dhjetë ishim të gjithë në klasë, pesëdhjetë e katër vetë: pothuajse pesëmbëdhjetë apo gjashtëmbëdhjetë ishin shokët e mi që nga klasa e parë. Duke menduar për pyjet dhe fushat ku i kalova pushimet, klasa m'u duk kaq e vogël! Më kujtohej edhe mësuesi i klasës së tretë, i cili gjithnjë qeshte me ne, saqë dukej sikur ishte shoku ynë. Mësuesi ynë i ri është i gjatë, pa mjekër, me flokë të hirtë e të gjatë. Ka një rrudhë të drejtë mbi ballë; ka zë të trashë dhe na sheh të gjithëve sikur të jetë duke na lexuar mendjen.

Thosha me veten time: "Ja dita e parë e shkollës. Edhe nëntë muaj të tjerë. Sa shumë punë, sa shumë provime mujore, sa shumë mund!... Por dhe sa shumë





gëzime e veprimtari të bukura me shokët dhe mësuesin e ri!

Kur dola, dëshiroja shumë ta gjeja mamën të hyrja. Dhe vërtet ajo ishte atje, ndaj shpejtova ta përqafoja e ta puthja. Ajo më tha:

- Kurajë, Enrik! Do t'i bëjmë mësimet bashkë.

Dhe në shtëpi u ktheva shend e verë.

"Zemër", Edmond de Amicis, nga seria "Klasikët për fëmijë", përktheu: R.Rizaj



## KUPTO TEKSTIN

### Fjalorth

*rrugët gëlojnë* – rrugët janë të mbushura plot me njerëz që lëvizin shpejt, në mënyrë të çrregullt e plot zhurmë.

*flokë të shpupuritur* – themi kështu kur flokët rrinë si të ngatërruara, si të pakrehura.

*ishin si gozhdë në zemër* – më mërzitën, më hidhëruan shumë.

*të bëra vrer* – të bëra helm; e përdorim këtë shprehje kur mërzitemi apo hidhërohemi shumë.

*shend e verë* – kjo shprehje tregon se jemi shumë të lumtur a të gëzuar.

### Pyetje rreth tekstit

1. Trego me fjalët e tua se si e përshkruan Enriku ditën e parë të shkollës:  
- jashtë shkollës; - brenda në shkollë; - brenda në klasë.
2. Pse Enrikut iu duk e vogël klasa? Po klasa jote, sa nxënës ka?
3. Si i përshkruan djali dy mësuesit e tij: të mëparshmin dhe të riun? Përshkruaje dhe ti mësuesen ose mësuesin tënd.
4. Si mendon ti, pse Enriku ishte i shqetësuar dhe pse më pas u kthye i gëzuar në shtëpi?

### Kthehu te teksti

1. Nënvizohet fjalinë ku tregohet se:

- pushimet kanë mbaruar,
- shokët e Enrikut kishin ndryshuar,
- mamaja i dha kurajë Enrikut,
- drejtori i ngjau më i vjetër Enrikut,
- në katin e parë kishte shtatë klasa,
- në shtëpi u kthye i lumtur.

### Po ti?

- Si u ndjeve ti ditën e parë të shkollës?
- Çfarë ndryshimesh vure re te shokët e tu?
- Ku ngjason dhe ku dallon dita jote e parë e shkollës nga dita e Enrikut?



**Detyrë.** Shkruaj nga një fjali për çdo paragraf.

# Pushimet verore

- Përpara se të shkruash, lexo me kujdes fjalët kyç.

Fjalë kyç për ata që i kanë kaluar pushimet **në bregdet**.



Det pa kufi, ujë i kripur, i ngruhtë, rërë e nxehtë, në breg, pulëbardhë, anije, notoj lehtë, bëj kala, shoh anije, çadër, plazh, peshk, mbledh guaska etj.



Fjalë kyç për ata që i kanë kaluar pushimet **buzë liqenit**.



Liqen, ujë i ëmbël, i freskët, rërë, breg, peshk, barishte, kallama, lejlek, varkë, notoj me vështirësi etj.

Fjalë kyç për ata që i kanë kaluar pushimet **në mal**.

Gjelbërim, pisha, bredha, çadër, ditë e freskët, natë e ftohtë, ketra, drerë, ngjitem, zbres, ajër i pastër, burim, ujë i ftohtë, pjekim mish, kamping etj.



## ■ Një diskutim në klasë



Ditën e parë të shkollës mësuesja solli në klasë Ermalin, nxënësin e ri të klasës.

Për ta njohur me ne, mësuesja hapi një diskutim me temë: "Ku është më mirë të jetosh, në fshat apo në qytet?"

– Le ta pyesim më parë Ermalin, se si ndihet ai larg vendlindjes, – tha mësuesja.

Fillimisht Ermali u skuq dhe belbëzoi ngadalë:

– Mirë... jo dhe aq mirë... çka.

Disa nxënës filluan të qeshnin.

– Kini durim fëmijë, – u tërhoqi vëmendjen mësuesja. – Ermali ende nuk e ka mbaruar mendimin e tij. Ai është edhe ca i ndrojtur, sepse sapo është njohur me ju.

– Mësuese, – ngriti dorën Dritoni, – a mund t'i bëj një pyetje Ermalit?

– Patjetër, Driton.

– Ermal, për çfarë të merr më shumë malli tani që je larg fshatit?

– Për kopshtin, – u çel Ermali. – Sa bukur është të rrish në kopshtin para shtëpisë!

– Eh, porqe ka sa të duash edhe këtu, – u hodh Artini.

– Më merr malli dhe për shokët e shoqet e klasës, mësuesen, fqinjët e rritur, teta Shpresën që pastronte rrugicën, xhaxhi Gimini që na rregullonte dritat..., – vazhdoi me të vetën Ermali.

– Kjo është një gjë e mirë, se tregon që ti, Ermal, ke pasur shumë miq. Por edhe këtu mund të gjesh plot miq, – i tha me dashuri mësuesja.

– Eh, këtu ka kaq shumë njerëz!... Vështirë ta njohin njëri-tjetrin! Ne në fshat i përshëndetim të gjithë kur kalojmë në rrugë.

– Epo, dihet, qyteti ka shumë më tepër banorë se fshati, – tha si me mburrje Elona.

– Jo, pse? – kundërshtoi Lindita. – Lagjja ku banoj unë i ngjan fshatit tënd, Ermal. Ne e njohim shumë mirë njëri-tjetrin.



- E shikon, Ermal? Mbase janë ditët e para dhe qyteti të ka futur frikën, - ndërhyri mësuesja.
- Mësuese, - mua s'më pëlqen të banoj në fshat. Në qytet ndihesh më i rëndësishëm, më modern, - foli me zë të lartë Berti.
- Ti je kot fare! - e shau atë Elona, shoqja e bankës.
- Elona, kujdes kur flet me shokun, ndërsa ti, Berti, fol me zë më të ulët, - u tërhoqi atyre vërejtje mësuesja.
- Mësuese, - mori leje për të folur Dritoni, - unë mendoj se për të qenë njeri i mirë dhe modern nuk ka rëndësi ku jeton, në fshat apo në qytet. Mësueses i ndriti fytyra nga përgjigjja e tij. Edhe shokët e miratuan duke lëvizur kokën.
- Unë mendoj se në fshatin e Ermalit ka shumë gjelbërim dhe ajri është i pastër, - tha Dritoni.
- Po, ashtu është, - pohoi Ermali. Ai filloi ta ndiente veten si në shtëpinë e tij.

## -KUPTO TEKSTIN

### Pyetje rreth tekstit

1. Ku kishte banuar më parë Ermali?
2. Pse në fillim ai ishte i ndrojtur?
3. Për çfarë e kishte marrë malli Ermalin?
4. Pse diskutuan shokët e klasës dhe mësuesja?
5. Kujt i tërhoqi vëmendjen mësuesja? Pse?
6. Si u ndie Ermali në fund të diskutimit?

### Detyrë

Bëj dallimin ndërmjet qytetit dhe fshatit.



Qyteti ka rrugë të gjera ..... etj.



Fshati ka ..... etj.

### Fjalorth

*modern* - e përdorim këtë fjalë për diçka apo për një person që ka cilësi të përparuara të kohës.  
*e miratoj* - e pëlqej dhe e përkrah një veprim a mendim.  
*belbëzoi* - në këtë rast kjo folje tregon se Ermali tha diçka nëpër dhëmbë, nuk i shqiptoi fjalët qartë se ishte i pasigurt.

# Diskutimi dhe biseda

- Kthehu te tregimi *Një diskutim në klasë*.

1. Cila ishte tema e diskutimit?
2. Kush e udhëhoqte diskutimin?
3. Cilët morën pjesë në diskutim?
4. Ç'gabime bënë gjatë diskutimit Berti dhe Elona?

- Bëj dallimin.



1. Diskutimi është një bashkëbisedim në grup a ndërmjet dy ose më shumë njerëzve, ku shkëmbehen mendime për një çështje të veçantë.



2. Biseda është një bashkëbisedim i lirë ndërmjet dy ose më shumë njerëzve. Ata flasin për të forcuar miqësinë, për të kaluar kohën e lirë, për të shkëmbyer ide dhe mendime...

## Rregullat gjatë diskutimit

- Mendohu para se të flasësh.
- Shprehu qartë.
- Fol me zë të ulët dhe shmang përsëritjet e shpeshta.
- Dëgjo me vëmendje atë që thonë të tjerët.
- Mos e ndërprit tjetrin kur flet.
- Fol kur të të vijë radha.

## PUNË NË GRUP

### Temë për diskutim

A mund të jetë fshati ashtu siç është qyteti?



### Temë për bisedë

Si do të dëshironit të ishte vendbanimi juaj?



# Sinonimet

**Kujto!** Sinonimet janë fjalë të ndryshme, që kanë kuptim të njëjtë ose shumë të afërt.



Sinonimet janë një pasuri e madhe për gjuhën.  
Ato ndihmojnë për ta shprehur më bukur e më qartë mendimin.



## USHTROHU

1. Lexo fjalët dhe shkruaj në fletore grupet e sinonimeve:

shikoj, vajzë, vështroj, mirëqenie, udhë, djalë, shtëpi, mirësi, cucë, dhomë, rrugë, banesë, odë, konak, gocë, çun, vërej, vilë, vashë, mbarësi, çupë

2. Shto një a më shumë sinonime për fjalët e dhëna. Krijò fjali me to.

qejf, dëfrim .....  
habitem, .....  
inatos, .....  
kuvendoj, .....  
prezantoj,.....

3. Dallo fjalët që janë përdorur me kuptimin e parë dhe me kuptim të figurshëm.

Kalamajtë po luanin në oborr. Beni është kalama.

Ti bën si bebe. Bebja solli gëzim në familje.

Fëmijët fjetën herët. Mos bëj si fëmijë.

4. Nënvizò me të kuqe sinonimet në fjalitë e mësipërme.

# Antonimet

**Kujto!** Antonimet janë fjalë me kuptim të kundërt.

Këtu në hënë është **ftohtë!**

Kur u ngjitëm **lart** e kuptuam.

Në tokë është **nxehtë.**

Duhet të zbrisni **poshtë.**



Fjalët *i ftohtë - i nxehtë, lart - poshtë* janë antonime. Antonimet mund të jenë: *emra, mbiemra, folje, ndajfolje.*



## USHTROHU

1. Shkruaj antonimet e këtyre mbiemrave:

i mirë	-	.....	i bukur	-	.....
i madh	-	.....	i bardhë	-	.....
i gjatë	-	.....	zemërgjerë	-	.....

2. Shkruaj antonimet e këtyre foljeve:

lodhem	-	.....	vesh	-	.....
hap	-	.....	shes	-	.....
armatos	-	.....	ngul	-	.....

3. Shkruaj antonimet e këtyre emrave:

ngrohtësi	.....	fatmirësi	.....
gëzim	.....	lumturi	.....
ngathtësi	.....	butësi	.....

4. Shkruaj antonimet e këtyre ndajfoljeve:

mirë	.....	gjatë	.....
para	.....	larg	.....

# ■ Cikli jetësor i bimëve

- Lexo tekstin e mëposhtëm

Pisha e zezë mund të jetojë deri në 5-6 shekuj (500 ose 600 vjet). Gështenja mund të arrijë moshën nga 1000 deri në 2000 vjet. Edhe selvia, që rritet në zona të ngrohta, mund të arrijë moshën 300 vjet.

Ahu mund të jetojë 6–8 shekuj, kurse lisi 6–7 shekuj.

Pemët frutore jetojnë më pak. Kumbulla jeton 25–30 vjet, mandarina 50–70 vjet, portokalli 60–70 vjet. Molla në kushte të mira jeton deri në 2 shekuj, dardha deri në 3 shekuj. Ka pjergulla rrushi që numërojnë në jetën e tyre 90–100 vjet.

Ullinjtë jetojnë deri në 800–900 vjet.

- Renditi bimët sipas jetëgjatësisë së tyre. Fillo nga bima që jeton më gjatë dhe vazhdo me bimët që jetojnë më pak.

.....

.....

.....

- Shkruaj numërorët me fjalë.
- Shiko pikturat e bashkëmoshatarëve të tu dhe përshkruaji me dy-tri fjali.





## ■ Tri gëzimet

- O çun, çfarë po pret në kopsht?

Çuni nuk flet. I pëlqen një mollë e kuqe në majë të degës. E shkund degën me një shkop të gjatë dhe molla bie.

Një mollë dhe një gëzim për çunin e vogël.

Te lumi i kaltër gjen peshkatarin. E përshëndet dhe ulet pranë tij. Shikon si rriten rrathët e valëve, kur peshkatarin hedh grepin në ujë.

- A ka peshq të mëdhenj këtu, xhaxha?

- Ka, - thotë peshkatarin.

- A ka sa dora ime?

- Edhe më të mëdhenj, por... Mos fol tani, se edhe ata më të mëdhenjtë mund të frikësohen prej teje.

Çuni shtrihet mbi bar dhe ëndërron një peshk të madh sa një dorë, sa një njeri, sa një pemë... Por të gjithë ata frikësohen prej tij dhe kjo i jep njëfarë kënaqësie.

Peshkatarin i fal një peshk çunit. Ja, i shtohet dhe një gëzim i dytë.

Çuni vrapon nëpër kopsht. E merr shportën ku mban mollën, dhe vë në të edhe peshkun. Ashtu shend e verë vrapon te shtëpia. Në hyrje të lagjes takon fëmijën e parë. Ai duket i mërziur.

- Hej, unë kam një mollë të kuqe! Unë kam edhe një peshk! - i thotë ai plot gëzim. Djali tjetër hesht.

"O ti që ke peshkun dhe mollën, gëzimi i një njeriu nuk zgjat gjithmonë. Pse atëherë s'i ndajmë gëzimet bashkë?" - i thotë një zë nga brenda.

Çuni ia zgjat shportën djalit të mërziur dhe i thotë:

- Hajde t'i ndajmë bashkë edhe mollën, edhe peshkun.

Kështu lindi gëzimi i tretë dhe ky gëzim jeton gjatë.



# KUPTO TEKSTIN

## Fjalorth

*çun* – djalë i vogël.

*shend e verë* – shumë i gëzuar.

### Pyetje rreth tekstit

1. Cili është gëzimi i parë i djalit? Si e fitoi djali atë?
2. Cili është gëzimi i dytë i djalit? Kush ia dhuroi atë?
3. Cili është gëzimi i tretë i djalit? Kujt ia dhuroi djali atë?
4. Pse gëzimi i tretë jeton më gjatë se dy të parët?

### Shëno me ✓ përgjigjen e saktë dhe me ✗ përgjigjen e gabuar.

- Çuni këputi një mollë të gjelbër nga pema.
- Çuni ëndërron një peshk sa një njeri.
- Çuni mërzhitet që peshqit frikësohen prej tij.
- Çuni ka dy gjëra në shportë.
- Djali tjetër i lutet çunit t'i ndajnë gjërat bashkë.



### Kthehu te teksti

- Sa herë është përdorur fjala *gëzim*? \_\_\_\_\_
- Sa herë është përdorur fjala *çun*? \_\_\_\_\_
- A veproi mirë djali që i ndau dhuratat me djalin tjetër?



### Po ti?

- Po ti, nëse ke diçka, a të pëlqen ta ndash me të tjerët?
- Kur mendon ti se veprimi yt është më i rëndësishëm:
  - kur i fal dikujt diçka
  - apo
  - kur e bën të lumtur?
- Pse mendon kështu?



## ■ Vajza e kopshtarit

Rrugës për në Institutin e Fëmijëve që nuk Dëgjojnë, kopshtari i fliste shoqëruesit, i ngrysur në fytyrë:

– Ah, Xhina ime e shkretë! Sa e pafat që ka lindur! Nuk e kam dëgjuar kurrë të më thotë *babi* dhe kurrë nuk ka dëgjuar një fjalë në këtë botë! Sa me fat që u gjet një zotëri zemërmirë, që e pranoi në institut. U bënë tre vjet që nuk e kam parë. Kam qenë në mërgim. Kam punuar shumë, vetëm e vetëm për Xhinën e vogël. Pa më thoni, a është rritur shumë? A është e kënaqur?

Sapo mbërritën në institut, u futën te dhoma e vizitorëve.

– Jam babai i Xhina Voçit, – tha kopshtari. – Desha ta shoh menjëherë time bijë.

– Janë në pushimin e drekës, – u përgjigj roja. – Por po lajmëroj mësuesen.

Pas pak u hap dera. Hyri një mësuese me një vajzë për dore. Babai dhe vajza e vështruan njëri-tjetrin për një çast, pastaj u rrokën për qafe. Vajza ishte veshur me një fustan pambuku me vija të kuqërreme dhe me një përparëse të bardhë. Ishte zgjatur! I ati filloi ta vështronte nga koka te këmbët me lot ndër sy.

– Ah! Sa qenke rritur! Sa qenke zbukuruar! Xhina ime e gjorë! Xhina ime e dashur! Ju, zonjë, jeni mësuesja? I thoni që të më bëjë ato shenjat e saj, sepse





diçka do të kuptoj dhe dalëngadalë do të mësohem.

Mësuesja buzëqeshi dhe i tha vajzës:

– Kush ka ardhur të të takojë?

Vajza, me një zë të trashë dhe të çuditshëm dhe me një intonacion të veçantë, shqiptoi qartë duke buzëqeshur:

– Ë-shtë ba-bi im.

Kopshtari u zbraps një hap dhe klithi i çuditur:

– Zemër, ti flet? Po si është e mundur?! Pse, nuk flasin me shenja, zonja mësuese? A nuk flasin me gishta? Po si është kështu kjo punë?

– Jo, zoti Voçi, – u përgjigj mësuesja. – Nuk flasin më me shenja. Ajo ka qenë një metodë e vjetër. Këtu i mësojmë me një metodë të re. Nuk e dinit?

– Nuk dija gjë! – u përgjigj i shtangur kopshtari. – Kam qenë tre vjet jashtë shtetit! Bija ime, ti më kupton? E dëgjon ç'të them?

– Jo, zotëri, – tha mësuesja, – zërin nuk arrin ta dëgjojë. Por ajo i kupton fjalët nga lëvizjet e gojës suaj. Dhe i shqipton, se ia kemi mësuar germë për germë. I kemi mësuar si duhet t'i lëvizë buzët dhe gjuhën dhe çfarë përpjekjesh duhet të bëjë me kraharor dhe grykë që të mund të nxjerrë zë.

Kopshtari mbeti gojëhapur. Ende nuk i besohej.

– Pa më thuaj, Xhina, – pyeti vajzën duke i folur ballë për ballë. – A je e lumtur që u kthye babi dhe nuk do të ikë më?

Vajza u përgjigj me çiltërsi:

– Po, jam e lum-tur që je kthyer e s'do i-kësh më... ku-rrë.

"Zemër", Edmond de Amicis, përktheu: R.Rizaj



## KUPTO TEKSTIN



### Fjalorth

*shkoj në mërgim* – shkoj larg atdheut, në vend të huaj, për të jetuar dhe për të punuar. Në këtë tregim, babai i vajzës ka shkuar në mërgim për të siguruar një punë dhe një rrogë më të mirë që të mbajë familjen.

*intonacion* - ngritja, ulja dhe forca e zërit, si edhe mënyra e shqiptimit të fjalëve. Me anë të intonacionit ne dallojmë fjalinë pyetëse nga fjalia dëshirore, dëftore apo nxitëse.

### Pyetje rreth tekstit

1. Pse ishte i shqetësuar babai në fillim të tregimit? Pse e quan "vajza e gjorë"?
2. Si iu duk atij pamja e jashtme e Xhinës kur e takoi?
3. Çfarë ndryshimesh kishte bërë vajza gjatë kohës së qëndrimit në institut?
4. Pse mësuesja i tha babait që metodat kishin ndryshuar?
5. Cilat fjalë e lumturuan babanë kur Xhina i shqiptoi?

### Po ti?

1. A ke ndonjë shok/shoqe apo ndonjë njeri në rrethin familjar me aftësi ndryshe? Si e kaloni kohën së bashku?
2. Pse është e rëndësishme që njerëzit me aftësi ndryshe:
  - t'i mbajmë afër e t'i ndihmojmë kur kanë nevojë;
  - t'i bëjmë të ndihen të vlefshëm?

### Kthehu te teksti

1. Gjej dhe nënvizo në tekst fjalët e dhëna më poshtë. Shkruaj kuptimin e tyre.
  - (mbeti) gojëhapur - .....
  - (mbeti) i shtangur - .....
  - u zbraps - .....
  - klithi - .....

### Punë në grup

Me ndihmën e mësueses/it mblidhni të dhëna për Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë ose për Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë. Çfarë metodash përdorin mësuesit për të dhënë mësim? A janë të njëjtë librat tuaj me librat që përdorin ata? Diskutoni në klasë.



# Ani pianistja

## Hyrja

Ani erdhi në shkollën e muzikës të qytetit tonë tre muaj pasi kishte filluar viti shkollor. Ishte truphedhur dhe simpatike. Kishte flokë të gjatë dhe ngjyrë gështenjë. Anit i pëlqente të fantazonte. Ajo ishte e padjallëzuar, mësonte mirë dhe i kryente me rregull detyrat. E mundonte pak gjeografia dhe hartat, ama në mësimin e pianos ishte e jashtëzakonshme.

Një ditë Anin e ftuan në një koncert, që e organizonte bashkia e qytetit. Kjo u ra si bombë dy shoqeve të saj të klasës, Elës dhe Enit. Pa ardhur Ani, ato mbaheshin më të mirat në piano. Prandaj u bënë ziliqare.

Salla ishte mbushur plot. Dirigjenti i bëri me shenjë Anit që të fillonte. Por Ani nga hutimi dhe shqetësimi e mori këtë gjest si përshëndetje. Ajo u ngrit e i dha dorën dirigjentit. Në sallë u dëgjuan të qeshura. Dy shoqet e klasës vështruan njëra-tjetrën: "Budallaqja, e kemi thënë ne!" Por shumë shpejt salla u magjeps. Nga duart e pianistes së vogël filluan të dilnin tinguj të mrekullueshëm. Suksesi ishte i jashtëzakonshëm. Njerëzit nuk pushonin së duartrokituri. Atë natë Ani nuk fjeti fare nga lumturia.

Të nesërmen, e gjithë klasa e priti me duartrokitje. Pastaj fëmijët filluan të thërrisnin: "Ani! Ani! Je e madhe!" Kjo ishte një surprizë, e cila, sa e gëzoi, aq dhe ia skuqi faqet nga turpi. Vetëm dy shoqet ziliqare nuk e uruan.

Në pushimin e madh, kur Ani vajti në banjë, ato i mbyllën derën dhe i hodhën përsipër një gotë me ujë të ftohtë të ngjyrosur. Ani bërtiti dhe deshi të hapte derën, por brava u këput dhe ajo mbeti brenda... Ngjarjen e morën vesh të gjithë. Mësuesja kujdestare dhe drejtori e pyetën Anin se kush ia bëri këtë rreng. Por Ani nuk u tregoi asgjë. Kjo sjellje zemërgjerë i bëri

## Zhvillimi



shoqet që të ndiheshin shumë keq.  
Kaloi një javë dhe pendimi po i gërryente nga brenda. Pasditen e së shtunës ato shkuan në shtëpinë e Anit. Derën ua hapi mamaja e Anit. Ajo i ftoi brenda, por ato i lanë një pako në dorë dhe ikën.

Ani gjeti në pako një kukull me flokë të gjatë, në xhepin e së cilës ishte vënë një pusullë. Atje shkruhej:  
"Ani, je e madhe!  
Me dashuri nga Ela dhe Eni".

Shpresa Vreto

## KUPTO TEKSTIN

### Pyetje rreth tekstit

1. Pse dy shoqet e kishin zili Anin?
2. Cili ishte gabimi që bëri Ani në fillim të koncertit?
3. Cili ishte shkaku i keqkuptimit:  
ndrojtja nga skena,  
padituria,  
mendjemadhësia? Pse?
4. Si e pritën shikuesit interpretimin e Anit?
5. Çfarë i ndodhi Anit të nesërmen në shkollë? Cila ishte:  
e papritura e këndshme,  
e papritura e keqe?
6. Si e përshkruan autorja Anin?

### Po ti?

- Si duhet të sillesh me një shoqe ose shok që:  
ka arritur sukses,  
është i ndrojtur,  
humbet në një garë,  
të ka bërë një të keqe?
- Diskutoni në klasë për këtë temë:  
Ti nuk e arrin dot suksesin duke pasur zili tjetrin, por duke e marrë atë si shembull.  
Zbulo te vetja aftësitë e tua të veçanta dhe përpiqu më shumë. Atëherë sukcesi do të trokasë patjetër te ti.

### Detyrë

- Përshkruaj shkurtimisht pasionin tënd.

### Fjalorth

*truphedhur* - trup i zhvilluar mirë.  
*e padjallëzuar* - që sillet e vepron me çiltërsi, pa qëllime të këqija ndaj të tjerëve.  
*u ra si bombë* - u erdhi e papritur.



# Hyrja- zhvillimi -mbyllja



Tregimi ka një ndërtim të caktuar. Ai përbëhet nga: **hyrja**, **zhvillimi** dhe **mbyllja**.

- Kthehu te tregimi "Ani pianistja".  
Me ndihmën e mësueses analizo përbërësit e tij.

<b>HYRJA</b>	Në hyrje paraqiten <b>personazhet</b> , <b>koha</b> , <b>vendi</b> ku ndodh ngjarja.
<b>ZHVILLIMI</b>	Gjatë zhvillimit të tregimit tregohet se <b>çfarë ndodh</b> . Kjo është pjesa më e gjatë. Ajo ka përshkrime (të vendit e të personazheve), situata e të papritura, tregohen sjelljet dhe veprimet e personazheve, bashkëveprimet e tyre etj.
<b>MBYLLJA</b>	Në mbyllje të tregimit tregohet si përfundon ngjarja.

(Për të gjetur lehtësisht temën, bëj pyetjen:)

**TEMA**

Për çfarë flet ky tregim?

Tregimi "Ani pianistja" flet për një vajzë shkollare. Ajo është shumë e talentuar në piano, por kjo e bën të përballet me xhelozinë e shoqeve të veta.

(Për të gjetur lehtësisht mesazhin, bëj pyetjen:)

**MESAZHI**

Çfarë mësojmë nga kjo pjesë?

Në tregimin "Ani pianistja" shkrimtarja na jep mesazhin se ne të gjithë duhet të jemi zemërgjerë ndaj sukseseve të tjetrit.

## Detyrë

- Gjej temën, mesazhin (idenë) dhe personazhet e tregimeve:  
*Një diskutim në klasë; Dita e parë e shkollës.*

# ■ Përshkruajmë shokun ose shoqen

- Përshkruaj një shok ose një shoqe të klasës. (Përdor sa më shumë nga fjalët e dhëna për pamjen fizike, për karakterin e sjelljen e tij/e saj).

Ne mund t'i përshkruajmë njerëzit nga:

## Pamja fizike:

### Ngjyra dhe lloji i flokëve:

gështenjë, gështenjë e çelur, gështenjë e errët, të verdhë, kuqaloshë, të verdhë të zbehtë, të zinj, korb të zinj, të kuq, të thinjur, gri në të bardhë; të krehur, të pakrehur, të shpupuritur, të dredhur, të lëshuar, kaçurrelë, të mbledhur, përpjetë etj.

**Trupi:** i gjatë, elegant, i hollë, thatanik, mesatar, normal, i shkurtër, i imët, i shëndoshë, i rregullt etj.

**Qëndrimi i trupit:** i drejtë, i ngrehur, i përkulur, kryelartë, serioz, i shkujdesur, i thjeshtë etj.

### Tiparet e fytyrës dhe shprehja

**Balli:** i lartë, i ngushtë, i ulët, i gjerë;

**Sytë:** të kaltër, gështenjë, larushë, gri, jeshilë, të zinj;

**Shprehja:** e gjallë, e gëzuar, e qeshur, e habitur, e qetë, e ëmbël, e trishtuar, e lodhur, e menduar, e inatosur...

**Zëri:** i ulët, i prerë, lutës, bindës, i lartë, i ngjirur, melodioz, autoritar etj.

## Nga karakteri dhe sjellja:

e dashur, e hapur, e ndjeshme, e respektueshme, e gëzuar, e hareshme, e qetë, entuziaste, optimiste, pesimiste, e trishtuar, melankolike, nervoze, krenare, e qetë, e pasigurt, e paqëndrueshme, e pavendosur, mendjemadhe etj.







## RREGULLORJA E KLUBIT "MIQTË E MIRË"

Mirë se erdhët në klubin "Miqtë e mirë"!

### Rregullorja

- Çdokush mund të jetë anëtar i klubit, pavarësisht nga ngjyra e lëkurës apo nga problemet shëndetësore.
- Miqtë mbeten miq, edhe sikur njëri të shkojë diku larg.
- Miqtë e mirë i ndajnë gjërat me njëri-tjetrit.
- Miqtë e ndihmojnë shokun, kur ka nevojë.
- Miqtë nuk e kanë zili shokun.
- Miqtë duhet ta kuptojnë njëri-tjetrit edhe pa folur.
- Miqtë nuk duhet t'ua tregojnë të tjerëve të fshehtat e shokut.
- Miqtë nuk duhet t'i mbajnë inat njëri-tjetrit.



# Rregullorja e klubit "Miqtë e mirë"

Vendose veten në situatat e mëposhtme. Në rregulloren tuaj të vjetër mungojnë disa rregulla, që duhet t'i shtoni.

Shkruaj nga një rregull për secilën situatë.

## Situata 1

Një vajzë rome sapo ka ardhur në lagjen tuaj. Ajo do të hyjë në klubin e miqve. Vera dhe Artini kundërshtojnë. Ti dhe shokët e tjerë doni ta pranoni. Për këtë rast duhet të shkruani një rregull.

.....



## Situata 2

Majlinda dëshiron të bëhet anëtare e klubit tuaj. Ju nuk pranoni, sepse e keni kuptuar që ajo nuk di të mbajë të fshehta. Pasi ajo ju lutet shumë, ju pranoni, por shkruani një rregull që Majlinda ta ketë parasysh.

.....

## Situata 3

Edi do të shkojë të jetojë me prindërit jashtë shtetit. Ai ju lutet që të mbetet përsëri anëtar i klubit. Disa nga ju e kundërshtojnë, por shumica mendon se duhet të shkruhet një rregull për këtë rast.

.....



## Situata 4

Ermira ka fituar çmimin e parë në konkursin e piktorëve të vegjël. Dy nga shoqet tuaja u mërzitën, sepse donin ta fitonin vetë çmimin. Ato thanë që pikturat e Ermirës nuk ishin aq të mira. Ju i këshilluat t'i kërkonin të falur shoqes dhe menduat se ishte e nevojshme të shtohet një rregull për këtë rast.

.....

## Situata 5

Një shoku juaj me aftësi ndryshe dëshiron të jetë në skuadrën tuaj të volejbollit. Disa nga ju e kundërshtojnë, nga frika se mos humbisni lojën me skuadrën kundërshtare. Ndërsa disa të tjerë mendojnë se ai mund të stërvitet bashkë me ju. Shkruani një rregull për këtë rast.

.....





# Një mik i madh: fjalori

Përse fjalori mund të jetë një mik i madh?

Fjalori është një libër që:

- përmban fjalët e gjuhës;
- jep kuptimin e çdo fjale, si edhe kuptime të tjera të saj;
- të mëson si ta shkruash e ta përdorësh drejt çdo fjalë;
- të jep të dhëna gramatikore (emër, mbiemër, folje, ndajfolje etj.).



Fjalorët janë disa llojesh:

**njëgjuhësh**, siç është *Fjalori i gjuhës shqipe*;

**dygjuhësh**, siç janë: fjalorët anglisht – shqip, shqip – frëngjisht etj.

**fjalorë enciklopedikë** – ku renditen njohuri nga fusha të ndryshme të dijes etj.

Fjalët në fjalor renditen sipas alfabetit.

a. Si e gjejmë fjalën në fjalor?

Kërkojmë p.sh., fjalën **breg**.

Shikojmë **shkronjën e parë** **b** baba... bacë... etj.

Shikojmë **shkronjën e dytë** **br** brazdë... bravë... etj.


Shikojmë **shkronjën e tretë** **bre** bredh... bredhur... **breg**.



b. Gjejmë kuptimin e fjalës.

**breg/u** pjesë a rrip toke në anë të një rrjedhe uji, buzë detit, buzë liqenit.

c. Shohim veçoritë gramatikore të fjalës.



Për të gjetur fjalët që janë të lakuara ose të zgjedhuara, më parë duhet të gjejmë **fjalën bazë**.

Për këtë: (p.sh.: *miqtë, kam punuar, e bukur*) duhet që:

- **emrin** ta kthejmë **në trajtën e pashquar, numri njëjës, rasa emërore**: *miqtë* - *mik*.
- **foljen** ta kthejmë **në kohën e tashme, mënyra dëftore, veta I, numri njëjës**: *kam punuar* - *punoj*.
- **mbiemrin e nyjshëm** ta kthejmë **në gjininë mashkullore, pa nyjë**: *e bukur* - *bukur*



# USHTROHU

Fjalori i gjuhës shqipe ekziston edhe në formën e digjitalizuar, ku ne mund t'i kërkojmë e t'i gjejmë kuptimet e fjalëve të reja e të panjohura;

1. Gjej fjalën bazë të emrave e të foljeve që janë në tabelë.

emra	emërore, njëjës	folje	veta I, e tashme
pleq	plak	këndojmë	këndo
miq		shkruam	
djem		pastroja	
gratë		vizatonin	
lumenjtë		marrim	
parqe		do të shisni	
fiq		do të takoj	
rrathë		shikova	

2. Ngjyros fjalën bazë të çdo rreshti.

djalë	djem	djalit	djemve	djali
peshqit	peshk	peshqve	peshkut	peshku
dëgjova	dëgjonte	kishte dëgjuar	dëgjuar	dëgjoj
përdua	përroi	përduan	përrenjve	përrenj
e vogël	i vogël	të vegjël	të vogla	vogël

3. Zgjidh njërën nga fjalët në kllapa dhe vendose ndërmjet dy fjalëve të dhëna, ashtu si renditet në fjalor.

breshër,	bukuri,	burrë	(bukuri, bari, balet)
pemë .....			pjeshkë (patë, prek, pikturë)
natë .....	nesër		(napë, nepërkë, numër)
qafë .....	qerre		(qiell, qullac, qendër)

4. Shkruaj fjalët në fletore sipas rendit alfabetik. Më pas gjej në fjalor kuptimin e gjashtë prej tyre.

alarm, letër, shkollë, zile, zhapik, tokë, nis, re, gjethe, pemë, bori, copëtoj, detyrim, përgjegjësi, bashkëpunim, anëtar, ilustrim, titull, shënjestër, gjatësi, mirësi, garë, fitoj, dimër, dhomë.

# ■ Është fat të kesh një shoqe si Fatbardha

E dashur revista "Ylberi",

Ti tani je bërë mikja ime më e dashur, prandaj po të shkruaj. Unë jam Eneida, një vajzë në klasën e katërt. Dua të të shkruaj për shoqen time të ngushtë, Fatbardhën. Ashtu si emrin, ajo ka edhe zemrën.

Bardha është një vajzë rome shumë e lezetshme. Ajo ka flokë të zinj dhe sy të gjelbër. Vrapon shumë shpejt dhe ka një zë të mrekullueshëm. Unë u njoha fare rastësisht me të. Familja ime banon në lagjen ku jetojnë shumë familje rome. Shumë prindër i këshillojnë fëmijët e tyre që të mos shoqërohen me ta. Dhe kështu, edhe mua, pa dashjen time, m'u krijua mendimi se duhet të rrija sa më larg fëmijëve romë.

Por një ditë, pa arritur ende te pallati im, dëgjova një të lehur qeni. Fillova të vrapoja, ndërsa ai m'u sul edhe më keq. Atë kohë nga dera aty pranë doli një vajzë, e cila e largoi qenin, duke i bërtitur:

– Ik, ik, qen i keq!

Por ndërkaq, ai e kafshoi në dorë. Unë fillova të bërtisja e të qaja me të madhe. Shumë të rritur na u afruan. Erdhi dhe i zoti i qenit duke vrapuar. Ai po thoshte se e kishte qenin të vaksinuar. Fatbardha nuk nxirrte asnjë fije zëri, vetëm e mbante grushtin të shtrënguar.

– Eja, – i thashë, shkojmë në shtëpinë time. – Unë e kam mamin infermiere.

Fatbardha tundi kokën në shenjë pohimi dhe

erdhi pas meje.

Kur po hynim në shtëpi, mami po dilte, se kishte ndërrimin e dytë. Unë fillova t'ia shpjegoja të gjitha, ndërsa mami hapi kutinë e ndihmës së shpejtë dhe filloi t'ia mjekonte plagën Fatbardhës.

– Tani, hajde të shkojmë te shtëpia e Fatbardhës t'i njoftojmë, sepse kjo vajzë duhet patjetër të bëjë vaksinën.

Nuk i zihet besë të zotit të qenit.

Dhe ashtu bëmë. Fatbardha i duroi gjilpërat si heroinë. Shtrëngonte dhëmbët dhe herë pas here i shpëtonte ndonjë lot nga sytë. Nuk e di, po atë çast u ndjeva keq. Ajo po vuante për shkakun tim. Fatbardha e kuptoi gjendjen time, më shihte me sytë e gjelbër plot dashuri dhe vinte buzën në gaz.

Që atëherë ne jemi bërë shoqe të ngushta. Dhe ta dini, Fatbardha jo vetëm më shpëtoi prej qenit, por prej saj unë mësova shumë gjëra. Edhe ajo thotë se është me fat që më ka mua shoqe.

E dashur revistë,

Gjithandej shkruhet e thuhet se ne jemi të barabartë, megjithëse të ndryshëm nga pamja, ngjyra, aftësitë tona etj. Ndërsa unë thjesht doja të tregoja një rast miqësie të vërtetë. Ju lutem, botojeni letrën time.

Me dashuri, Eneida



## Pas leximit të mësueses/it duhet të plotësosh:

revista titullohet "Ylberi"


vajza që shkruan letrën .....  
ngjyra e syve.....  
ngjyra e flokëve .....  
Kush e mjekoi?.....

shoqja e saj .....  
ngjyra e lëkurës.....  
Cilën kafshoi qeni?.....  
Cila nga vajzat është me fat për shoqen që ka zgjedhur? .....

## DISKUTONI NË GRUP

Lexoje dhe një herë me zë të lartë paragrafin e fundit të letrës.

- Pse Eneida ia ka dërguar këtë letër revistës:
  - për t'i bërë qejfin Fatbardhës,
  - për të treguar se di të shkruajë bukur,
  - për t'u dhënë një mesazh bashkëmoshatarëve të saj?
- Cili është mesazhi që Eneida u përcjell bashkëmoshatarëve?



# ■ Letër revistës - letra formale



Shkruaj dhe ti një letër.

**TEMA:** Të gjithë jemi të barabartë, pavarësisht se të ndryshëm nga ngjyra e lëkurës, nga aftësitë, nga prejardhja etj.

**Së pari.** Zgjidh revistën ku do ta dërgosh letrën. ....

**Së dyti.** Mos harro të vësh datën .....

**Së treti.** Drejtoju revistës. ....

**Së katërti.** Meqë këtu ngecin të gjithë, me siguri dhe ti do të kruash kokën. Por mos u tremb. Fillimi është gjithnjë i vështirë.

Mendoje mirë se çfarë do të shkruash për këtë temë.


- Mund të shkruash diçka nga përvoja jote: P.sh.: Edhe unë kam një shok/shoqe rome  
Ose: Shoku im është i ndrojtur, sepse i merret goja... Ose: Unë kam një shok/shoqe që nuk është mirë me mësimet.  
Prindërit...

- Mund të shfaqësh mendimet e tua për këto probleme kaq të rëndësishme: P.sh.: Të rriturit na këshillojnë dhe na mësojnë shumë gjëra me vlerë. Por ndonjëherë harrojnë se çfarë kanë thënë. Sot në botë shumë njerëzve u shkelen të drejtat. Unë mendoj se.....

**Së pesti.** Mos harro përshëndetjen e fundit.

## Mëso më shumë

- Nëse do ta nisësh letrën me postë, shkruaje adresën në zarf.
- Nëse do ta nisësh nëpërmjet kompjuterit, me postë elektronike, atëherë duhet ta shkruash letrën edhe një herë në kompjuter.
- Kontrollon mirë revistën, se në fund të faqes së parë ose të fundit mund të jetë adresa e saj postare ose elektronike.





# ■ Letër shoqes – Letra personale

Shkruaji një letër shoqes të cilën e ke larg.  
Ty të ka marrë shumë malli.

Do t'i thuash se e do dhe gjërat tani të duken ndryshe pa të.

A e di ti se mënyra më e shpejtë për të komunikuar me shoqen ose shokun që ke larg është posta elektronike? Kërkoju ndihmë më të rriturve që të futesh në postën e internetit (e-mail, shqiptohet i-meil). Në tastierën e kompjuterit do të shtypësh shkronjat që të duhen për të shkruar letrën.

- Provoje dhe ti të shkruash një letër dhe ta dërgosh me e-postë (e-mail).
- Cilat janë gjërat e përbashkëta dhe cilat janë ndryshimet ndërmjet të dyja letrave?



Ekrani i kompjuterit

Tastiera e kompjuterit

# Revista për fëmijë - Të drejtat dhe përgjegjësitë

Ti dhe të gjithë fëmijët e botës keni të drejtat tuaja, ashtu sikurse i kanë edhe të rriturit. Këto të drejta janë shkruar në një libër, që quhet "Konventa e të Drejtave të Fëmijëve". Të drejtat tuaja duhet të zbatohen nga të rriturit. Por, a ndodh gjithnjë kështu? Që të kërkes të drejtën tënde, duhet ta njohësh më parë atë.

- Plotëso dhe ti sipas shembujve të mëposhtëm.



- a. Shkruaj disa nga të drejtat e tua, sipas situatave të mëposhtme:

- Klasa është shumë e ftohtë.
- Mësuesja nuk e merr parasysh mendimin tënd.
- Prindërit lexojnë pa leje ditarin tënd.

- b. Shkruaj disa nga detyrat e tua, sipas situatave të mëposhtme:

- Mami të ka blerë një qenush për ditëlindje.
- Ke një klasë shumë të bukur dhe plot mjete shkollore.
- Nuk ke dalë mirë me mësimet semestrin e parë.

Disa nga fjalët me të cilat mund t'i fillosh fjalitë janë:

Kam të drejtë; E kam për detyrë; Nuk duhet; Kam nevojë; Duhet të; Të mos etj.



## ■ Gjuha e nënës

Atë ditë të nxehtë plazhi ziente si një koshere bletësh. Lu afrova një ëmbëltoreje, që të blija akullore për djalin tim të vogël. Te banaku shitësja po fliste me një vajzë të vogël 9 vjeçe, e cila shoqërohej nga një djalosh më i madh.

- Paske ardhur, Albana?

- Ëhë.

- Sa qenke rritur, bukuroshe! Mami dhe babi mirë janë?

Vajza tundi kokën në shenjë pohimi. Shitësja e pyeste, por ajo nuk fliste, vetëm përgjigjej me shenja, duke lëvizur duart dhe kokën. Kur vajza dhe djaloshi u larguan, e pyeta shitësen:


- Pse nuk fliste ajo vajza?

- Nuk di mirë shqip.

- Mua m'u duk se ajo i kuptonte fjalët e tua.

- Po, ajo është shqiptare. Ka qenë tre vjeçe kur shkoi me prindërit në Itali. Tani jetojnë atje. Ajo kupton, por nuk flet shqip.

Sa keq u ndjeva! Nuk fajësova vajzën. Më erdhi keq që prindërit e saj nuk e kishin ushtruar për të folur shqip. Për këtë vendosa t'u shkruaj një letër fëmijëve në revistën e tyre.



Të dashur fëmijë shqiptarë, kudo ku jetoni, Ju duhet ta dini se gjuha e nënës është si qumështi i nënës, që e rrit fëmijën me shëndet dhe me dashuri. Nëpërmjet saj ju merrni dijet e para. Edhe gjuha e huaj të jep dije, por gjuha amtare është gjuha e zemrës suaj. Zemra e një francezi flet frëngjisht, zemra e një italiani

flet italisht, zemra e një anglezi flet anglisht, ndërsa zemra e një shqiptari flet shqip.

Prandaj, sado të vegjël të jeni, kërkojuani këtë të drejtë prindërve tuaj.

Sokol Jakova

## -KUPTO TEKSTIN

### Pyetje rreth tekstit

1. Pse vajza i përgjigjej shitëses me shenja?
  2. Cilin bën me faj autori: fëmijën apo prindërit?
  3. Pse autori e krahason gjuhën e nënës me qumështin e nënës?
  4. Cila është porosia që u jep autori fëmijëve?
  5. Cila është e drejta që kanë fëmijët për gjuhën e nënës?
- Shkruaje këtë të drejtë në fletoren tënde.

### Fjalorth

*ëmbëltore* - dyqan ku shiten ëmbëlsira.

*tundi kokën në shenjë pohimi* - pohoi pa zë, tha "po" me shenja.

### Shëno me përgjigjen e saktë dhe me përgjigjen e gabuar.

- Vajza ka qenë 4 vjeçe kur ka shkuar në Itali me prindërit.
- Autori e dërgoi letrën në shkollë.
- Edhe zemra ka gjuhën e saj.
- Autori ua drejton letrën vetëm fëmijëve që jetojnë jashtë vendit.
- Në tekst gjenden këto fjalë: gjerman, gjermanisht.
- Fëmijët duhet të kërkojnë të drejtën për të mësuar gjuhën e nënës.

### Plotëso

**Cila është gjuha e nënës**

për

një shqiptar -	gjuha shqipe
një anglez -	.....
një grek -	.....
një italian -	.....
një rus -	.....
një francez -	.....
një kosovar -	.....

- Cilët prej tyre kanë gjuhë të njëjtë?
- Trego për ndonjë shok, shoqe ose të afërm, që jeton jashtë shtetit. Si e flet ai ose ajo gjuhën shqipe?



## Poezia në dialekt

Naim Frashëri

### Nuk e harron mëmëdhenë

Njeriu kudo të rronjë  
Nuk e harron mëmëdhenë  
Zogu le të fluturonjë,  
Po në mënt e ka folenë.  
Uji sado që të ngrihet,  
E të hapetë ndë erë.  
Të mblidhetë e të shtrihet,  
Prap mbi dhet do të bjerë;  
Ngado të vejë e të bredhë,  
Të ndryshohet e të ndrohet,  
Prap mbi dhet do të rrjedhë,  
Veç atje mund të qetohet.

Andon Zako Çajupi

### Robëria

E dashura mëmëdhe,  
Të dua dhe kshtu si je!  
Po kur të të sho të lirë,  
Do të të dua më mirë.  
Qani pyje, fusha, gurë,  
Qani male me tëborë!  
Shqipëria mbet e gjorë  
Dhe nukë she dritë kurrë;  
Një mjegull keq e shkretë  
E ka mbuluar për jetë.  
E dashura mëmëdhe,  
Të dua dhe kshtu si je!  
Po kur të të sho të lirë  
Do të të dua më mirë!

Gjergj Fishta

### Gjuha shqipe

Porsi kanga e zogut t'veres,  
Që vallzon n'blerim të Prillit;  
Porsi i ambli flladi i eres,  
Që lmon gjit e drandofillit:  
Porsi vala e bregut t'detit  
Porsi gjâma e rrfës zhgjetare,  
Porsi ushtima e njëj termetit,  
Njashtû â' gjuha e jonë shqyptare.

Ndre Mjeda

### Guxo


Lundërtari që s'rezikohe  
Kur asht' deti shkum' e valë,  
Vetë me vedi mos t'ankohet  
Se i shkoi dita pa fitim.

Tuj u tall' e tuj pritue  
Kurrgjasend nuk qitet n'dritë;  
Çfarëdo sendi me fitue  
Trimni lypet e guxim.

Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Andon Zako Çajupi, Ndre Mjeda janë shkrimtarë të mëdhenj shqiptarë dhe figura të shquara të Rilindjes sonë Kombëtare. Gjithë jetën e tyre ata punuan për pavarësinë e vendit, kulturën shqiptare dhe gjuhën shqipe.



Naim Frashëri



Gjergj Fishta



A. Z. Çajupi



Ndre Mjeda

1. Përse flasin poezitë e mësipërme?
2. Flisni për mesazhet e rëndësishme që na sjellin poetët.
3. Pse këto mesazhe janë shumë të vlefshme dhe në ditët tona?
4. Me ndihmën e mësueses/it shkruaji sipas drejtshkrimit fjalët dialektore

**P. sh.: Toskërisht**  
*të rronjë*

**Me drejtshkrim**  
*të rrojë*

**Gegërisht**  
*i ambël*

**Me drejtshkrim**  
*i ëmbël*

- Zgjidh poezinë që të pëlqen më shumë dhe mësoje përmendsh. Kujdes, duhet të respektosh veçoritë e të folmeve dialektore.

# Dialektet e gjuhës shqipe

Gjuha shqipe ka **dy dialekte**: toskërishten dhe gegërishten. Në pjesën jugore të Shqipërisë dhe në disa zona në Maqedoninë e Veriut flitet dialekti i toskërishtes, ndërsa në pjesën veriore të Shqipërisë, në Kosovë, te shqiptarët e Malit të Zi, si dhe nga pjesa më e madhe e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut flitet dialekti i gegërishtes.

Dialektet e gjuhës shqipe janë shumë të rëndësishme. Ato janë pasuria më e madhe e gjuhës shqipe. Sa më mirë t'i njihni ato, aq më mirë do t'i kuptoni dhe do t'i shijoni veprat e bukura të shkrimtarëve shqiptarë.

Dallimet në dialektet e shqipes nuk janë të shumta.

Ato vihen re: **në përdorimin e tingujve (fonetikë)**

Fjalët me **â** (hundore) të gegërishtes

në toskërishte shqiptohen me **ë**. P.sh.:

nânë	nënë
âsht' (â)	është
âmbël	ëmbël
kânga	kënga
gjâma	gjëmë

Fjalët me **-n-** ndërmjet dy zanoreve

në toskërishte shqiptohen me **-r-**:

ve <u>n</u> a	ve <u>r</u> a
trim <u>n</u> i	trim <u>r</u> ë
ra <u>n</u> a	r <u>r</u> ë

Ndryshon shumësi i emrave mashkullorë:

brina	brinjë
demela	dembelë
pusa	puse

Disa fjalë përdoren vetëm në gegërishten ose vetëm në toskërishten:

dryn-çelës, ftyr- ftyrë  
rren-gënjën  
shpin-shplodh  
tinëz-fshehurazi  
tlyn-gjalpë  
kry-kokë

- Lexo edhe një herë me kujdes poezitë.  
Me ndihmën e mësueses/it gjej dallimet ndërmjet dialekteve.



## ■ Gjuha standarde shqipe

Ju u njohët me disa krijime në të dyja dialektet, që janë shkruar shumë kohë më parë. Ato tingëllojnë bukur, por ndryshojnë nga gjuha që ju mësoni në shkollë, dëgjoni në televizor ose lexoni në gazeta e revista. Poezitë: *Nuk e harron mëmëdhenë* dhe *Robëria* janë shkruar në toskërisht, kurse poezitë: *Guxo* dhe *Gjuha shqype* dhe tregimi *Lulja ma e bukur* janë shkruar në gegërisht.

Po ne ç'dialekt mësojmë, do të pyesni ju? Ju mësoni gjuhën standarde shqipe, e cila është mbështetur mbi këto dialekte.

Për gjuhën standarde shqipe gjuhëtarët kanë punuar për një kohë shumë të gjatë. Në vitin 1972, në ë, u mbledhën gjuhëtarët nga të gjitha viset shqiptare dhe mbajtën Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Aty u vendosën rregullat e gjuhës standarde. Kjo gjuhë përdoret si gjuhë zyrtare në të gjitha trevat ku jetojnë shqiptarët.

**Gjuha standarde përdoret në mjedise publike: në shkollë, në shtyp, në televizion, radio dhe në të gjitha dokumentet zyrtare.**



# Kur bie shi

Retë shkojnë palë-palë,  
kur bie shi.  
Lumi rritet valë-valë,  
kur bie shi.

Filladi këndshëm e njom arën,  
kur bie shi.  
Bujku gëzueshëm e hedh farën,  
kur bie shi.

Lulja e bukur çel te lumi,  
kur bie shi.  
Një djalë t' vocërr e zë gjumi,  
kur bie shi.

Mehmedali Hoxha



## KUPTO TEKSTIN

### Pyetje rreth tekstit

1. Si duket qielli kur bie shi?
2. Çka ndodh me lumin kur bie shi?
3. A gëzohet bujku kur bie shi? Pse?
4. Çka i ndodh lules kur bie shi?
5. Çka bën djali i vogël kur bie shi?
6. Në cilën stinë bie më tepër shi?

### Detyrë

Pse është i nevojshëm shiu?

- Gjej sa herë përsëritet vargu Kur bie shi \_\_\_\_\_.
- Gjej dhe lexo *fjalët e shkruara me vizë në mes*.
- Gjej dhe lexo fjalët që zëvendësojnë foljen fle.
- Gjej dhe lexo fjalët që zëvendëson foljen lag.

Mësoje vjershën përmendsh dhe recitoje bukur.



### Fjalorth

*flad* - erë e lehtë

*këndshëm* - që të kënaq kur e sheh ose e nuhat

*i vocërr* - i vogël



### Po ti?

Cilat ditë të pëlqejnë më shumë:  
me diell,  
me shi,  
me dëborë?  
Përkruaje ditën që të pëlqen  
më shumë.



## Vjeshta

Kur vjeshtës vendin i lë vera  
dhe zogjtë shtegtojnë larg e larg,  
nga pemët gjethet rrëzon era  
si fjongo të arta përmbi park.

Kur vjeshta vjen, zverdhon në vreshta  
bistaku i rrushit bukuri!  
Me begatinë që sjell vjeshta,  
gëzohem unë, gëzohesh ti.

O vjeshtë e artë, o stinë e zjarrtë,  
ti, mrekulli e punës sonë,  
nga fryti yt i begatë  
njeriut faqet i kuqojnë!

Xhevahir Spahiu

### KUPTO TEKSTIN

#### Pyetje rreth tekstit

1. Çfarë ndodh kur vjen stina e vjeshtës?

Zogjtë shtegtojnë

.....  
.....  
.....


2. Pse vjeshta quhet stinë e begatë?

3. Cilat vargje tregojnë se njeriu është i lidhur me natyrën?

Çfarë i japin ata njëri-tjetrit?

4. Çfarë ka ndier poeti, kur e ka shkruar këtë vjershë:

mall            brengë  
gëzim        keqardhje  
dashuri      inat?

 Çfarë tregojnë emrat e mësipërm?

#### Fjalorth

*fjongo* – shirit, zakonisht prej mëndafshi,  
me të cilin vajzat lidhin flokët.

*bistak* - veshi i rrushit.

*begati* - pasuri.

*fryti* - këtu: të mirat, prodhimet e tua.

#### Mëso!

Mbiemrat kur përdoren në poezi,  
tregime, përralla etj., quhen **epitete**.




## Thellohu në tekst

Poezia (vjersha) është një tekst i shkruar në **vargje**, që shpreh **ndjenja, emocione, gjendje shpirtërore dhe mendime** të poetit. Ideja a mendimi kryesor që e shtyn poetin të shkruajë një vjershë paraqet motivin. Motivet janë të shumta dhe të ndryshme. Poezia ka një gjuhë të veçantë nga proza.

### Dallimet

Poezia shkruhet në **vargje**.



Në prozë **fjalja nuk fillon me rresht të ri**, por vazhdon aty ku përfundon fjalja e mëparshme.

- Ja si do të ngjante kjo poezi në prozë.

Paragrafi 1

Vera iku dhe tani është vjeshtë. Zogjtë shtegtojnë për në vendet e nxehta. Era i rrëzon gjethet nga pemët. Ato ngjajnë si fjongo të arta.

Paragrafi 2

Vjeshta është një stinë e begatë. Ne i mbushim shportat plot me fruta: mollë, dardhë, rrush. Fytyrat e fëmijëve kuqëlojnë nga shëndeti.



## Kthehu te teksti

- Kthehu dhe një herë te poezia *Vjeshta*. Sa strofa ka ajo? Sa vargje ka çdo strofë? Dallo rimat e saj.

## Detyrë

- Analizo poezitë *Pëllumbi i bardhë* (f. 43), *Globi* (f. 44).
- Mëso vjershën përmendsh.

# Përshkruajmë tingujt dhe ngjyrat e vjeshtës

- Dëgjo me vëmendje leximin e mësueses.

Gjatë leximit të mësueses, me siguri të tërthorë vëmendjen fjalët që tregojnë zhurmat e tingujt. Ato janë të nënvizuara në tekst. Me ndihmën e tyre përshkrimi i vjeshtës bëhet shumë i gjallë e tërheqës.

Ti ke mësuar të përshkruash një person, një kafshë, një send. Por duhet të dish se përshkruhen edhe ngjyrat, edhe tingujt.

- Bëj një përshkrim të vjeshtës duke u ndalur te zhurmat dhe ngjyrat.

Thesi i fjalëve për ngjyrat e vjeshtës:

## E VERDHË

e artë

(e verdhë e shndritshme)

kanarinë (e verdhë e hapur, e shkëlqyeshme)

ngjyrë limoni (e verdhë e zbehtë që afrohet dhe me të gjelbrën)

ngjyrë gruri (e verdhë e çelët)

okër (e verdhë që vjen si e kuqe)

ngjyrë mjalti (që shkon drejt së verdhës së errët)

## Detyrë

- Përshkruaj një pemë në stinën e vjeshtës dhe më pas vizatoje.

## NË VJESHTË

Bambi, kaprolli i vogël, dëgjonte shushurimën e gjetheve që binin. Një fëshfëritje e pareshtur e kërcitëse vinte nga të gjitha degët. Një tingull i butë zbriste vazhdimisht nga lart. Sa mirë ta zinte gjumi nën atë ninullë mërmëritjesh!

Përtokë, gjethet e thara fëshfërinin dhe kërkëllinin të shtyra nga era. Bënin sh-sh-sh-sh-sh-sh me një tingull të mprehtë dhe të shkoqur. Pastaj erdhën shirat e vjeshtës. Binin me zhaurimë, nga mëngjesi në mbrëmje, duke kërcitur pa pushim nëpër ato pak gjethe të thata të mbetura ende në degë.

F. Salten

## E KUQE

vishnjë

(e kuqe e errët)  
e ndryshkur

(e kuqe në kafe)  
e kuqërremtë

(që vjen si e kuqe)

# Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm



Mbi bar çeli një lule.



Unë quhem Lule.




Në qiell ndriçon ylli.



Unë quhem Ylli.



Poshtë urës kalon një lumë.



Ky lumë është Drini i Zi



Unë kam një qen.



Qeni quhet Balo.

## Kujto

Gjej ç'loj emrash janë fjalët me ngjyrë të kaltër dhe ato me të kuqe.

Emrat që tregojnë njerëz, kafshë, sende e gjëra të tjera quhen emra të përgjithshëm.

Emrat e përveçëm janë emrat që u vëmë njerëzve, kafshëve, sendeve dhe vendeve për t'i dalluar nga të tjerët.

Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe.



## USHTROHU

1. Gjej emra të tjerë të përgjithshëm dhe të përveçëm sipas shembujve të mësipërm.

2. Vendos  tek emrat e përgjithshëm dhe  tek emrat e përveçëm.

- |                                 |                                |                                 |                                   |                                   |
|---------------------------------|--------------------------------|---------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| <input type="checkbox"/> djali  | <input type="checkbox"/> nëna  | <input type="checkbox"/> gjyshi | <input type="checkbox"/> era      | <input type="checkbox"/> kërmilli |
| <input type="checkbox"/> Agimi  | <input type="checkbox"/> mjeku | <input type="checkbox"/> Kiti   | <input type="checkbox"/> miza     | <input type="checkbox"/> Tetova   |
| <input type="checkbox"/> Mira   | <input type="checkbox"/> syzet | <input type="checkbox"/> flokët | <input type="checkbox"/> lepuri   | <input type="checkbox"/> breshka  |
| <input type="checkbox"/> kafazi | <input type="checkbox"/> Drita | <input type="checkbox"/> qeni   | <input type="checkbox"/> Kumanova | <input type="checkbox"/> Drini    |

3. Nënvizohet shkronjën që është shkruar gabim në fjalët e mëposhtme:

Mësuese arta  
usta Flamuri

nënë drita  
Doktor Astriti

Macja kiti  
qeni rodi

kukulla barbi  
këngëtare valbona

4. Cilët nga emrat e mëposhtëm përdoren edhe si emra njerëzish? Shkruaji ata me shkronjë të madhe.

shqiponja .....	zambaku .....	luani .....
drita .....	kanarina .....	hëna .....
kafazi .....	agimi .....	bilbili .....
trëndafili .....	era .....	vera .....

5. Emrat e nënvizuar ndaji në fletore sipas skemës së mëposhtme:

Dielli doli prapa malit. Fshati u zgjua nga kënga e gjelit. Nëna, babai dhe fshatarët e tjerë u ngritën herët në agim. U zgjuan edhe lopët, pulat, gjeli, qeni Rodi e macja Bjanka. Të gëzuar këtë mëngjes u zgjuan edhe Drita, Agimi dhe të gjithë fëmijët e tjerë. Ata do të shkonin nga Dragozhani në Manastir me autobus.

emra njerëzish	emra kafshësh	emra sendesh e të tjerë
të përgjithshëm   të përveçëm	të përgjithshëm   të përveçëm	të përgjithshëm   të përveçëm
nëna   Drita		

6. Plotëso fjalitë me emra të përveçëm.

- Unë jam (emri / mbiemri) ..... dhe jam nga (qyteti/fshati).....
- Po ti si quhesh dhe nga je?
- Unë quhem ..... dhe jam nga.....
- Të pëlqejnë kafshët?
- Po. Unë kam në shtëpi një qen të bukur. Atë e quajnë .....
- Një ditë në oborrin e pallatit tim ne gjetëm tre këlyshë qeni. Ne i quajtëm ....., ..... dhe ..... . Ata ishin shumë të bukur. Ne luanim me ta; edhe macja ..... vraponte pas nesh. Nëna e ..... na ndihmonte t'i ushqenim. U bëmë edhe një kolibe të madhe.

7. Gjej gabimet dhe shkruaje tekstin si duhet në fletore.

Në fundjavë unë me gjyshi gëzimin dhe nëna shpresën shkuam në strugë. Rrugës ne pamë shumë vende të bukura. Në strugë pamë liqenin e ohrit. Aty pamë dhe drinin e zi që kalon në mes të qytetit. Në antikë aty pranë kalonte rruga egnatia. Emri i vjetër i qytetit ishte enhallon.




# Gjinia e emrit (mashkullore dhe femërore)

## Kujto!

Emrat janë në gjininë mashkullore dhe femërore.  
Emrat e gjinisë mashkullore mbarojnë me: **-i** ose **-u**.  
Emrat e gjinisë femërore mbarojnë me: **-a** ose **-ja**.

Nxënësit po përgatiten për teatrin e shkollës. Një vajzë do të luajë rolin e Kësulëkuqes, ndërsa një djalë rolin e ujkut. Kësulëkuqja merr në dorë një shportë që ia jep mami. Vajza kalon nëpër skenën e vizatuar si një pyll. Rrugës ajo sheh një breshkë, një lepurush, një dre, një sorkadhe dhe një zog, që i cicëron pranë veshit. Arrin te shtëpia e gjyshes dhe sheh nga dritarja. Nuk duket gjë. E hap derën, e cila nuk ishte e mbyllur me çelës. Në vend të gjyshes në shtrat ishte ujku, por ajo nuk e kuptoi. Sa i frikshëm! Por gjahtari që kaloi aty më vonë, e vrau ujkun dhe i shpëtoi të dyja.



- Ndaj në tabelat përkatëse, sipas gjinisë, emrat e nënvizuar.

Emra njerëzish		Emra kafshësh	
mashkullore	femërore	mashkullore	femërore
		<b>zog- zogu</b>	
Emra vendesh		Emra sendesh	
mashkullore	femërore	mashkullore	femërore

Kur janë emra njerëzish ose kafshësh, gjinia e emrit përcaktohet nga gjinia e tyre:

vajza – djali; artisti – artistja; nxënësi – nxënësja;  
pula – gjeli; luan – luaneshë; macja – maçoku.

Por ka dhe raste që emrat e kafshëve dalin vetëm me të njëjtën formë për të dyja gjinitë:

dhelpra; gjirafa; papagalli; hipopotami; majmuni.

Ka raste kur emrat në gjininë femërore mbarojnë me -i:

**mami** (im) ose emër i përveçëm **Antigoni**.

Ka raste kur emri i gjinisë mashkullore del me -a ose -ja:

**daja** ose emër i përveçëm **Leka**.



# USHTROHU

## 1. Shkruaj emrat e gjinisë femërore përbri atyre të gjinisë mashkullore.

piktori	<u>piktorja</u>	skulptori .....	princi .....
mësuesi .....	shitësi .....	nxënësi .....	
mjeku .....	luani .....	mbreti .....	

## 2. Shkruaj emrat e gjinisë mashkullore përbri atyre të gjinisë femërore.

pula	<u>gjeli</u>	gjyshja .....	arusha .....
sportistja .....	tezja .....	halla .....	
këngëtarja .....	macja .....	pata .....	

Kujdes! Për të dalluar gjininë e emrit, ktheji ata në rasën emërore, në numrin njëjës.

## 3. Ngjyros me të kuqe emrat e gjinisë femërore dhe me të kaltër të gjinisë mashkullore. Thuaj si i dallove.

Sot ai djali i vogël, Marku, është bërë një shkrimtar i famshëm. Mamin e tij e quanin Eli, ndërsa babin Andrea. Marku i kishte sytë të zinj, flokët të kuq dhe fytyrën në formën e vezës.

Edhe tani që është i moshuar, sa herë pi një filxhan me çaj, i kujtohen biskotat me formën e lepurushit. Po më shumë nga të gjitha kujton puthjen e mamit kur vinte nata. Sa gëzim i sillte ajo! Kur mami ishte e zënë me punë dhe nuk vinte në dhomë, puthja quhej e humbur. Sa trishtim ndiente Marku!

Marku kujton shpesh kur së bashku me motrën dhe vëllanë shkonin te halla dhe te xhaxhai i tyre në fshat. Shtëpia e tyre ishte në mes gjelbërimit dhe ajrit të pastër. Kur shëtisnin, atyre u pëlqente shumë të hanin fruta pylli, luleshtrydhe e manaferra. Në mbrëmje shikonin një film me seri për fëmijë që u pëlqente shumë. Në mëngjes secili prej tyre kujdesej me kënaqësi për kafshët e veta. Marku kujdesej për kalin e bardhë, vëllai për papagallin, ndërsa motra për lopën laramane dhe për dhinë me zile. Secilin kujtim dhe secilën ndjesi Marku i ka shkruar në një libër. Motra e tij është bërë aktore, ndërsa vëllai veteriner.



## 4. Ndahuni në tri grupe. Secili grup të zgjedhë një nga tekstet e faqes 63. Dalloni emrat dhe ndajini në fletore sipas gjinisë.

## Gjinia e emrit. Gjinia asnjane



gazetari, gazetarja



maçoku, macja



topi, pema



të larët, të diturit

♦ Në ç'gjinj janë emrat gazetari, gazetarja, maçoku, macja, topi, pema? Thoni një mbiemër për secilin emër.

Emrat gazetari, maçoku janë në gjininë mashkullore, ndërsa gazetarja, macja janë në gjininë femërore. Meqenëse këta emra tregojnë frymorë, ne e përcaktojmë menjëherë gjininë e tyre, duke u nisur nga gjinia natyrore.

Në gjuhën shqipe të gjithë emrat kanë gjini. Ata janë të gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjane.

Emrat: topi, lapsi, libri, çelësi etj. janë në **gjininë mashkullore**.

Emrat: pema, molla, çanta, lulja etj. janë në **gjininë femërore**.

Emrat: të larët, të diturit, të folurit, të menduarit, të kuqtë etj. janë në **gjininë asnjane**.

### Vini re!

Disa emra që dikur ishin të gjinisë asnjane, sot njihen si emra të gjinisë mashkullore, p.sh.: dyllë, djathë, mish etj. Gjurmë të kësaj gjinie i gjejmë në shprehje të ndryshme frazeologjike ose në shprehje të tjera: më ngjethet mishtë, i nxori ujët e zi etj.

Emrat e gjinisë asnjane, si **kryet**, të **zitë**, të **folurit**, janë më të paktë se emrat e gjinisë mashkullore dhe femërore.

Janë të gjinisë **asnjane**: - disa emra të prejardhur nga foljet

- disa emra të prejardhur nga mbiemrat.

Pjesore e foljes	Emër asnjane	Mbiemër	Emër asnjane
ecur	të ecurit	i ftohtë	të ftohtët
folur	të folurit	i kuq	të kuqtë
menduar	të menduarit	i nxehtë	të nxehtët
vepruar	të vepruarit	i zi	të zitë



# USHTROHU

1. Ndani emrat e dhënë në tri grupe sipas gjinisë.

*këngë, disk, edukatore, laps, muzikë, të folur, njeri, arushë, fletë, të vepruar, makinë, telefon, gjuhë, kompjuter, ngjyrë, kub, shkronjë, alfabet, profesor, balerinë, lajm.*

Gjinia mashkullore	Gjinia femërore	Gjinia asnjëse

2. Ktheni në trajtën e shquar emrat e ushtrimit 1.

3. Ktheni emrat e mëposhtëm në gjininë femërore.

kunat .....	durrsak .....
gjysh .....	nip .....
gjel .....	dajë .....
shok .....	pëllumb .....

4. Lidhni emrat mashkullore me gjegjësit femërorë.

dhëndër	bashkëshorte
gjel	grua
burrë	motër
lojtar	pulë
bashkëshort	nuse
vëlla	lojtare

5. Formoni emra asnjës nga temat e mëposhtme:

ecur .....	i verdhë .....
ngrënë .....	qarë .....
i bardhë .....	bredhur.....





## Kur të shkosh, lum dreri

Kur të shkosh, lum dreri,  
të pish ujë te gurra  
ujin mos e ndal!  
Ujin e duan zogjtë  
që këndojnë në mal.

Kur fluturon, lum zogu,  
të këndosh në degë të pemës,  
Mollën mos e shkund!  
Mollën e dua unë  
për mësuesen në katund.

Vehbi Kikaj



Gjërat më të dashura të mësueses, Keli Uoker



### KUPTO TEKSTIN

#### Pyetje rreth tekstit

1. Kujt i drejtohet fëmija? Shkruaj:  
në strofën e parë ..... në strofën e dytë .....
2. Për kë kujdeset fëmija? Shkruaj:  
në strofën e parë ..... në strofën e dytë .....
3. Si shprehet dashuria e fëmijës për natyrën dhe për mësuesen?
4. Shiko pikturën dhe titullin e saj "Gjërat më të dashura të mësueses". Molla tregon shëndet dhe bukuri. Librat tregojnë dituri. Flisni për lidhjen e mësueses me këto të dyja.

#### Po ti?

- Përse fëmijët i duan shumë mësueset ose mësuesit e tyre? Plotëso:

Unë e dua mësuesen ose mësuesin, sepse: .....

.....

.....

.....

.....

.....

## ■ Pëllumbi i bardhë



Atij pëllumbi të bardhë  
(në botë më i miri),  
që në sqep fort mban  
një degëz ulliri...

Atij pëllumbi të lehtë  
që po fluturon,  
i besoj vërtet  
kur Dreni e pikturon..

Në sytë e tij ninëzat  
e tua po shkrihen,  
e në zemër ritmet  
me tuat përtërihen...

Vizatoje, ngrije n'erë  
duke e mbajtur në dorë,  
sille disa herë  
rreth globit tokësor!

Rifat Kukaj

### KUPTO TEKSTIN

#### Pyetje rreth tekstit

1. A ju pëlqen pëllumbi? Pse:  
ka ngjyrë të bardhë,

.....,  
është shpend i butë,

.....,

2. Në cilat vargje i krahason poeti:

- sytë e fëmijës me sytë e zogut, - ritmet e zemrës së pëllumbit me ato të fëmijës?

3. Çfarë tregon dega e ullirit? Pse të rriturit e quajnë pëllumbin shpendi i paqes? Cili është mesazhi që na jep poeti në strofën e fundit?

#### Detyrë

- Mësoje vjershën përmendsh dhe recitoje me zë të ëmbël.
- Vizato dhe ti një pëllumb me flatrat e hapura duke fluturuar.



#### Fjalorth

*ninëz/ë* - bebja e syrit.

*përtërihet* - shtohen.

*gjallërohen* - marrin fuqi të reja.

# Thirrjet dhe mesazhet

## GLOBI

Le t'u japim globin fëmijëve, të paktën për një ditë.

T'ua japim që të lozin, si me një top me ngjyra.

Të lozin, të këndojnë, atje lart mes yjesh.

Le t'u japim globin fëmijëve,

t'ua japim si një mollë të jashtëzakonshme.

Si një rrotë buke të ngrohtë,

që të paktën një ditë ta ngopin urinë e tyre.

Le t'u japim globin fëmijëve,

që të paktën për një ditë, globi të dijë ç'është shoqëria.

Fëmijët do ta marrin globin nga duart tona,

dhe do ta mbjellin me drurë të pavdekshëm.



Nazim Hikmet, përktheu Atalanta Pasko

- Kjo poezi është shkruar si një thirrje, me anën e së cilës poeti i drejtohet botës së të rriturve. Vështro se si shkruhen vargjet:

T'ua japim  
që të lozin, si me një top me ngjyra,  
që të këndojnë, atje lart mes yjesh,  
që të paktën një ditë ta ngopin urinë e tyre,  
që globi të dijë ç'është shoqëria.

- Shkruaj dhe ti katër fjali, duke ndjekur shembullin e mësipërm.

P. sh.:

Na jepni dashuri, që bota të mbushet me mirësi,

Na jepni .....


.....

THIRRJET janë shkrime të shkurtra, me anë të së cilave një njeri ose një shoqatë u drejtohet njerëzve. Me anë të thirrjes, njerëzit nxiten për të marrë pjesë në një veprimtari të caktuar.

# Numri i emrit

## Kujto!

Emrat janë në numrin njëjës dhe në numrin shumës. Emrat në numrin njëjës tregojnë vetëm një njeri, një kafshë a një send. Emrat në numrin shumës tregojnë dy a më shumë njerëz, kafshë a sende.



## 1. Lexo tekstin e mëposhtëm dhe ngjyros me të kuqe emrat në njëjës dhe me të kaltër në shumës.

Çdo ditë Mogli shikonte nëse ishte ndonjë nga katër vëllezërit e tij te shkëmbi në fund të luginës. Pastaj i shtynte buajt nëpër fusha. Me të shkuar aty flinte, zgjohej, flinte përsëri i shtrirë nën pemë. Thurte shporta me bar të thatë dhe i mbushte me karkaleca; shikonte gjarpërinjtë që ngroheshin në diell ose ata që gjuanin bretkosa pranë pellgjeve. Ndonjëherë ndërtonte me baltë kështjella dhe figura njerëzish, kuajsh dhe buajsh. Te duart e njerëzve vendoste disa shkopinj, që dukeshin si ushtarë dhe vetë hiqej si mbreti i tyre. Ai kthehej çdo natë në fshat të bashkohej me burrat që kuvendonin: ishte kryetari, roja, berberi.

Emrat e **gjinisë mashkullore** në numrin shumës dalin:

- |  |   |  |
|--|---|--|
| ▪ si në numrin njëjës<br>një blerës – disa blerës<br>një shitës – shumë shitës | ▪ me <b>-a</b> :<br>një stol – disa stola<br>një libër – ca libra | ▪ me <b>-ë</b> :<br>një kryetar – disa kryetarë<br>një shofer – disa shoferë |
| ▪ me <b>-e</b> :<br>një qytet – disa qytete<br>mendim – ca mendime             | ▪ me <b>-ra</b> :<br>një mall – ca mallra<br>shi – disa shira.    |  |

Ka emra të gjinisë mashkullore që **pësojnë ndryshime**, kur përdoren në shumës:

- |                               |                              |
|-------------------------------|------------------------------|
| një gjarpër – disa gjarpërinj | një kushëri – disa kushërinj |
| një kalë – disa kuaj          | një djalë – disa djem        |
| një pellg – disa pellgje      | një vëlla – disa vëllezër    |
| një dru – disa drurë          | një dre – disa drerë.        |

- Shto nga një shembull për çdo rast.

Emrat e **gjinisë femërore** në numrin shumës dalin:

- si në numrin njëjës  
një tablo – disa tablo  
shitëse – shitëse  
një shami – disa shami

- me **-a**:  
një fushë – disa fusha  
një pulë – disa pula  
një gomë – disa goma

Ka emra të gjinisë femërore që **pësojnë ndryshime**, kur përdoren në shumës:  
një derë – disa dyer  
një natë – disa net.

• Shto nga një shembull për çdo rast.



## USHTROHU

2. Vendos në tabelë emrat *mik, djalë, libra, çanta, oborr, pemë, gjel, pula, tablo, fletore, rrugë, detyra, semaforë* duke shtuar para secilit emër *një* ose *disa*.

Gjinia mashkullore		Gjinia femërore	
Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
një mik			

3. Emrat në shumës ktheji në njëjës dhe emrat në njëjës ktheji në shumës. Nënvizu emrat që nuk ndryshuan.

Gjinia mashkullore				Gjinia femërore			
Sh	Nj	Nj	Sh	Nj	Sh	Sh	Nj
rreziqe.....		këngëtar.....		mollë .....		arka .....	
trena .....		plak .....		dritare .....		shpella .....	
numra.....		dru .....		errësirë .....		dëshira .....	
ujqër .....		polic .....		figurë .....		detyra .....	
pyje .....		bir .....		mjeke .....		festa .....	
drerë .....		fshat .....		rrugë .....		dyer .....	
divane.....		mall .....		lundër .....		tablo .....	

4. Ngjyros me të kuqe emrat që dalin me **-ë, -a** ose **-e** dhe me të kaltër emrat që pësojnë ndryshime.



# Ushtrime për gjininë dhe numrin e emrit

1. Nënvizto me të kuqe emrat në numrin njëjës dhe me të kaltë emrat në numrin shumës. Një ditë luani u sëmur. Ai lajmëroi të gjitha kafshët. Donte t'u thoshte dëshirat dhe porositë e tij të fundit. Në fillim në shpellë hyri dhia. Pas saj u fut delja. Më pas hyri viçi të dëgjonte amanetet e mbretit. Pas pak luani u ndie më mirë. Doli nga guva dhe pa dhelpren. Ajo kishte shumë kohë aty, por kishte frikë të hynte.

2. Shkruaji në tabelë emrat që gjete në ushtrimin 1, pastaj ktheji sipas shembullit.

Emra të gjinisë mashkullore		Emra të gjinisë femërore	
Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
një luan	disa luanë	një kafshë	disa kafshë

3. Rretho **M** për emrat mashkullorë, **F** për emrat femërorë, **Nj** për emrat në njëjës, **Sh** për emrat në shumës. Shiko shembullin.

oxhakë <b>(M)</b> F Nj <b>(Sh)</b>	brisqe M F Nj Sh	peshq M F Nj Sh
trena M F Nj Sh	sportist M F Nj Sh	divane M F Nj Sh
rrugë M F Nj Sh	drerë M F Nj Sh	fshatra M F Nj Sh
figura M F Nj Sh	ujk M F Nj Sh	mollë M F Nj Sh
kolltukë M F Nj Sh	mjeke M F Nj Sh	romane M F Nj Sh
dru M F Nj Sh	policë M F Nj Sh	numra M F Nj Sh

## Mbaj mend!

Emrat e gjinisë mashkullore që në shumës mbarojnë me **e**, **-ra** kthehen në gjininë femërore. P.sh.: mal - male, qytet - qyete, ujë - ujëra, fshat - fshatra, shi - shira etj.

4. Vendos në tabelë emrat: *heshtje, dorë, diskutim, plak, legjenda, letra, libra, çantë, lule, piktura, rrugë, fletë, kuti, shitës, mësues, fole, flokë, fëmijë.*

Emra të gjinisë mashkullore		Emra të gjinisë femërore	
Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës

## Kujdes!

Ka emra që dalin njësoj si në njëjës dhe në shumës.

# ■ Agimesha e ngujuar në shtatë shpella

## Pamja e tretë

(Pasi shpëton Agimesha e ngujuar nga Ujku)

TË GJITHË (këndojnë):

*Shumë të pritëm të vish ndër ne*

*Të na mbushësh me hare,*

*Tash që jemi të gjithë tok*

*Zemrën frika s'na e rrok. (2 herë)*

(Pasi ia thonë këngës, e futin AGIMESHËN në mes dhe e mbulojnë me pyetje të ndryshme)

LEPURI: Çka je ti, Agimeshë?

AGIMESHA: Unë jam ylli i mëngjesit, një udhëtar i largët.

ARIU: Prej nga vjen, Agimeshë?

AGIMESHA: Vij prej prapa shtatë maleve, shtatë fushave, shtatë lumenjve, shtatë qyteteve...

VJEDULLA: A ke trup, apo mos je hije?

AGIMESHA: S'kam trup, po s'jam as hije.

LEPURI: Kur s'ke trup e s'je as hije, ç'mund të jesh atëherë?

AGIMESHA: Jam vullneti i fëmijëve, dëshira e tyre, gëzimi i tyre, ëndrra e tyre.

DRERI: Po si mund të dukesh kështu, pra?

AGIMESHA: Dukem ashtu si më dëshirojnë fëmijët. Ata shpresonin se unë do të vija dhe unë, siç e shihni, erdha. Shpresat fëmijëve nuk ua thyej. Prandaj bëhem gëzimi i tyre, kënga e tyre, ëndrra e tyre dhe më në fund realizimi i gjithë dëshirave të tyre. Unë s'i dua fëmijët përtacë, as lazdrakët, as inatçorët nuk i dua. As fëmijët që nuk janë të zellshëm në shkollë nuk i dua fare. Ja, pra, unë jam kjo që jam dhe jam kështu si jam.

LEPURI: Harrove të thuash një send, moj Agimeshë!

AGIMESHA: Çka, për shembull?

LEPURI: Nuk fole asgjë për harmoninë midis kafshëve, atë që ne e dëshirojmë.

VJEDULLA: Po, po, edhe për bashkimin nuk the gjë!

AGIMESHA: Harmoninë e bëjnë vetëm ata që e pastrojnë zemrën nga e keqja, që



e pastrojnë trurin nga mendimet e këqija. Kur të punohet për harmoninë, edhe bashkimi vjen. Kur të punohet për bashkimin, edhe harmonia vjen si dhuratë. Duhet të duheni, njëri-tjetrin ta doni si veten dhe bashkimin ta ruani si ruhen sytë. A më kuptuat?

TË GJITHË (këndojnë):

*Bashkimi, vëllezër, bën fuqinë,  
Dashuria sjell lumturinë.  
Kush fut grindje e shamatë,  
Nuk ka kurrë jetë të gjatë! (2 herë)*



## KUPTO TEKSTIN

### Pyetje rreth tekstit

1. Çfarë është Agimesha?
2. Si duket Agimesha?
3. Për çfarë harroi të fliste Agimesha?

### Kthehu te teksti

1. Gjej në tekst se çfarë bëhet Agimesha për fëmijët:

Bëhem gëzimi i tyre;

.....  
.....  
.....

2. Gjej në tekst se cilët fëmijë nuk i do Agimesha:

Unë s'i dua fëmijët .....

.....  
.....  
.....

### Po ti?

1. Çfarë dëshirash do të doje të të realizonte Agimesha ty?
2. Provo ta vendosësh veten në vend të Agimeshës. Çfarë dëshirash do t'u plotësoje fëmijëve?

### Detyra

- ◆ Komento me fjalët e tua thënien e fundit të Agimeshës:  
Duhet të duheni, njëri-tjetrin ta doni si veten dhe bashkimin ta ruani si ruhen sytë.
- ◆ Provoni ta luani pjesën me role në klasë.

# TEATRI I SHKOLLËS



## ■ Gjiganti prej akulli

### AUTORJA:

Në një vend shuumë të largët, që quhet Laponi... kurrë nuk duhet të futesh në pyll në mbrëmje, sepse natën në të mbretëron gjiganti i llahtarshëm i akullit.

### UDHËTARI 1:

E vetmja mënyrë për t'i shpëtuar, është të ndezësh një zjarr, sapo të bjerë nata. Vetëm kështu mund ta mbash larg atë. Gjiganti prej akulli nuk guxon t'i afrohet zjarrit, nga frika se mos shkrin i tëri.

### UDHËTARI 2:

Ditmiri po kalon nëpër pyll, për t'u kthyer në shtëpi. Sa shumë nxiton! Ai do që të mbërrijë në shtëpi para se të bjerë nata. Por flokët e mëdhenj të dëborës e pengojnë dhe Ditmiri nuk sheh pothuajse asgjë.

### UDHËTARI 3:

Dhe, më e keqja, po bëhet natë. Ditmiri dridhet nga të ftohtit dhe frika.

### MONOLOGU I DITMIRIT (duke kërkuar nëpër xhepa)

Shkrepëset! Shpejt shkrepëset! I shkreti unë! Me zor gjeta vetëm tri fije qesharake. E para, e zezë e gjitha, shkrumb e djegur, e përvëlur. E dyta, e thyer copë-copë. Sa për të tretën, ajo është e mirë, e pathyer, e padjegur, por s'kam kuti për ta ndezur.

### UDHËTARI 4:

Shikoni, një hije e madhe po rrëshqet midis pemëve.

**DITMIRI:** Obobooo! Gjiganti i dëborës po afrohet.



(Dëbora kërcet nga hapat e Gjigantit dhe degët e pemëve thyhen. Përbindëshi qëndron përpara tij, aq i madh, sa edhe hënën e mbulon.)

**DITMIRI:** Booboo, i mjeri unë! Olele, olele ... ç'më gjeti!

**GJIGANTI I AKULLIT:** Ahaa! Ahaa! Ahaa! Ja dhe një tjetër që i futa tmerrin. (Tallet Gjiganti me zë të tmerrshëm.)

**DITMIRI:** Nuk po qaj prej teje (Ditmiri flet duke tërhequr hundët. Gjiganti i akullit shkul një pemë nga inati.)

**DITMIRI:** Po qaj për këto shkrepëset magjike.

**GJIGANTI I AKULLIT:** Prit t'i shoh?!

**DITMIRI:** Sapo m'i dha një xhind i pyllit. Ai më tha se njëra nga këto tri shkrepëse është magjike dhe të realizon çdo dëshirë.

**GJIGANTI I AKULLIT:** Xhindi i pyllit?!

**DITMIRI:** Po, vetëm se, ja, shikoje vetë, e fërkova fijen e parë dhe nuk ndodhi asgjë. Kur doja të fërkoja të dytën, ajo u thye dhe...

**GJIGANTI I AKULLIT:** Fija e fundit qenka magjikja, domethënë!

**DITMIRI:** Kështu mendoj dhe unë, vetëm se më humbi kutia dhe nuk kam me çfarë ta ndez.

**GJIGANTI I AKULLIT:** Ku të humbi?

**DITMIRI:** Ja andej... (tregon me gisht mes errësirës së bredhave) Fillova ta kërkoj, por ra dëborë dhe tani më duket se do t'ia filloj nga e para. (Këmbadoras, Gjiganti gërmon kudo nëpër dëborë për të gjetur kutinë e shkrepëseve. Duke kërkuar, largohet shumë nga Ditmiri.)

**AUTORJA:**

Kështu gjiganti i akullit as e kuptoi që dita po zbardhte. Kur e ndjeu më në fund diellin, ishte shumë vonë. Nga nxehtësia e lanë forcat. Këmbët iu shkrinë, kurrizi po ashtu.

### TË GJITHË SË BASHKU

Ha-ha-ha nga gjiganti i frikshëm mbeti një pellg ujë. Ditmiri shpëtoi dhe jetoi përgjithmonë i lumtur.

*"Përralla që të futin dridhmat", Sofi Mullenheim,  
përktheu: M. Mema*





a. Mëso më shumë për tekstin e dramës.

### Gjiganti prej akulli

#### AUTORJA

Në një vend shuumë të largët, që quhet Laponi... kurë nuk dihet të futesh në pyll në mbremje, sepse natën në të mbretëron gjiganti i lahtarshëm i akullit.

#### UDHËTARË

E vetrja mënyrë për t'i shpëtuar, është të ndezësh një zjar, sapo të bjerë nata. Vetëm kështu mund ta mbash larg atë. Gjiganti i akullit nuk guxon t'i afrohet zjarrit, nga frika se mos shkorr i tarr.

#### UDHËTARË

Ditmiri po kalon nëpër pyll, për t'u kthyer në shtëpi. Sa shumë nxiton! Ai do që të mbërrijë në shtëpi para se të bjerë nata. Por Tokët e mëdhenj të dëborës e pengojnë dhe Ditmiri nuk sheh pothuajse asgjë.

#### UDHËTARË

Dhe, më e keqja, po bëhet natë. Ditmiri dridhet nga të ftohtit dhe frika.

(duke kërkuar nëpër xhepat)

Shkopëset! Shpejt shkopëset! I shkretë unat! Me zor gjeta vetëm tri fije qesharake. E para, e zehtë e gjitha, shkumb e djegur, e përvëluar. E dyta, e thyer copë-copë. Sa për të tretën, ajo është e mirë, e pathyer, e padjegut, por s'kam kull për ta ndezur.

#### UDHËTARË

Shikoni, një hije e madhe po rëshqet midis pemëve.

Oboboo! Gjiganti i dëborës po afrohet.

Monolog kemi atëherë kur personazhi flet me vete duke u drejtuar nga publiku.

Dialog kemi kur dy ose më shumë personazhe bisedojnë me njëri-tjetrin.

Fjalët e pjerrëta në kllapa quhen didaskali. Ato janë sqarimet që bën autori.

b. Përgatitja për shfaqje

1. Ndani rolet dhe përgatitni veshjet:



AUTORJA – zgjidhni njëren nga vajzat e klasës që lexon më rrjedhshëm.



4 UDHËTARË – zgjidhni dy vajza dhe katër djem, që dinë të lexojnë bukur dhe me intonacionin e duhur, për të luajtur rolet.



DITMIRI – zgjidhni njërin nga djemtë që është më i zoti për të aktruar.



GJIGANTI I AKULLIT – zgjidhni djalin më trupmadh të klasës për këtë rol.

2. Bëni skenën me një karton të madh, ku do të pikturoni pyllin e frikshëm në dimër.

Të tjerët do të ndihmojnë për përgatitjen e shfaqjes, përgatitjen e skenës, muzikën, veshjet etj. Gjithashtu, do të hartoni tekstin e një njoftimi dhe të një ftese.



Njoftim

Ditën e ..... dt .....

.....

.....

.....

Ftesë

Jeni të ftuar në .....


.....

.....

.....

# Thirrja, ftesa për në shkollë (shfaqje etj.)

1. Kur ke marrë për herë të fundit ftesë për ndonjë rast (festë, ditëlindje etj.)?
  2. Në çfarë ngjarje ke qenë i ftuar?
  3. A ke pasur ndonjë thirrje për të mësuar?
- Ja se si mund të duket ftesa (thirrja):



## BISEDOJMË:

1. Për cilët është shkruar ky tekst?
2. Cilët e bëjnë ftesën në këtë rast?
3. Çfarë do të zhvillohet (paraqitet etj.) atje?
4. Kur do të mbahet shfaqja?
5. Ku do të mbahet shfaqja?

## MENDOJMË

Ftesa është një tekst i shkurtër informativ me të cilin thërrasim për të marrë pjesë në ndonjë ngjarje të rëndësishme. Ajo shkruhet në tri pjesë:

1. fjalët hyrëse
2. përmbajtja (kush, çka, ku, kur, përse)
3. mbyllja (përshëndetja dhe nënshkrimi)

Teksti duhet të shkruhet drejt dhe pa gabime gramatikore dhe drejtshkrimore.

## KRIJOJMË

Shkruaj dhe rregulloje nga ana estetike një ftesë për ditëlindjen tënde.

Ftesa duhet t'i përmbajë të gjitha të dhënat e duhura, por asaj mund t'i shtoni edhe informacione të tjera interesante.

# Mbiemri i nyjshëm dhe i panyjshëm

Për festën e mësueses, fëmijët e vegjël këndojnë një këngë të gëzuar në kopshtin e gjelbëruar. Ana flokëkuqe drejton korin. Beni flokëverdhe dhe Andi flokëzi shoqërojnë vajzat. Ç'fëmijë të hareshëm dhe entuziastë!

## Kujto

Mbiemrat tregojnë se si janë njerëzit, kafshët, sendet.



Mbiemri qëndron zakonisht pas emrit dhe tregon cilësinë e tij. Mbiemri e bën më të qartë dhe më të plotë kuptimin e emrit.

Mbiemrat janë:

të nyjshëm: e vegjël, .....

të panyjshëm: flokëkuqe, .....

	Numri njëjës	Numri shumës
Gjinia mashkullore:	kopsht i madh, djalë gazmor,	djem të shkathët, djem gazmorë
Gjinia femërore:	këngë e bukur, vajzë simpatike,	vajza të vogla, vajza simpatike



## USHTROHU

1. Nënvizohet me të kuqe mbiemrat e nyjshëm dhe me të kaltër mbiemrat e panyjshëm. i ëmbël, i athët, kundërmues, i rëndë, i fortë, i mprehtë, i lartë, i zi, gri, i gjelbër, i qetë, i trishtuar, kaçurrel, serioz, i thjeshtë, kryelartë, krenar, mendjemadh, i gjatë, mesatar, thatanik.

2. Lidh mbiemrin me emrin.

aromë	e ëmbël	djalë	zeshkane	nxënës	e hijshme
limon	i fortë	vajzë	mesatar	sjellje	simpatik
mollë	i thartë	trup	të zinj	vajzë	guximtare
ftua	e këndshme	flokë	i gjatë	djalë	shembullor

### 3. Shkruaj mbiemrat e nyjshëm dhe mbiemrat e panyjshëm.

Andi i vogël jeton pranë një zonje të moshuar. Zonja punon tërë ditën në një makinë qepëse. Ajo qep përparëse të bukura. Puna e madhe e pengon zonjën të gatujë. Andi zemërmirë kujdeset shumë për të. Ai sot do t'i përgatisë një drekë të shijshme. Këputi në kopsht sallatë jeshile e rrepa të kuqe. Në një tenxhere të madhe zjeu patate të mëdha. Zonja Fink e falënderoi Andin e papërtuar për gjellën e shijshme.

mbiemra të nyjshëm

mbiemra të panyjshëm

.....

.....

.....

### 4. Hiq mbiemrin që nuk i përket emrit të frutës.



Mollë e kuqe / e fortë / majoshe / katrore / e rrumbullakët

Dardhë e verdhë / e gjelbër / e butë / e ëmbël / e zezë

Rrush i zi / kokërrmadh / i hidhur / i fortë / i ëmbël

Portokall i kuq / portokalli / këndor / i pjekur

### 5. Nënvizu me të kuqe mbiemrat e nyjshëm dhe me të kaltër mbiemrat e panyjshëm. Korrigjo mbiemrat e shkruar gabim.

1. Nga kuzhina vinte një aromë kundërmues. Aroma ishte e fortë dhe e këndshme.
2. Hyj në kuzhinën e pastër. Aty shikoj gjyshen e kënaqur.
3. Gjyshja po gatuate për drekë një pulë të pjekur.
4. Ajo i hodhi pulës erëza pikante.

### 6. Plotëso fjalitë e mëposhtme me mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm në kllapa (e madhe, e madh, të ndryshme, e shumta, të verdha, të këndshme, gazmor, të gjelbra).

Unë me motrën \_\_\_\_\_ shkuam në tregun e perimeve.

Në arkat \_\_\_\_\_ kishte mollë të kuqe, \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_,

Aty kishte edhe perime \_\_\_\_\_.

Frutat lëshonin aroma \_\_\_\_\_.

Shitësi \_\_\_\_\_ u shërbente klientëve.

Motra atë ditë shkoi edhe në tregun \_\_\_\_\_.



# Gjinia dhe numri i mbiemrit

## Kujto!

Mbiemri tregon cilësinë e emrit. Ai është në gjininë femërore dhe në gjininë mashkullore, në numrin njëjës dhe në shumës.

- Lexo fjalët poshtë figurave dhe plotëso vendet bosh.



vajzë **e** .....



vajza **të** vogla



djalë **i** vogël



djem **të** .....

Gjinia e mbiemrave të nyjshëm dallohet nga nyjat.  
Në gjininë mashkullore, mbiemri merr nyjat:

**i** – numri njëjës  
peshk **i** kuq

**të** – numri shumës  
peshq **të** kuq

Në gjininë femërore, mbiemri merr nyjat:

**e** – numri njëjës  
lule **e** kuqe

**të** – numri shumës  
lule **të** kuqe

## Mbaj mend!

Mbiemrat e panyjshëm të gjinisë femërore mbarojnë zakonisht me -e. P.sh.:

në njëjës:

*djalë gazmor - vajzë gazmore*

në shumës:

*djem gazmorë - vajza gazmore*



## USHTROHU

### 1. Lidh mbiemrin me emrin. Thuaj gjininë e mbiemrit.

aromë	e ëmbël	djalë	zeshkane	dru	i hijshëm
limon	i fortë	vajzë	bardhosh	sjellje	i rrezikshëm
mollë	i thartë	trup	i shpupuritur	kryqëzim	i shtrembër
ftua	e këndshme	flok	i gjatë	djalë	shembullore

### 2. Lidh mbiemrin me emrin. Thuaj numrin e mbiemrit.

djalë	e madhe	zonjë	e moshuar	makinë	e shijshme	përparëse	e shijshme
punë	të kuqe	djalë	të mëdha	drekë	qepëse	sallatë	të bukura
rrepa	i vogël	tenxhere	zemërmirë	patate	të mëdha	gjellë	e gjelbër

### 3. Shkruaj në fletore katër fjali, ku të ketë mbiemra të gjinisë femërore e mashkullore, në numrin njëjës e shumës.

# ■ Përshtatja e mbiemrit me emrin

**Nënvizo emrat së bashku me mbiemrat që i shoqërojnë.  
Thuaj gjininë dhe numrin e emrit dhe të mbiemrit.**

Në mbrëmje doli një hënë **rumbullake** dhe e shndritshme. Ajo ndriçoi tërë natën hapësirat e gjera të mbuluara me dëborë. Kur Peteri, si një ditë më parë, u hodh nga parmaku i lartë i shkallëve mbi dëborën e trashë, i ndodhi një e papritur. Në vend që të zhytej në dëborën e shkriçet, u përplas mbi një truall të fortë dhe rrëshqiti tatëpjetë brinjës së pjerrët. Sipërfaqja e ngirë e kish bërë të rrëshqiste poshtë.



Mbiemri **përshtatet me emrin** që shoqëron:  
në gjini: *hënë rumbullake, diell rumbullak;*  
në numër: *hapësirë e gjerë, hapësira të gjera;*

Mbiemri është në numrin që ka edhe emri.  
Emri njëjës, mbiemri njëjës; emri shumës, mbiemri shumës.

Mbiemri merr gjininë, numrin dhe rasën e emrit që cilëson.



## USHTROHU

1. Lidh emrin me mbiemrin.

Kujdes gjininë.

ëmbëlsirë	e ëmbël
qytet	i madh
muzikë	e shijshme
trafik	i çmuar
përgjegjësi	i dendur
mendim	e madhe

2. Lidh emrin me mbiemrin.

Kujdes numrin.

lumenj	të rrëmbyer
breg	e madhe
shkollë	të gjera
rrugë	i thepisur
dyer	i pastër
oborr	të mëdha

3. Ktheji në numrin shumës ose në njëjës grupet e fjalëve të mëposhtme.

Nënvizo çfarë ndodhi te mbiemri.

kapelë e kuqe	.....	djem të vegjël	.....
tabelë e zezë	.....	nxënës vullnetarë	.....
pemë e lartë	.....	xhepa të fshehtë	.....
grua e moshuar	.....	trëndafila të kuq	.....


4. Shkruaji mbiemrat në kllapa në rasën e duhur. Nënvizo çfarë ndodhi te mbiemri.

diellin (i nxehtë)	.....	djemve (i vogël)	.....
tabelës (i zi)	.....	kalit (qimekuq)	.....
pemëve (i lartë)	.....	i xhepit (i fshehtë)	.....
grave (i moshuar)	.....	trëndafili (i kuq)	.....

# Teatri dhe kinemaja

Shfaqja, si në teatër dhe në kinema, realizohet përmes lojës së aktorëve. Në një shfaqje teatri, loja e aktorëve është e drejtpërdrejtë. Ndërsa në film loja e aktorëve regjistrohet në shiritin e filmit.

Teatri u krijua në Greqinë e Lashtë, rreth shek. VI p.K. Në fillim shfaqeshin vetëm tragjedi dhe komedi. Në tragjedi fundi i shfaqjes është i hidhur dhe ndodhin ngjarje tragjike. Në komedi fundi i shfaqjes është i lumtur dhe komedia të bën për të qeshur.



Kinemaja u krijua nga Vëllezërit Lumjer në shekullin XIX. Fillimisht filmat ishin bardhezi dhe pa zë. Pastaj u shtua zëri dhe më pas ngjyrat. Në fillim filmat janë shfaqur në kinema, në ekrane të mëdha. Pastaj, kur u shpik televizori, filmat u shfaqën dhe në ekranin e vogël.



## KUPTO TEKSTIN


### Pyetje rreth tekstit

1. Çfarë është teatri?
2. Çfarë është kinemaja?
3. Ku dallon teatri nga kinemaja?

### Detyrë

- Shkruaj mbresat që të ka lënë një film ose një shfaqje teatrale që të ka pëlqyer më shumë.

# ■ Princeshë Ardita



1.

Na ishte njëherë një mbret, i cili kishte një vajzë të bukur e të zgjuar, princeshën Ardita. Shumë princa e kapitenë dëshironin të martoheshin me princeshën, por ajo i kishte thënë mbretit:

– Baba, unë do të martohem me atë burrë që di të fshihet më mirë.

Të gjithë princat e kapitenët filluan të gjenin vende për t'u fshehur. Por princesha Ardita kishte një teleskop të veçantë, me të cilin shihte tërë qiellin dhe në thellësitë më të mëdha të detit. Dhe kështu i gjente të gjithë.

Në këtë vend, asokohe, jetonte një djalë i ri. Ai quhej Agim.

Agimi nuk ishte i pasur, por kishte tri gjëra të çmuara, që i kishte fituar duke ndihmuar të tjerët. Një ditë Agimi ndihmoi një peshk të kuq që kishte ngecur mes gurëve në breg dhe nuk dilte dot. Agimi e hodhi në ujë dhe peshku i dhuroi një guralec dhe i tha:

– Merre këtë guralec! Kur të ndodhesh në rrezik, hidhe atë në ujë dhe thirr: "Peshk, o peshk, më ndihmo e më sill fat".

Një ditë tjetër Agimi shpëtoi një shqiponjë, së cilës i kish ngecur këmba në një rrjetë. Kur Agimi e liroi, ajo i tha:

– Merre këtë pendë! Nëse ndonjëherë do të ndodhesh ngushtë, hidhe atë në ajër dhe thirr:

"Shqiponjë, o shqiponjë, më ndihmo e më sill fat."

Një natë Agimi shpëtoi një dhelpër që i kishte ngecur këmba e prapme në një kurth arinjsh. Kur Agimi e liroi nga kurthi, edhe dhelpëra i tha:


– Merri këto tri qime! Nëse ndonjëherë ndodhesh ngushtë, hidhi këto qime në zjarr dhe thirr: "Dhelpër, o dhelpër, më ndihmo e më sill fat".

2.

Kur Agimi dëgjoi se princesha do të martohej me atë djalë që fshihej më mirë, shkoi drejt e në qytet.

Kur e pa Agimin, djalë të ri e bukurosh, princesha u gëzua dhe i tha:





– Ti ke tri ditë kohë për t’u fshehur. Pas tri ditësh do të filloj të të kërkoj. Fshihu mirë!

Agimi pa u menduar gjatë, vrapoi drejt detit. Hodhi guralecin në ujë dhe thirri:

– Peshk, o peshk, më ndihmo e më sill fat.

Peshku nxori menjëherë kokën, hapi gojën dhe i tha të fshihej në barkun e tij. Pastaj u zhyt në fund të detit.

Pas tri ditësh princeshë Ardita filloi ta kërkonte. Me teleskopin e saj kërkoj në qiell, por nuk e gjeti. Kërkoj në tokë, por as aty nuk e gjeti. Kur kërkoj në ujë, thirri me zë të lartë:

– Ja, të gjeta! Je fshehur në barkun e një peshku në thellësi të detit. Meqë ti qenke fshehur kaq mirë, mund ta provosh edhe një herë.

Atëherë Agimi mori pendën e shqiponjës nga xhepi i pantallonave, e hodhi në ajër dhe thirri:

– Shqiponjë, o shqiponjë, më ndihmo e më sill fat!

Shqiponja zbriti menjëherë nga qielli dhe i tha Agimit të hipte në shpinën e saj. Pastaj u fsheh pas reve.

Pas tri ditësh princesha mori teleskopin dhe filloi të kërkonte.

Ajo kërkoj në të gjitha ujërat, por më kot, Agimin s’e gjeti dot. Kërkoj në tokë edhe aty nuk e gjeti. Atëherë kërkoj në qiell dhe papritur thirri:

– Të gjeta, larg, prapa reve! Meqë ti qenke fshehur kaq mirë, mund ta provosh edhe një herë.

Agimit i mbeti mundësia e fundit. Nxori tri qimet e dhelprës nga xhepi i pantallonave, i hodhi në zjarr dhe thirri:

– Dhelpër, o dhelpër, më ndihmo e më sill fat.

Dhelpra e këshilloi Agimin të mos lëvizte nga vendi dhe shkoi fshehurazi në pallat. Te shkallët princesha kishte lënë një mollë. E mori atë dhe e ndau përgjysmë. Pastaj i tha Agimit të fshihej në zemrën e saj dhe e kthehu mollën përsëri te shkallët.

Pas tri ditësh princeshë Ardita mori teleskopin dhe filloi të kërkonte.

Kërkoj në qiell, nuk e gjeti. Kërkoj në det, nuk e gjeti. Kërkoj anembanë dhe filloi të dyshojë.



E zemëruar përplasi këmbët për tokë. Ajo u hidhërua shumë që e humbi djaloshin. Për të ngushëlluar veten kafshoi mollën. Në atë çast nga molla doli Agimi! Që të dy qeshën e u përqafuan të gëzuar.

Princeshë Ardita dhe Agimi jetuan përherë të lumtur.

*Përshtatje e përrallës "Princeshë Ardita", Mahir Mustafa, Silvia Husler*



## KUPTO TEKSTIN

### Elementet e përrallës

Përralla është një rrëfim (tregim) popullor për ngjarje fantastike, ku veprojnë personazhe magjike. Duke u mbështetur tek elementet e përrallës popullore, shumë shkrimtarë kanë krijuar përralla mjaft të bukura. Kujtoni përrallën *Rosaku i shëmtuar*, shkruar nga Hans K. Andersen; *Kopshti i gjigantit*, shkruar nga Oskar Uajllidi etj.

Ja disa nga elementet e përrallës:

- |                            |   |  |
|----------------------------|---|--|
| <b>Koha</b>                | → | Koha e përrallës është e papërcaktuar.   |
| <b>Vendi</b>               | → | Vendi është gjithmonë përrallor, magjik ose misterioz.   |
| <b>Personazhi kryesor</b>  | → | Personazhi kryesor i përrallës është i mirë (pozitiv) dhe guximtar. Atij i dalin gjithnjë pengesa nga personazhi i keq (negativ), por më në fund del fitimtar. |
| <b>Personazhe ndihmëse</b> | → | Personazhet ndihmëse (dytësore) e ndihmojnë personazhin kryesor të kalojë vështirësitë.  |
| <b>Objektet magjike</b>    | → | Objektet magjike i shërbejnë shpesh personazhit dytësor për të ndihmuar personazhin kryesor.   |
| <b>Fundi i përrallës</b>   | → | Përrallat mbyllen gjithmonë me një fund të lumtur, ku fitimtar del personazhi pozitiv. Ndërsa personazhi negativ e pëson.                                      |

### Diskuto

- Së bashku me mësuesen/in analizojini një nga një të gjitha elementet te përralla "Princeshë Ardita".

## ■ Të dymbëdhjetë muajt e vitit

Po e nisim përrallën. Qofshi të gëzuar të gjithë ju që na dëgjoni.

Ishte njëherë një plakë e mjerë dhe shumë e varfër. Një ditë ajo u nis e shkoi të mblidhte karthje për dimër. Mblidh e mblidh, hyri në ca ara të punuara. Në krye të këtyre arave, pa një shtëpi. Kur po mblidhte karthje zuri të binte një vesë shi. Që të mos lagej, plaka shkoi në këtë shtëpi për të gjetur strehë. Sapo hyri brenda, pa dymbëdhjetë djem të rinj shumë të bukur.

– Mirë se ju gjeta, djem! – uroi plaka.

– Mirë se erdhe, moj plakë e mirë! – ia kthyen ata. – Ç’të ka sjellë këtej në një kohë kaq të keqe?

– Unë, o djem, kam dalë të mbledh ca karthje për dimër, se jam e varfër dhe shtëpia ime nuk është shtëpi, po kasolle e prishur. Në këtë kasolle era, shiu dhe të ftohtit hyjnë nga të katër anët.

Njëri nga djemtë u ngrit dhe e pyeti:

– Pa na thuaj, moj nëne, cili është muaji më i keq i vitit?

– O djem, – tha plaka, – nuk ka muaj të keq. Secili ka të mirat e tij. Të gjithë muajt qofshin të bekuar, se që të gjithë janë të mirë.

– Ç’po thua kështu, moj nëne? A mos muaji janar është njëlloj si muaji maj?

– O djem, – tha plaka, – në qoftë se nuk do të binte shi e dëborë në janar, si do të vinte maji plot me lule?

Atëherë djemtë i thanë:

– Ke ndonjë trastë, moj nëne?



Plaka nxori e u dha trastën djemve. Ata ia mbushën trastën plot me floriinj. Plaka mori trastën e u kthye në fshat. Pas ca kohësh e motra vuri re se plaka nisi të rrojë mirë e të prishë shumë pare. Vajti e i tha:

– Moj motër, më thuaj, ku i ke gjetur këto pare?

Plaka ia tregoi të gjitha.

Të nesërmen, e motra u ngrit, mori një thes të madh e shkoi te shtëpia e djemve në mal.

Djemtë e pyetën:

– Ç'të ka sjellë këtej, moj plakë e mirë?

– Kam ardhur, – u tha ajo, – për të mbledhur karthje, se ja erdhi janari i ftohtë, ky muaj i keq e i mallkuar. – Mos e sjelltë herë tjetër kokën këtej!

– Po na thuaj: cili është muaji që të pëlqen? – e pyetën djemtë.

– Asnjëri nuk më pëlqen. Të gjithë janë të këqij. Ca me shi, ca me erë e ca me të nxehtë të madh.

Atëherë djemtë e pyetën:

– Ke ndonjë trastë, moj plakë?

– Kam, – u përgjigj plaka shumë e gëzuar dhe u zgjati thesin.

– Sille këtu!

Ata ia mbushën thesin plot me nepërka e me zhapiinj.

Plaka mori thesin e u kthye e gëzuar në shtëpi. Por kur e hapi, ç'të shohë!

Ndërsa motra e saj, plaka e mirë, jetoi gjithë jetën e lumtur.

Unë nuk isha atje, as ju nuk ishit, kështu që po të doni besoni, po të doni mos besoni.

*Përralla nga Ballkani, përshtati: Mitrush Kuteli*







# KUPTO TEKSTIN

## Pyetje rreth tekstit

1. Pse kishte dalë në pyll e moshuara?
2. Si ishte e moshuara, e varfër apo e pasur? Nga e kuptove? Nënvizoi të gjitha fjalitë që e tregojnë këtë.
3. Thuaj me fjalët e tua se për çfarë e pyetën djemtë të moshuarën dhe çfarë ju tha ajo.
4. Krahaso fjalët e së moshuarës me fjalët e motrës së saj.
5. Cila prej tyre e meritoi të jetonte e lumtur? Pse?

## Kthehu te teksti

- Plotëso:

- Si e fillon autori përrallën që do të na tregojë neve?

.....

- Si e përfundon?

.....

- Si nis zakonisht përralla?

.....

- Si përfundon zakonisht përralla?

.....

## Po ti?

- Cili është muaji që të pëlqen më shumë? Pse?

- Cili është muaji që vlerëson më shumë? Apo i vlerëson të gjithë muajt? Pse?

## Këshillë

Në përrallë autori përdor fjalën *plakë*. Është mirë që, kur flasim për një njeri që është në moshë të madhe, të mos përdorim fjalët *plak*, *plakë*, por *i moshuar*, e *moshuar*.

## Detyrë

- Shkruaj mesazhin e përrallës.

.....

.....

.....

.....

## Fjalorth

*karthje* – shkarpa.

*një vesë shi* – e përdorim këtë shprehje kur duam të tregojmë se bie një shi shumë i imët, i ngjashëm me vesën e mëngjesit.

*Qofshin të bekuar!* – këtë shprehje e përdorin shumë njerëz, sidomos të vjetrit në moshë, kur urojnë dikë që të ketë fat dhe t'i shkojë jeta mbarë.

*pare* – para, lekë, të holla.





# ■ Ndërtimi i përrallave—Hyrja dhe mbyllja

Të gjitha hyrjet e përrallave ngjajnë me njëra-tjetrën. Ato fillojnë me:  
*Na ishte njëherë ... Ishte se ç'na ishte... . Shumë kohë përpara...*

- Shiko se si nisin këto përralla:


## Sirenat

*Njëherë e një kohë* mes krijesave të mrekullueshme të detit jetonte Mbreti Mjekërbardhë. Ai kishte shtatë vajza, ndërmjet të cilave dallohej njëra. Ajo ishte më e bukura dhe më e magjishmja që kishin parë ndonjëherë krijesat e detit. Ariela ishte sirenë, gjysmënjeri dhe gjysmëpeshk....



## Peshku i artë

*Na ishte njëherë* një peshkatar i vjetër që jetonte me gruan në një kasolle pranë detit. Ai shkonte gjithnjë për të peshkuar, por ndonjëherë kapte peshk dhe ndonjëherë jo. Peshkatori ishte i varfër, shumë i varfër dhe kasollja e tij ishte bërë me baltë dhe me kashtë...



## Hansi dhe Greteli

*Shumë e shumë kohë më parë* jetonte në pyll një familje shumë e varfër. Pjesëtarët e familjes ishin: djali Hans, vajza Gretel, babai i tyre dhe njerka e keqe. Njerka nuk i donte fare fëmijët e burrit dhe mendohej t'u bënte keq...



Siç e vure re, në hyrje të përrallës jepen disa të dhëna kryesore për personazhet. Cilat janë ato? Shkruaji në fletore.

- Të gjitha përrallat kanë **një fund të lumtur**. Ata që janë të mirë, jetojnë të lumtur. Ata që bëjnë keq, dënohen. Ata që bëjnë gabime e pësojnë dhe mësojnë nga gabimet (si peshkatar i varfër).

### Sirena

– Urime, vogëlushe! – i tha i mallëngjyer Mbreti i Detit. – Qofsh e lumtur me princin tënd!

Dhe, ndërsa anija po largohej mbi valët e detit, dy të rinjtë u puthën me njëri-tjetrin. Në këtë çast të gjitha krijesat e detit thirrën: **URRA! Jetë të lumtur!**



### Peshku i artë

Nuk kishte më mrekulli. Nuk kishte më gjëra të bukura. Nuk kishte çudira që vinin prej peshkut të artë. Gjithsesi, peshkatar i ishte shumë **i lumtur** që u kthye në jetën e tij të zakonshme.



### Hansi dhe Greteli

Hansi, Greteli dhe babai i tyre u kthyen në shtëpi **të lumtur**. Varfëria e tyre kishte marrë fund një herë e përgjithmonë dhe njerka e keqe nuk ishte më.



### Detyrë

- Shkruaj dy hyrje përrallash (sipas modeleve të mësipërme.)
- Shkruaj me katër fjali mbylljen e dy përrallave që të pëlqejnë më shumë (sipas shembujve të mësipërm).

# Përemrat vetorë



Thuaj çfarë janë fjalët me ngjyrë të kuqe.

- **Ne** do të shkojmë në ekskursion për të vizituar Krujën.

Do të vini dhe **ju** me ne?

- Jo, ne ishim vitin e kaluar.

**Unë** i tregova Besianit programin e ekskursionit. **Ai** e pëlqeu shumë.

Ai ua tregoi shokëve e shoqeve të tij. **Ata** janë shumë të interesuar

për historinë e Skënderbeut. **Ajo** është e pasur me ngjarje dhe figura historike.

Fjalët: **unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato** janë përemra vetorë.

Përemri vetor ka tri veta: **Veta I, Veta II, Veta III.**

Njëjës

Shumës

Veta I **UNË** (folësi)

**NE** (personat që flasin, ku është edhe folësi)

Veta II **TI** (dëgjuesi)

**JU** (personat që dëgjojnë, ku është dhe dëgjuesi)

Veta III **AI** gj. mashkullore (personi për të cilin flitet)

**ATA** gj. mashkullore (personat për të cilët flitet)

**AJO** gj. femërore (personi për të cilin flitet)

**ATO** gj. femërore (personat për të cilët flitet)

Përemrat vetorë të **vetës I** dhe **II** përdoren vetëm **për njerëz**. **Veta III** zakonisht përdoret për të mos përsëritur një emër që është përdorur më përpara. Këta përemra përdoren edhe për **frymorë**, edhe për **sende**.

Kur i drejtohem dikujt me nderim e mirësjellje, ne përdorim vetën II shumës në vend të vetës II njëjës. P.sh., kur i drejtohem një të moshuari, i themi: "Po ju, si keni qenë?"



## USHTROHU

### 1. Nënvizohet me të kuqe përemrat vetorë.

Motra ime është shtatë vjeçe. Ajo është në klasën e parë, kurse unë jam në klasën e katërt. Çdo mëngjes ne shkojmë së bashku në shkollë me autobus. Ai qëndron para shtëpisë. Ka fëmijë që vijnë më këmbë. Ata e kanë shtëpinë afër shkollës.

- Po ju e keni afër shkollën?

- Po, ne e kemi afër.

- Po ti, pse vjen me autobus?

### 2. Plotëso fjalitë me përemrin vetor që duhet.

..... shkoj në stërvitje çdo ditë.

..... jemi shtatë vetë në skuadër.

..... keni trajner mësues Drinin.

..... janë volejbolliste shumë të afta.

..... është fusha e basketbollit.

.....stërvitesh çdo ditë.

# Folja

## Kujto!

Folja tregon veprim ose gjendje të njerëzve, të kafshëve ose të sendeve.

tregon veprimin që bën peshkatori

Peshkatori po **kap** disa peshq.

tregon gjendje (vendndodhje)

Peshkatori **është** në breg të liqenit.

tregon gjendje (ç'është)

Peshkatori në breg **është** babai im.

tregon gjendje (si është)

Peshkatori **është** i gëzuar.

tregon gjendje (pronësi)

Tani peshkatori **ka** shumë peshq.



Në shembujt e mësipërm veprimi shprehet si i vërtetë dhe i sigurt.  
Kur veprimi shprehet si i vërtetë dhe i sigurt, folja është në **mënyrën dëftore**.

Folja në **mënyrën dëftore** e tregon veprimin dhe gjendjen në kohë të ndryshme: në kohën e tashme, në kohën e ardhme dhe në kohën e shkuar.

- Në tekstin e mëposhtëm gjej çfarë tregojnë foljet me të zezë, veprim apo gjendje?

Mogli **bie** nga dega.

Majmunët **shpëtojnë** Moglin.

Mogli **është** mik i ngushtë i majmunëve.

Shkruaj në kohën e ardhme foljet e mësipërme.





# USHTROHU

## 1. Lidh me shigjetë foljen me atë që tregon ajo.

Unë kam një lepur.

Lepuri është i bukur.

Lepuri është kafshë e butë.

Lepuri është në kopsht.

tregon gjendje, vendndodhje

tregon gjendje, pronësi

tregon gjendje, si është

tregon gjendje, se ç'është



## 2. Nënvizto me të kuqe foljet në kohën e tashme dhe me të kaltër në kohën e ardhme.

Unë kam një shok të ngushtë. Ai e ka emrin Joni dhe i bie pianos. Shoku im është i shkëlqyer në mësim. Ai ka shumë vullnet. Ne kemi shumë vjet që jemi shokë. Shoku im do të ketë sot koncert. Unë i shikoj gjithnjë me kënaqësi koncertet e tij. Unë kam besim tek aftësitë e shokut tim. Të gjithë në klasë krenohen me të. Ne mendojmë që ai do të bëhet artist i madh dhe do të japë koncerte në të gjithë botën.

## 3. Vendosi foljet në kohën dhe në vetën e duhur.

Në fillim, udhëtimi ynë (është) ..... i qetë dhe pa vështirësi. Pastaj, gjërat (ndryshojnë) ..... për keq. Vendmbërritja jonë (janë) ..... një ishull, por në fillim të nëntorit (fillojnë) ..... befas një stuhi e furishme, që na (nxjerrin) ..... jashtë drejtimit të lëvizjes, madje duke na shtyrë në veriperëndim. Dhe ky (isha) ..... vetëm fillimi. Ditën e pestë të muajit gusht anija jonë po (lundroi) ..... mes një mjegulle të dendur. Marinarët vunë re një shkëmb të madh, drejt të cilit po na (drejtuan) ..... era. Por (isha) ..... tepër vonë. Ne nuk (bënit) ..... asgjë. Anija u (përplaset) ..... me shkëmbin dhe u (ndamë) ..... më dysh.



## 4. Ngjyros me të kuqe foljet që tregojnë veprim, dhe me të kaltër foljet që tregojnë gjendje.

E kështu para sysh më doli historia e Ilirisë. Ajo është shumë e lashtë. Një legjendë e vjetër thotë se Kadmi kërkonte motrën e vet. Ajo ishte Europa. Duke ecur arriti më në fund në Beoti të Greqisë. Aty ngriti qytetin e Tebës. Më pas erdhi në brigjet e Adriatikut bashkë me gruan e tij. Gruaja e tij ishte shumë e bukur. Ajo e kishte emrin Harmonia. Aty ku jetonin ilirët, lindi biri i tyre Ilirios. Sapo e lindi, djalin e pështolli një gjarpër magjik. Gjarpri i dha fuqinë dhe zgjuarsinë e tij. Që atëherë gjarpri është simbol i forcës së ilirëve, i mbrojtjes dhe i fuqisë sonë.



## ■ Si bëhen urimet

Përse shkruajmë urime?

Urimet bëhen me gojë a me shkrim në raste festash të ndryshme: *Viti i Ri, Dita e shkollës, Bajrami, Kërshëndellat* etj. Ne mund t'i urojmë të tjerët për gjithçka që është e rëndësishme për ta: *për ditëlindje, për dasmë, lindje të fëmijës, për ndonjë përvjetor, mbarimin e vitit shkollor* etj.

Urimi duhet të jetë: *i lexueshëm, i kuptueshëm, i shkurtër dhe i përzemërt.*

Përmbajtja e urimit:

- kujt i shkruajmë (emri dhe etiketa, p.sh. I dashur baba; E dashura gjyshe; Të nderuar zotërinj etj.)
- mesazhi (i shkurtër, i qartë, i ndjeshëm)
- përshëndetja dhe nënshkrimi në fund të mesazhit

### DETYRË

Shkruaj një urim për shokun, familjarët, miqtë. Mbani mend, ideja juaj është më e mira, sepse në të ka emocione dhe dëshira të singërta ndaj atij që e uroni. Miqtë do t'i gëzojnë më shumë urimi që ti vetë e ke menduar.

The image shows two empty rectangular boxes side-by-side, intended for writing a message. The left box is outlined in green and has a yellow sticky note on its top-left corner. The right box is outlined in blue and has a blue sticky note on its bottom-right corner.

## ■ Zogu dhe djali

Një zog të bukur zuri një djalë,  
ai po dridhej dhe i thosh ca fjalë:  
- Nuk të vjen keq që jam i mitur,  
si ti i vogël dhe i parritur?  
Jam bir i vetëm, mëma më pret  
E kam lënë keq brenda në fole.  
Dheu me borë gjithë u mbulua,  
edhe s'ka mbetur gjëkund pothuaj!  
Më pret imëzë si ty jot ëmë,  
Të mos i vete, ç'bëhet prëmë?  
Kam dhe unë shpirt e dua të rroj,  
të lëviz, të bredh, të loz, të këndoj.  
Fjalët e zogut djali i dëgjoi,  
qau, e puthi, pastaj e lëshoi...

*Naim Frashëri*





## KUPTO TEKSTIN

### Pyetje rreth tekstit

1. Për cilën stinë të vitit flet vjersha?
2. Çfarë i ndodhi zogut të vogël?
3. Pse djalit i erdhi keq për zogun?
4. A bëri mirë ai që e lëshoi? Pse?
5. Çfarë do të bësh ti nëse një zog bie nga foleja? Pse?



### Fjalorth

*i mitur* – i vogël.

*imëzë* – ime më (mamaja ime).

*prëmë* – mbrëmë (në mbrëmje).

*breth* – shkoj andej-këtej pa qëllim.

### Shëno me ✓ përgjigjen e saktë dhe me ✗ përgjigjen e gabuar.

- Mëma e djalit është brenda në fole.
- Mëma nuk shqetësohet për zogun e vogël.
- Nuk ka rënë shumë dëborë.
- Zogut i pëlqen të jetojë.
- Djali e uthi zogun.

### Krahaso

Çfarë kanë njëloj dhe çfarë kanë ndryshe zogu dhe djali? Lidh me shigjetë.

zogu

djali

luan  
 mëson  
 këndon  
 shëtit  
 e pret mamaja  
 ka shtëpi të ngrohtë  
 shkon në shkollë  
 ka ftohtë  
 ka shokë  
 ka libra e lapsa  
 ka rroba të ngrohta  
 ka pupla të ngrohta



### Detyrë

- Mësoje vjershën përmendsh dhe recitoje bukur.  
(Kur të thuash fjalët e zogut, duhet të bësh sikur ke frikë dhe ftohtë.)



## ■ Një peizazh dimëror

Dëgjo me vëmendje mësuesen që lexon këtë tekst me udhëzime.  
Vendos numrin e duhur te secila figurë.

Ndiq udhëzimet dhe shiko figurat:

1. Nga një karton i kaltër prit një rreth të madh. Nga një karton ngjyrë kafe prit një pemë me degë dhe ngjite këtë të fundit në kartonin e madh të kaltër.

2. Përdor karton ose stof të gjelbër për të bërë shkurret.

3. Përdor pambuk për të krijuar borën dhe plakun prej bore. Me letër ose me stof përgatit kapelën dhe shallin e plakut tënd prej bore.

4. Për ta bërë edhe më të bukur peizazhin tënd dimëror, mund të përdorësh letër alumini. Me të krijo hënën, kristalet e borës dhe akujt që ndodhen në degët e pemës.

Tani peizazhi yt dimëror është i mrekullueshëm!



Ky është një tekst udhëzues. Nëpërmjet tij, hap pas hapi, ti krijove këtë peizazh dimëror.

### Detyrë

- Krijo dhe ti një peizazh duke përdorur kolazhin.

## ■ Peizazh

Pasditja hutaqe  
vishet me acar.  
Pas xhamave  
mbushur me avull  
fëmijët, kokë më kokë mbledhur  
shohin një pemë të verdhë,  
tek shndërrohet në një zog.  
Pasditja shtrin krahët  
përgjatë brigjeve të lumit.  
E dielli si një mollë e kuqe  
përkundet mbi çati.

## ■ Dantellat e akullit

Nëpër natë si në përralla  
fryma e ftohtë e dimrit  
u ndal mbi pemët më të larta;  
dhe shtriu përgjatë degëve  
dantellat e saj të gjera.

Federiko Garsia Lorca

### KUPTO TEKSTIN

#### Kthehu te teksti

1. Lexo këto dy poezi dhe plotëso karakteristikat e tyre:

	Peizazh	Dantellat e akullit
Sa vargje kanë?		
Sa strofa kanë?		
A kanë rimë?		
Si është kuptimi i fjalëve që përdor poeti: i zakonshëm apo i figurshëm?		
A krijon poeti figura me fantazi?		
A renditen fjalët si në tekstin në prozë?		

2. Nënvizu mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm. Cilët emra cilësojnë ata?

#### Po ti?

- Të ka ndodhur të vështrosh nga dritarja peizazhin e një dite dimërore?  
Rrëfeje atë sa më bukur.



## ■ Shkruaj një poezi (me fjalë të zgjedhura)

Siç e vure re në poezitë e mësipërme, poeti i zgjedh me kujdes fjalët, për të krijuar një peizazh tjetër me fantazinë e tij.

Një njeriu të zakonshëm pema i duket pemë, ndërsa poetit i duket e shndërruar në zog. Një njeri i zakonshëm degët i sheh të mbushura me akull, ndërsa poetit ato i duken sikur janë të mbuluara me dantella.

- Nëse dëshiron të shkruash poezi, duhet të bëhesh magjistar i fjalëve. Duhet të zgjedhësh fjalë të veçanta, të bukura e tërheqëse dhe të krijosh me to përfytyrime me fantazi.



### 1. Zgjidh njëren nga temat:

Nata e Vitit të Ri, Pylli, Deti, Shiu.

### 2. Gjej fjalët që do të përdorësh. Përcakto ndjesitë që i përshtaten temës.

	Mbiemra	Emra	Folje	Ndjenja e emocione
	e ndritshme e kaltër	flokët e borës si yje	xixëllon	habi
Pylli				
Deti				
Shiu				

- Nuk është e domosdoshme që poezia të ketë rimë, por të tingëllojë si këngë.

# Kohët e foljes në mënyrën dëftore

Në fundjavë Joni **shkonte** diku për t'u argëtuar.



Paradite Joni **shkoi** në kala.



Tani Joni po **shkon** në muze.



Në mbrëmje Joni **do të shkojë** në teatër.

## Kujto

Folja emërton veprim ose gjendje. Ajo gjendet me pyetjet *Ç'bën?* ose *Ç'është?*.

Foljet *shkoi*, *shkon* dhe *do të shkojë* tregojnë se veprimi ndodh, ka ndodhur apo do të ndodhë me të vërtetë. Këto folje janë në **mënyrën dëftore**.

Folja tregon jo vetëm veprim, por përcakton edhe kohën kur ndodh veprimi.

### shkonte

tregon një veprim që ka ndodhur **në të shkuarën**

**Koha e shkuar**

### shkon

tregon një veprim që ndodh **në kohën kur flasim**

**Koha e tashme**

### do të shkojë

tregon një veprim që do të ndodhë **në të ardhmen**

**Koha e ardhme**

*Koha e shkuar*, *koha e tashme* dhe *koha e ardhme* janë tri kohët kryesore të **mënyrës dëftore**.

## KOHA E TASHME

*Unë po lexoj librin.*

## KOHA E ARDHME

*Unë do të lexoj librin.*

## KOHËT E THJESHTA TË MËNYRËS DËFTORE

## KOHA E SHKUAR

Foljet tregojnë **veprime që ndodhin në çaste të ndryshme të së shkuarës**.

*Unë lexoja kartolinat.*

*Unë lexova kartolinat.*



# USHTROHU

## 1. Lidh foljet me kohët përkatëse.

do të blej  
bleva  
do të blejë  
blija  
do të blesh  
blenë  
do të dhurojë  
bleu

e tashme

e shkuar

e ardhme

shkruajmë  
fluturoi  
këndove  
kërkoj  
kërkojmë  
shkoje  
përshkruaja  
shkojnë

## 2. Lexo tekstin e mëposhtëm dhe zgjidh kohën e duhur të foljes në kllapa.

Buzë rrugës (pashë/shikoja) një turi të kuqërremtë. Kafshëza (lëvizi/lëvizte) bishtin. Ajo (vinte/erdhi) drejt meje. Kafshëza (vrapoi/vraponte) shumë shpejt. Ajo (kërcente/kërcyen) pa pushim nga njëra degë në tjetrën.

## 3. Nënvizto foljet në fjalitë e mëposhtme dhe thuaj kohën e tyre.

Unë do të tregoj për fqinjin tim, Noelin. Ai më pëlqen shumë, por një ditë na shqetësoi. Prindërit i blenë Noelit një kompjuter. Ai instaloi aty shumë lojëra dhe luante gjithë ditën me to. Një ditë luajti aq shumë me kompjuter, sa pati dhembje koke. Prindërit thirrën menjëherë mjekun. Edhe fqinjët shkuan menjëherë aty. Mjeku shkroi recetën dhe babai vrapoi në farmaci. Mjeku e këshilloi Noelin të luante me orar. Me siguri Noeli do të vendosë orar për kompjuterin.

## 4. Analizo sipas kërkesave të tabelës foljet e nënvizuara.

Bishti i ketrit ndriste nga drita. Ai afroi turirin afër meje. Kishte dy doçka të bardha. Ato nuk ngjanin si putra kafshe. Unë e pëlqeva shumë atë. Unë nuk do të harroj kurrë këtë pamje. Do do të vini dhe ju këtu?

Folja	veta	numri	mënyra	koha
-------	------	-------	--------	------

## 5. Dallo vetën, numrin dhe kohën e foljeve në fjalitë më poshtë.

Unë lexova këtë javë "Librin e xhunglës". Atë ma dhuroi halla për ditëlindje.

Këtë libër e lexoj me dëshirë. Fëmijët i lexojnë me kënaqësi librat. Ata blejnë gjithmonë libra. Në panair blenë edhe më shumë.

– Ti do të lexosh këtë fundjavë ndonjë libër?

– Po, do të lexoj librin që më dhuruan prindërit.



## 6. Shiko figurën dhe shkruaj gjashtë fjali, ku folja të jetë në kohë të ndryshme.

# Folja në kohën e tashme

## Kujto!

Folja në kohën e tashme tregon për një veprim që kryhet në kohën kur flasim.

- Lexo poezinë e mëposhtme dhe bëj dallimin ndërmjet foljeve me të kuqe dhe atyre me të kaltër. Nënvizto foljet në kohën e tashme.

O UJË I FTOHTË, E I KULLUAR

– Nga cilat male po **zbret**,

o ujë i ftohtë, e i kulluar?

– Po **vij** nga larg duke vrapuar nga borë e bardhë që ju **përrshëndet**.

Ku po **shkon** kështu me nxit o ujë i ftohtë, akull, i kulluar?

– Në kopshte **do të ndaloj**.

Barin **do të gjelbëroj**.



- Plotëso tabelën e mëposhtme duke zgjedhur foljet në kohën e tashme.

Unë	shko- <b>j</b>	arrij	vij	blej	shtyj
Ti	shko- <b>n</b>	arrin	vjen		shtyn
Ai/ajo	shko- <b>n</b>				
Ne	shko- <b>jmë</b>	arrijmë		blejmë	shtyjmë
Ju	shko- <b>ni</b>				
Ata/ato	shko- <b>jnë</b>	arrijnë	vijnë	blejnë	



## USHTROHU

### 1. Shkruaj foljen në kllapa në kohën e tashme.

Pipi po (flas) ..... me fëmijët me duar e këmbë:  
 Mami im (jam) ..... engjell dhe babi im (jam)  
 ..... mbret i zezakëve. Jo të gjithë ju (kam)  
 ..... një fat të tillë. Babai im (shëtiti) .....  
 me anije gjithë botën. Ai (mban) .....  
 një kurorë ari në kokë. Pipi (jam) .....fëmijë i  
 çuditshëm. Ajo (është) ..... shumë e fortë. Nuk  
 (gjej) ..... në gjithë botën fëmijë më të fortë se  
 ajo. Pipi (ngre) .....në ajër një kalë. Ja atë kalin  
 që po (vrapoj) në oborr. Nuk e (besoj) .....ju?



## 2. Ktheji në kohën e tashme foljet që janë në kohën e ardhme.

- Bora (do të mbulojë)..... malet. Dimri (do të jetë) ..... i ftohtë. Pas dimrit (do të vijë) ..... pranvera. Nga malet (do të rrjedhin) .....rrëke ujërash. Ato (do të ujitin) ..... fushat. Fermerët (do të lërojnë) ..... Barinj të (do të kullosin) ..... bagëtitë. Fëmijët (do të luajnë) .....në parqet e lulëzuara.

## 3. Zgjedho foljet mësoj, punoj duke ndarë me vizë mbaresat.

# Drejtshkrimi i foljeve në kohën e tashme

### Kujdes!

Ndonjëherë disa folje në kohën e tashme i shkruajmë gabim.

P.sh.: lajmë, lajnë dhe jo ~~lajm~~, ~~lajn~~      blej dhe jo ~~ble~~  
fle dhe jo ~~flej~~      bëjmë jo ~~bëmë~~  
punoj dhe jo ~~punoj~~      bëjnë dhe jo ~~bënë~~

## 3. Plotëso tabelën me zgjedhimin e tyre.

Unë		shtyj	shkrij	
Ti	mban			
Ai/ajo				ngrin
Ne		shtyjmë		ngrijmë
Ju				
Ata/ato	mbajnë			

## 4. Zgjidh dhe nënvizo nga foljet në kllapa atë që është në kohën e tashme.

Ne shkojmë çdo të diel në tregun e qytetit. Aty (blejmë/blemë) perimet dhe frutat për të gjithë javën. Ne e (shtyjmë/shtymë) karrocën e ushqimeve me radhë. Pastaj (vijmë/vimë) në shtëpi me autobusin e linjës. Unë (ble/blej) më shumë fruta, kurse vëllezërit e mi (blejnë/ blenë) ëmbëlsira. Unë i (vizatoi/vizatoj) mollët shumë bukur. Ato (ngjajnë/ngjanë) sikur janë të vërteta.

## 5. Foljet duhet të jenë në kohën e tashme. Korrigjo foljet e shkruara gabim.

Ju bleni shumë libra për fëmijë në panair. ....  
Unë e ngre me vështirësi çantën. Ata e ngrejnë me lehtësi. ....  
Unë fle në orën 9, ju fleni më vonë. ....  
Fëmijët çdo ditë bënë rrugë të gjatë më këmbë. ....  
Ne nuk e dijmë këtë vjershë. ....



# ■ Arinjtë polarë



Arinjtë polarë janë kafshë shumë të mëdha. Gjatësia e tyre shkon deri në 3 m, ndërsa pesha e trupit deri në 700 kg.

.....

Arinjtë polarë jetojnë në Detin e Ngrirë të Veriut, në mjedise me akull. Shtëpitë e tyre janë zgavrat e akullit.

.....



Atyre u pëlqen klima e atjeshme, edhe pse temperaturat gjatë dimrit mund të ulen deri në -45° C.

Veshja e arinjve polarë është shumë e trashë. Ata kanë dy shtresa: një shtresë gëzofi dhe një shtresë dhjami, të cilat i mbrojnë nga i ftohti i madh.

.....

Ushqimi më i pëlqyer i arinjve polarë janë fokat. Ndonjëherë, ata ushqehen edhe me lopë deti apo balena. Në raste të veçanta, ata mund të ushqehen edhe me shpezë të ndryshme.

.....



Arinjtë polarë jetojnë në përgjithësi nga 15 deri 18 vjet, por ka raste që shkojnë deri në 30 vjet.

.....

Arushat polare linden përgjithësisht një ose dy këlyshë, po ka raste edhe 3 këlyshë. Para se të linden, ato bëjnë një strofull për të mbrojtur të vegjlit.

.....

- Pasi të dëgjosh me vëmendje secilin paragraf, përgjigju pyetjeve të mëposhtme.

Ku jetojnë arinjtë polarë? ..... Si e durojnë të ftohtin? .....

Cilat janë përmasat e tyre?..... Me se ushqehen? .....

Sa gjatë jetojnë? ..... Sa këlyshë linden? .....

## Patatet e ziera

Makina qepëse zuri të punonte përsëri.

– Po sot është e diel, – tha Andi si me qortim.

Zonja Fink iu përgjigj pa e ngritur kokën:

– Sot është e diel, por deri nesër unë duhet të kem mbaruar së qepuri gjithë këtë pirg grykësesh e përparësesh. Meqë ndërrova shtëpinë, kësaj here jam prapa me punën.

– Po për drekën si do t’ia bëni? – e pyeti Andi.

– Sot s’ka drekë. S’kam për të gatuar.

– Sa keq! – tha Andi. – Po ju duhet të hani diçka.

Andi shkoi në kuzhinën e vogël. Përveç patateve, nuk gjeti gjë tjetër në shportën e perimeve. U kthye në dhomë dhe e pyeti zonjën plakë se si mund t’i ziente patatet. Ajo ia shpjegoi pa ngritur kokën nga makina.

Andi solli nga kuzhina një tenxhere, po doli se kjo ishte tepër e madhe. Pastaj solli një tjetër, po kjo ishte tepër e vogël. Më në fund gjeti një të mesme, që bënte tamam për atë punë. Ai rendte me zell të madh poshtë e lart nga kuzhina te dhoma e gjumit, ku punonte zonja Fink. Pastaj lau tetë patate, e mbushi tenxheren me ujë dhe ndezi gazin. Shtiu pak kripë në tenxhere dhe, kur filloi të vlonte uji, uli flakën e gazit dhe i vuri kapakun.

– Tani i vjen radha gjizës! – lajmëroi ai. Dhe filloi ta përziante gjizën me qumësht. Po tenxherja ishte e vogël dhe nuk e nxuri gjithë qumështin, kështu që u derdh pak.

Rendi poshtë shkallëve dhe hyri në kopshtin e nënës. Atje këputi një tufë qepujka dhe disa rrepka të kuqe. Kur arriti lart, pyeti me një frymë:

– Janë zier patatet tani?

Zonja Fink i tha t’i provonte me pirun, po më parë të merrte një copë lecke që të mos digjte gishtat kur të ngrinte kapakun.

“Puna e gatimit qenka shumë tërheqëse, – tha me vete Andi. – Natyrisht, nuk krahasohet me gjuetinë e tigrave, po prapë të rrëmben dhe të duket vetja sikur ç’po bën”.



Ngriti kapakun (avulli ia veshi sytë) dhe ia nguli pirunin patates së parë që i hasi dora.

– Prapë nuk qenkan bërë!

Kur ato u bënë gati, zonja plakë e ftoi që të hanin së bashku. Andi vuri në tryezë: dy pjata, dy thika e dy pirunë.

Patatet ishin zier pak si tepër. Gjiza s'kishte kripë aq sa duhej. Rrepkave të kuqe u kishte mbetur pakëz dhé, që kërciste ndër dhëmbë.

Megjithatë, zonja Fink iu drejtua gjithë ëmbëlsi:

– Të lumshin duart e vogla! Nuk kam ngrënë kurrë gjellë kaq të shijshme!

"Gjyshja në pemën e mollës", Mira Lobe, përktheu Sofiana Filipi



## KUPTO TEKSTIN

### Pyetje rreth tekstit

1. Pse zonja Fink po punonte të dielën?
2. Çfarë bëri Andi, kur mori vesh se ajo s'kishte kohë të gatuar?

Numëro të gjitha veprimet e tij gjatë gatimit:

.....

.....

.....

.....

.....

### Po ti?

Ngjarja na tregohet në vetën e tretë, ku autori na tregon për Andin dhe zonjën Fink. Ritregojë dhe një herë ngjarjen në vetën e parë, pra sikur ti je Andi.

### Kthehu te teksti

Shëno V-e vërtetë ose G-e gabuar.

Koha kur ndodh ngjarja e tregimit. Kur?	<input type="checkbox"/> e martë <input type="checkbox"/> mëngjes	<input type="checkbox"/> e premte <input type="checkbox"/> paradreke	<input type="checkbox"/> e diel <input type="checkbox"/> pasdite
Vendi i ngjarjes së tregimit. Ku?	<input type="checkbox"/> rrugë <input type="checkbox"/> kuzhinë	<input type="checkbox"/> shtëpi <input type="checkbox"/> dhomë gjumi	<input type="checkbox"/> kopsht <input type="checkbox"/> tualet
Personazhet. Cilat?	<input type="checkbox"/> Ardi	<input type="checkbox"/> Andi	<input type="checkbox"/> zonja Fink



### Fjalorth

*pirg* - grumbull gjërash të ndryshme të hedhura njëra mbi tjetrën.

*zien* - vlon (uji, gjella).

*rendte* - vraponte.

*zell* - dëshirë e zjarrtë dhe kujdes i madh që tregon dikush për të kryer sa më mirë një punë, një detyrë, një porosi etj.

*i hasi dora* - i ndeshi dora; e preku me dorë.

## Jemi të ndryshëm



1. Shiko figurat e mësipërme. Shkruaj për secilën prej tyre nga një cilësi. Pastaj krahasoju me shokun e bankës.

2. Ju të gjithë në klasën tuaj jeni të ndryshëm. Secili ka cilësitë e tij të veçanta.

Cili nga shokët ka:

**ngjyrën e syve:** të kaltër, të gjelbër, të zezë, ngjyrë kafe

**ngjyrën e flokëve:** të zezë, kafe, të verdhë, të kuqe

**formën e flokëve:** kaçurrela, të drejta, të shkurtra, të gjata etj.

**gjatësinë:** 1 e 15 cm, 1 e 20 cm etj.

**peshën:** 30 kg, 32 kg etj.

### Krahaso dy shokë të klasës sate sipas këtij shembulli:

*P.sh.: Andi është më i gjatë se Besi. Besi është më i shëndoshë se Andi. Andi i ka sytë të kaltër, Besi i ka bojëkafe. Flokët e Andit janë të verdhë, ndërsa të Besit...*

#### Përdor këto fjalë:

*i qeshur, i shkathët, i ngathët,*

*i inatosur, i trishtuar,*

*i gëzuar, i mërziur,*

*gazmor, i urtë etj.*



## ■ Ata janë si ne

### a.

Disa fëmijë, për fat të keq, kanë të meta fizike. Ata ose kanë lindur të tillë, ose u ka ndodhur ndonjë aksident. Këta fëmijë quhen ndryshe *me aftësi të kufizuara*.

- Si mendon ti, a janë fëmijët me aftësi të kufizuara njëloj si të gjithë? A kanë dhe ata dëshira dhe ëndrra të njëjta me të gjithë?

- Shiko ilustrimin.

- Çka sheh aty? Në cilin aktivitet sportiv do të marrë pjesë ai?

- A është i mirë sporti për shëndetin e tij? Pse?



### b.

Në klubin e miqve është një rregull për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kujtohu dhe thuaje atë.

- Si mendon ti, fëmijët me aftësi të kufizuara ndihen më mirë vetëm kur rrinë me njëri-tjetrin?

- Çka mund të bëjmë ne të tjerët për ta?

- A do të ishte i lumtur një fëmijë i tillë, nëse ne do të rrinim me të dhe do ta quanim shok të vërtetë?

- Kujto tregimin e dy shoqëve që komunikojnë me njëri-tjetrën me shenja. Ç'tregon ai?



# Të ndihmojmë fëmijët në nevojë

Bashkohuni dhe ju me ne në këtë nismë.

Duke filluar nga data 05.12..... dhe në vazhdim, deri për Vitin e Ri, do të mbledhim rroba për fëmijët në nevojë.

Sado e vogël të jetë ndihma juaj, ajo është e madhe për ata. Le të ndihmojmë për t'i rikthyer buzëqeshjen dhe ngrohtësinë një fëmije.

Grumbullimi bëhet te Rruga e Lirisë; .....  
nr. tel.: .....



- Harto dhe ti një thirrje për të ndihmuar një grup në nevojë.

**Së pari**, duhet të vendosësh se kujt do t'ia drejtosh thirrjen.

**Së dyti**, shëno arsyet pse e shkruan këtë thirrje.

**Së treti**, mbylle shkrimin me kërkesën tënde ndaj personave që u drejtohesh.

- Lexo poezinë e shkruar nga Zhak Preveri dhe shkruaj se cili është mesazhi që na jep poeti me këtë poezi.

## Dita pa uri

Të kisha qenë bukëpjekës  
do piqja një bukë të madhe...  
e madhe sa qielli të ishte,  
rreth saj të varfrit të hidhnin valle.

Të hanin nga kjo bukë e madhe  
njerëz, zogj, insekte e kafshë  
edhe të ngopeshin për tërë jetën,  
burrat, gratë, pleqtë e kalamajtë.

Kjo do të mbetej një ditë e madhe  
e do të shkruhej në histori,  
e do të quhej në një mijë gjuhë:  
DITA PA URI!

Mesazhi i poetit

.....  
.....  
.....  
.....  
.....



- Dëgjo me vëmendje poezitë e mëposhtme kushtuar stinës së pranverës.



## ■ Pranvera

Jeni lodhë dallëndyshe të shkreta,  
je molisë i ziu bilbil,  
ah, pushoni n'streh e ku ju gjeta,  
pusho në kopsht te njaj zymbyl.

Mbi krahët tuej prej dhenash tjera  
ju pranverën na prutë këtej,  
shplodhuni ju, dallëndyshe të mjera,  
rri bilbil, në lulëzim që kthej.

Se qe një prrue prej malit ulet  
e të tanë fushës ushqim i jep,  
e nën bore po shpërthejnë lulet  
porsi fëmijët që zbulohen në djep.

*Ndre Mjeda*

*je molisë - je ligështuar, mërziur shumë*

## ■ Qershizat

Qershizat u poqën  
e po kuqëlojnë,  
poshtë pemës  
cullët  
kokrrat i vështrojnë.  
Çuna dhe çupa  
duart lart i zgjasin,  
po nuk i arrijnë,  
prandaj zënë thërrasin.

Kokrrat e qershisë  
bëjnë  
sikur s'dëgjojnë,  
degëzat nuk ulen,  
cullët t'i provojnë.  
- O qershia të kuqe  
mbushur me lëng plot,  
pse qëndroni lart,  
sa s'ju zëmë dot?  
- Po të ishim poshtë,  
nuk na kishit lënë,  
dhe ashtu papjekur  
do na kishit ngrënë!

*Bedri Dedja*

*cullët - fëmijët*





## Jam mik i zogjve!

Jam mik i zogjve,  
Jam mik i zogjve,  
Për ta kam ngritur me mijëra fole,  
Krejt pemët e blerta,  
Çati e ballkone,  
Për ta i ktheva në streh'...

Foletë i kam shtruar  
Me pupla të buta  
Dhe shiu s'i zë e era s'i rreh,  
Në vjershat e mia të gjitha i futa,  
Zemrën e bëra fole!

*Odhise Grillo*



- Pas dëgjimit të mësueses/it plotëso:

- Në cilën poezi përmendet fjala **fole**? .....
- Në cilën poezi thuhet se përroi zbret nga mali? .....
- Në cilën poezi ka dialog? .....

- Në secilën poezi përmenden tri veçori të stinës së pranverës. Shkruaji ato:

Pranvera .....

Qershizat .....

Jam mik i zogjve .....

- Plotëso për secilën poezi

	Nr. i strofave	Nr. i vargjeve	Me rimë/pa rimë
Pranvera			
Qershizat			
Jam mik i zogjve			

# Përshkruajmë pranverën

- Shiko figurat e mëposhtme dhe bëj një përshkrim të pranverës. Kthehu dhe një herë te faqet *thesi i fjalëve*.

Përshkruaj:

**Ngjyrat e pranverës:**



e kuqe, e gjelbër, .....  
.....  
.....  
.....

**Aromat e pranverës:**



e ëmbël, delikate, dehëse .....  
.....  
.....  
.....

**Tingujt e pranverës:**



ciu-ciu, quk-quk, kuak-kuak  
.....  
.....  
.....

**Ndjësitë e tua:**



hare, gjallëri.....  
.....  
.....  
.....



## ■ Çdo mëngjes përshëndes nënën time!

Ajo nënë quhej *E mira*. Jetonte e vetme me një djalë që ishte i bukur si yll. Nëna përpiqej shumë dhe lodhej natë e ditë që djali të bëhej edhe i ditur. *E keqja* ia rrëmbeu djalin Së mirës dhe e çoi në pyll. Atje e lidhi te një pemë që ta hanin egërsirat, dhe iku. Djali zuri të qante. Më në fund u duk Nata, e veshur me një fustan tërë xixa. Në flokë i ndrisnin yje të vogla, që dukeshin si shi i artë.

– Kush të ka lidhur te pema? – e pyeti ajo djalin.

– E keqja, – u përgjigj djali.

Nata nxori një thikë të artë dhe e preu litarin. Djali iu hodh në qafë.

– Sa e mirë je, moj Natë me yje! Të dua si nënën time..., – dhe dy pika lot i ranë mbi faqe.

– Cila është nëna jote? – e pyeti Nata.

– E mira..., por E keqja më ka ndaluar të kthehem te nëna...

Natës iu dhimbs djaloshi dhe vendosi ta merrte me vete.

– Ke dëshirë të udhëtosh gjithmonë me mua?

– Oh, po!

– Bëhu gati dhe emrin do ta kesh... Agim.

– Agim?!

Nata picërroi sytë dhe nisi të fliste me një zë të çuditshëm:

– Ti do të zbresësh në Tokë pas meje. Njerëzit do të të duan të gjithë, sepse ti do t'i lajmërosh që po vjen mëngjesi.

– Për këtë do të më duan kaq shumë?

– Po. Ti e di që njerëzit gjithë Natën flenë dhe presin sa të vijë Dita, që të punojnë e të bëjnë gjëra të bukura... Prandaj, kur të zbresësh ti, unë do të jem larguar; njerëzit do të jenë çlodhur. Bota





do të mbushet me dritë. Ke për të parë sa i lumtur do të ndihesh, kur të dëgjosh zëra që të presin me padurim.

– Sa mirë! Çdo mëngjes unë do të përshëndes të parën nënën time, – tha djali. Që prej asaj kohe, njerëzit, sapo zbardh, thonë: “Erdhi Agimi!”.

Nexhmije Muça

## KUPTO TEKSTIN

### Fjalorth

*iu dhimbs* – i erdhi keq për të

*picërroi sytë* – i mbyll sytë përgjysmë për t'i mbrojtur nga drita e fortë

### Pyetje rreth tekstit

1. Kush e kishte lidhur djalin në pyll? Pse?
2. Kush e liroi djalin? Si ishte ajo?
3. Çfarë i propozoi Nata djalit? A pranoi djali? Pse?
4. Çfarë bëjnë njerëzit natën?
5. Pse ata e duan aq shumë Agimin?

### Kthehu te teksti

- a. Gjej dhe lexo fjalinë që tregon se:
- djali u frikësua shumë;
  - djali u gëzua shumë që Nata e liroi;
  - djali e krahason Natën me nënën e tij;
  - djali u çudit me emrin që i vuri Nata;
  - djali nuk e harron nënën e tij.

b. Gjej:

- sa herë përmendet fjala Nata .....
- sa herë përmendet fjala E mira .....
- sa herë përmendet fjala Agim .....
- sa herë përmendet fjala E keqja .....

### Lidh me shigjetë

Cilësi të kundërta:

E MIRA

e dashur  
e egër  
e pashpirt  
e butë  
zemërmirë  
e ëmbël  
zemërgur

E KEQJA

### Plotëso

Gjej të veçantat që ka secila:

DITA dritë .....

NATA errësirë .....

- Thuaj çfarë të pëlqen më shumë te secila.

# ■ T'i mbrojmë pemët

## 1. Përse janë të rëndësishme pemët?

Zbukurojnë mjedisin,  
mbajnë ajrin të pastër,

.....  
.....  
.....

Shto të tjera.

## 2. Ne duhet t'i mbrojmë pemët:

të mos i thyejmë degët,  
t'i mbrojmë nga zjarri,

.....  
.....  
.....  
.....

Shto të tjera.

## 3. Shiko vizatimet e nxënësve dhe fol për to →.



## 4. Diskutoni në klasë për kënaqësinë e shëtijes në pyll.



# I gjithë faji i fshatarit (tregim për mbrojtjen e mjedisit)

Në natyrë gjërat janë shumë të lidhura me njëra-tjetrën. A keni ju njohuri për zinxhirin ushqimor? Pyesni mësuesit dhe prindërit para se të shkruani tregimin.

- Shikoni figurat dhe bëni një tregim.

Një fshatar i paditur donte të mbronte bimët nga dëmtuesit. Por ai i spërkati me më shumë lëndë helmuese sesa duhej. Kjo u shkaktoi shumë dëme kafshëve që ushqeheshin me to.



.....  
.....  
.....

.....  
.....  
.....



.....  
.....  
.....

.....  
.....  
.....



.....  
.....  
.....

Kështu mbaron kjo përrallë:

*Kjo histori e shkurtër ju rrëfen,  
pse në qiell asnjë fajkua më nuk gjen.*

F. Pratesi

## ■ Kujtoj qenin tim

Qenushi im quhej Xhek. Ai ishte qeni më i mrekullueshëm në botë dhe shoku im më i ngushtë. Më kujtohet hera e parë kur e takova Xhekun. Ai erdhi drejt derës duke vrapuar. Rreth qafës kishte një fjongo të madhe të kuqe. Pastaj u turr drejt meje. Mbaj mend se sa i gëzuar ishte! Hapa krahët dhe e përqafova. Xheku ishte shumë i lëvizshëm dhe nuk pushonte së tunduri bishtin e tij sa andej-këndej. Ai ishte qeni më leshator që kisha parë ndonjëherë.



Cikli i jetës së Xhekut filloi kur ai lindi. Gjatë kohës që u rrit, cikli i jetës së tij u bë më i plotë. Unë dhe Xheku u rritëm së bashku. Kur Xheku nga këlysh u bë qen i rritur, pësoi shumë ndryshime: jo vetëm që u bë më i madh në trup, por edhe më i fortë. Ndërsa koha kalonte, Xheku filloi të dukej më i plogësht dhe më i lodhur. Ecte ngadalë, rrinte gjatë pa lëvizur në një vend dhe sytë e tij dukeshin shumë të trishtuar. Prindërit e mi e çuan Xhekun te veterineri. Ai tha se Xheku ishte i madh në moshë dhe i sëmurë. Gjendja e tij nuk mund të përmirësohej.

Një ditë ai mbylli sytë për të fjetur, por nuk u zgjua më. Në këtë çast, cikli i jetës së tij përfundoi. Mbaj mend se sa i mërzitur dhe i vetmuar ndihesha ditën kur Xheku nuk ishte më. Nuk pushoja së qari dhe nuk kisha dëshirë të bëja asgjë. Më dukej sikur zemra ime ishte thyer më dysh. Çfarë do të bëja pa të? Një pjesë e imja ishte e inatosur me Xhekun që më la, pasi dihet që shokët e ngushtë nuk ndahen kurrë. Prindërit më shpjeguan se gjendja e Xhekut nuk kishte zgjidhje tjetër, përveç vdekjes.

T'i thoshe "Lamtumirë!" shokut të ngushtë, ishte vërtet e vështirë. Më mungon shumë!

Me kalimin e kohës, unë i kujtoj gjërat që bënim bashkë pa dëshpërimin e fillimit.



Kujtimet për Xhekun më bëjnë të buzëqesh. Edhe pse nuk e shoh dhe nuk e prek dot, ai është gjithmonë me mua. Një nga gjërat që pëlqej më shumë, është të ulem në hijen e lisit dhe të kujtoj gjërat që kemi bërë bashkë, sidomos në një ditë të nxehtë.

Marta Fàbrega

## KUPTO TEKSTIN

### Fjalorth

*turr* – erdhi me vrap.

*zemra ishte thyer më dysh* – është një ndjesi që provojmë, kur mërzitemi shumë për diçka të rëndë që na ndodh dhe që ka lidhje me gjërat tona më të dashura.

### Pyetje rreth tekstit

1. Pse në fillim djali ishte shumë i gëzuar për qenin e tij?
2. Si mendon ti, sa vazhdoi ky gëzim? Sa vjet mund të rrojë një qen, nëse e kryen ciklin e tij jetësor?
3. Pse ndihej i inatosur djali?
4. A ia shpjeguan mirë prindërit se çfarë kishte ndodhur?
5. Pse djali buzëqesh kur e kujton Xhekun?



### Po ti?

- Çfarë ndjeve për Xhekun, kur lexove këtë tregim?
- Çfarë ndjeve për djalin? Të erdhi keq? Pse?
- Po të ishe ti në vend të djalit, a do ta harroje Xhekun? Pse?

### Kthehu te teksti

Plotëso çfarë bënte Xheku:

kur ishte i ri

*vraponte*

.....  
 .....  
 .....

kur u plak

*ecte ngadalë*

.....  
 .....  
 .....

### Bisedë me mësuesen/in

Ju keni mësuar në diturinë e natyrës se kafshët, sikurse njerëzit, kryejnë një cikël jetësor (lindja, rritja, vdekja). Kjo është diçka e natyrshme, prandaj është shumë e rëndësishme të shprehim ndjenjat tona të gëzimit dhe të trishtimit. Këto ndjenja janë shumë normale dhe nuk ke pse të kesh turp apo frikë që t'i shprehësh. Kur i shpreh, lehtësohesh dhe përgatitesh për një gjë të re dhe të bukur që të vjen më pas.

# ■ Përshkruajmë kafshët

Shqiponja është më e fortë se të gjithë zogjtë që fluturojnë në qiell. Këta zogj trima dhe të fortë ndahen në shumë lloje dhe kanë shumë emra. Disa prej tyre quhen skifterë, disa quhen shqipe, shqiponja ose petritë.

Shqiponja e ka sqepin të kthyer porsigrep dhe thonjtë porsishtiza të mprehta. Shqiponja ha zogj të gjallë, lepuj, breshka dhe hardhuca. Asnjë nga zogjtë nuk i del kundër shqiponjës. Ajo është përmbi të gjithë shpendët e qiellit, ashtu si dhe luani përmbi të gjitha shtazët e tokës, prandaj quhet mbretëresha e shpendëve. Shqiponjat i ndërtojnë foletë e tyre nëpër male të larta, nëpër shkrepë dhe shkëmbinj.

*Kostandin Kristoforidhi*

## • Plotëso

Ç'loj gjallese është shqiponja? .....

Me se ushqehet? .....

Ku e ndërton fole? .....



## • Nga vëzhgimi të përshkrimi.

Zgjidh një kafshë, që mund të jetë jotja, e ndonjë të afërmi apo që ti e ke parë në televizor: qen, mace, peshk i kuq, breshkë, zebër, elefant, gjarpër, pinguin etj.

Përpara se ta përshkruash një kafshë duhet ta vëzhgosh, ta shikosh me vëmendje. Kjo bëhet, me qëllim që të të nguliten disa nga karakteristikat e saj kryesore. Gjithashtu, mos harro të vëzhgosh dhe mjedisin ku jeton ajo (shtëpi, kopsht, fshat, pyll, xhungël etj.).

## • Për të përshkruar një kafshë duhet të ndalesh te:

Pamja fizike

- ngjyra e trupit,
- forma dhe madhësia e trupit,
- koka me pjesët e saj përbërëse (sytë, hunda, sqepi, mustaqet, brirët etj.),
- gjymtyrët (krahët, këmbët) dhe bishti.

Lëvizjet

hidhet, vrapon, kalëron, zvarritet etj.

Sjelljet dhe zakonet

si ha, si fle, si luan, si sillet me njerëzit dhe me kafshët e tjera.

Zëri

mjaullin, leh, hungërin, ulërin etj.

Natyrë

ka frikë, është ledhatare, e gjallë, e egër, e dashur, besnike etj.

# ■ Sporti dhe koha e lirë

Përpara se të shkruash se cilat sporte pëlqen apo ushtron, zgjidh ushtrimin e mëposhtëm.

a. Vendos në vendet e duhura fjalët që mungojnë:




## SPORTET E MIA

Falë prindërve të mi unë merrem me disa sporte në kohën..... . Nuk do ta besoni, por më ka pëlqyer gjithnjë basketbolli, më shumë se..... Jo se dua....., por kam shumë shënjestër. Ajo që nuk më pëlqen te basketbolli, është kur shtyhem ..... me njëri-tjetrin dhe loja bëhet shumë e nxehtë. Kështu kthehem në shtëpi si kalamaj të djersitur dhe.....

Nga noti kam pak kujtime, por kënaqësia ..... nga maja e trampolinës nuk është gjë që harrohet lehtë. Është një spektakël..... . Njerëzit të shohin poshtë dhe.....

Ndërsa në dimër ..... është sporti që më pëlqen më shumë. Nga tetori në dhjetor, ndiqja një kurs ..... të skive. Një mësuese me një "autoritet të ëmbël" na detyronte të stërviteshim.....

Gjatë pushimeve të Vitit të Ri bëj ski me motrën time në pistat e Kodrës..... Pjesën tjetër të dimrit shkoj në pista të tjera me autobusin e Klubit.....



b. Pasi ta plotësosh tekstin, lexoje për ta kontrolluar nëse e ke bërë mirë.

- Bëj dhe ti një përshkrim të ngjashëm nga përvoja jote vetjake.

# Tregimi realist dhe tregimi fantastik

•Kthehu te tregimi *Një diskutim në klasë*.

1.

Një tregim është **realist**, kur çdo gjë që tregohet në të mund të ndodhë me të vërtetë në jetë.

P.sh., ktheu te tregimi *Një diskutim në klasë*, të gjitha elementet e tij janë reale:

**vendi real** - klasa, shkolla,

**koha reale** - paradite,

**personazhet reale** - mësuesja, Ermali, Dritoni, Lindita etj.

**ngjarja reale** - Ermali është nxënësi i ri i klasës,

**objektet reale** - sendet në klasë, bankat etj.



2.

Një tregim është **fantastik**, kur përmban **elemente fantastike**, që nuk ndodhin në jetë. Nuk është e thënë që të gjitha elementet e tij të jenë fantastike. Në tregimin fantastik mund të gjesh edhe **personazhe** reale, **vende** reale apo dhe **veprime** reale.

•Kthehu te tregimi *Vajza e kopshtarit*.

Me ndihmën e mësueses/it plotëso:

Personazhi kryesor	njeriu i kthyer në gishto	real apo fantastik
Veprimi	personazhi (Gishtoja) që fluturon	real apo fantastik
Personazhet e tjera	.....	reale apo fantastike
Vendi	.....	real apo fantastik
Koha	.....	reale apo fantastike

Detyrë

•Dallo elementet e mësipërme te pjesët

*Dita e parë e shkollës dhe Ani pjanistja.*





## ■ Plani i veprimtarisë

- Ritrego bukur dhe me hollësi sipas këtij *plani*:

Fëmijët shkuan për të peshkuar.  
Ata morën pajimet e peshkimit me vete.  
Në fillim shkuan te Bregu i Pulëbardhave.  
Pastaj shkuan te Gjiri i Qetësisë.  
Ata kapën një gjah të pasur.



### Punë në grup

- Ndahuni në tri grupe dhe secili grup të zgjedhë një veprimtari që do të realizojë. Por më parë duhet të bëni planin e veprimtarisë.

Lloji i veprimtarisë	
Qëllimi i veprimtarisë	
Pjesëmarrësit	
Udhëheqësi i grupit	
Koha	
Vendi	
Mjetet	
Mënyra e realizimit	
Përfundimi	

## ■ Fuqia e Mujit

Jetonte njëherë e një kohë, pranë Jutbinës, një malësor që kishte një vajzë dhe dy djem: Mujin dhe Halilin. Babai i tre fëmijëve mezi e siguronte bukën e gojës. Prandaj, sapo Muji hodhi shtat, ai e çoi te një pasanik që të punonte si bari lopësh.

Megjithëse Muji ishte ende i mitur, i duhej të ngrihej menatë, të vinte përpara lopët e zotërisë e t'i shpinte nëpër kullota.

Muji zgjidhte kullotat më të mira dhe, kur i zoti i milte, enët

mbusheshin plot, madje qumështi derdhej prej tyre. Por zotëria ishte aq i lig, sa vetëm bukë e kripë i jepte djaloshit të ngratë.

Një ditë Mujit i humbi një lopë nëpër bjeshkë. Oh, sa u mërzit ai! Dhe vendosi të mos kthehej atë natë në shtëpi. Siç ishte ashtu i lodhur nga të kërkuarit, u ul pranë një shkëmbi të merrte një sy gjumë. Nata ishte e errët, pa asnjë yll.

Papritmas Muji dëgjoji të qara fëmijësh. Ktheu kokën dhe pa aty pranë dy foshnja brenda në dy djepe. Atij i erdhi keq dhe filloi t'i përkundte, derisa i zuri gjumi.

Më vonë atij iu verbuan sytë nga dy drita të bardha. Ato paskëshin qenë dy zana të veshura me dritë. Ato iu afruan dhe i thanë:

– Ne të njohim ty, o Muj, mos u çudit. Ne i njohim dhe mundohemi t'i ndihmojmë njerëzit që kanë nevojë. Por, ama, ata që janë të mirë dhe të drejtë. Ne të vumë ty në provë dhe ti u kujdesë për foshnjat. Tani kërko nga ne ç'të duash. Do forcë? Do mall e gjë? Do dije? Do...

– Ah, moj zana të bardha, ju paskeni qenë fati im. Unë dua të jem i fortë se më ngacmojnë barinj të tjerë... më kanë halë në sy.

I thotë zana zanës:


– Motër, a i japim Mujit qumësht gjiri, që ta bëjmë të fortë?

– I japim motër.

Ato i japin vetëm tri pika dhe Muji ndien se mund të shkulë nga rrënja një lis bjeshke.

Po ato duan që ai të jetë më i fortë dhe i japin prapë qumësht.

– Tani ngrije atë shkëmb që është në këmbët e tua, – i thonë ato.



Muji e shkul nga vendi dhe e çon deri te nyja e këmbës. Më lart nuk e ngre dot. Zanat i japin përsëri qumësht. Ai e ngre shkëmbin deri te gjuri. Po zanat prapë s'janë të kënaqura. I japin përsëri qumësht dhe ai e ngre deri në brez.

– Prapë duhet t'i japim gji Mujit, – thonë ato.

Muji pi përsëri qumësht zane dhe e ngre shkëmbin mbi krye.

– Ku ta hedh, – u drejtohet ai zanave, – te Lugjet e Verdha apo në fushë të Jutbinës? Zanat buzëqeshin dhe i thonë njëra-tjetrës:

– Të mos i japim më gji Mujit, se mos shemb tërë botën.

Ndërkaq, në qiellin e errët kishte dalë hëna e portokalltë, që me dritën e saj ia shtonte edhe më shumë madhësinë Mujit.



## KUPTO TEKSTIN

Përshtatje nga *Cikli i këngëve legjendare për kreshnikët*

### Pyetje rreth tekstit

1. Ku jetonte Muji?
2. Në ç'gjendje ishte familja e tij?
3. Ç'ngjau ditën kur Muji humbi një lopë?
4. Çfarë i thanë zanat Mujit?
5. Çfarë u kërkoi Muji zanave? Pse?
6. Pse u trembën në fund zanat?



### Fjalorth

*hodhi shtat* – u zgjat; këtu: u rrit.

*menatë* – shumë herët në mëngjes.

*të merrte një sy gjumë* – të flinte pak.

*më kanë halë në sy* – më kanë shumë inat.

### Mëso

Muji është një personazh me fuqi të jashtëzakonshme, që arrin të shkulë lisa me gjithë rrënjë. Në këtë rast fjalët janë përdorur me kuptim të figurshëm. Veprimi zmadhohet shumë. Kjo është një figurë letrare që quhet **hiperbolë**.

### Kthehu te teksti

#### • Plotëso:

a. Çfarë ndodhi me Mujin, pasi piu qumësht zane:

Herën e parë .....

Herën e dytë .....

Herën e tretë .....

b. Cilat janë:

personazhet reale: babai i Mujit, .....

personazhet fantastike: .....

sendet fantastike: .....

vendi real: .....

koha: .....

### Detyrë

- Bëj dhe ti një përshkrim të shkurtër të personazhit të Mujit.  
Ndalu te: cilësitë fizike; cilësitë e karakterit.

# Llojet e fjalisë

## Kujto!

- Fjalja me të cilën tregojmë, quhet **fjali dëftore**. Në fund të saj vëmë pikë.
- Fjalja me të cilën pyesim, quhet **fjali pyetëse**. Në fund të saj vëmë pikëpyetje.
- Fjalja me të cilën shprehim kërkesë, urdhër, porosi, quhet **fjali nxitëse**. Në fund të saj vëmë pikë. Kur intonacioni është urdhërues, vëmë pikëçuditje.
- Fjalja me të cilën shprehim dëshirë, urim apo mallkim, quhet **fjali dëshirore** dhe në fund të saj vëmë pikëçuditje.
- Fjalitë fillojnë me shkronjë të madhe.

- Lexo tekstin e mëposhtëm dhe dallo llojin e fjalive.

Landi i uritur u sul te frigoriferi.

– Pse nuk ka më çokokrem dhe biskota?

Mami u përgjigj qetësisht:

– Ti nuk duhet të hash shumë ëmbëlsira.

– Kjo qenka e tmerrshme!

– Nuk i di ende rregullat e reja? Duhet të hash më pak sheqer dhe më pak yndyra.

Landi u sul për te patatinat.

– Mos i prek me dorë patatinat! Lëri aty ku janë! Hajde të hash supën me perime!

– Të lutem, ma, vetëm tri copë patatina më jep.

– Ulu tani këtu! Mos u bëj djalë i keq. Të bëftë mirë supa!



## USHTROHU

### 1. Lexo fjalitë dhe, sipas llojit, thuaj çfarë tregojnë.

Mbi tryezën e punës kishte vizore, trekëndësja etj.

Qielli ishte i kaltër e tek-tuk me re.

- Ende nuk e mbarove vizatimin?

- Rrofsh, moj motër!

- Ujiti lulet në mëngjes e në mbrëmje.

- Të lutem, babi, më ndihmo për ushtrimin!

- Kalo te vijat e bardha.

fjali dëftore

.....

.....

.....

.....

.....

.....

informacion

.....

.....

.....

.....

.....

.....

lutje

.....





# USHTROHU

## 2. Plotëso.

LLOJET E FJALISË	ÇFARË KUMTOJMË?	SHENJA E PIKËSIMIT
dëftore		pika .
pyetëse		
dëshirore	shprehim dëshira	
nxitëse		

## 3. Gjej dhe shkruaj llojin e fjalive të mëposhtme.

- Në oborrin e shtëpisë ishte një qershi. ....
- Qershia kishte një emër. ....
- Emrin ia kishte vënë gjyshi. ....
- Kishte emër qershia? .....
- Po. Ajo e kishte emrin Lumturi. ....
- Unë hipja shpesh në pemë. ....
- Zbrit nga pema! - më thoshte gjyshi. ....
- Mos u ngjit aq lart. ....
- Të lumshin këmbët! .....



## 4. Vendos shenjat e pikësimit dhe shkronjën e madhe aty ku duhen.

- Koni dhe shoqet e saj u afruan te cepi i shkëmbit aty pranë ishte një gji i vogël ranor dhe një varkë
- Çfarë të bëjmë me varkën – pyeti Koni.
- Fute në ujë
- Hajdeni ta shtyjmë bashkë ajo është e rëndë shtyje fort
- Sa i bukur qenka ky ishull Qenka vetëm për ne në të vërtetë aty nuk kishte këmbë njeriu
- Po, tani ne jemi tre Robinsonë
- po vetëm se ne kemi bukë e ushqime, – shtoi Billi
- mos the gjë ushqime – pyeti koni
- Edhe ti ke uri – tha billi
- ku do të hamë – pyetën njëzëri vajzat
- Këtu pranë është një shpellë e vogël. aty do të hamë

## 5. Ndërto në fletore një tekst me 5-6 fjali të llojeve të ndryshme për një veprimtari që keni realizuar në klasë.

## Fjalitë dëftore dhe pyetëse

Fjalitë me të cilën tregojmë, quhet **fjalitë dëftore**.

Fjalitë dëftore mbaron me **pikë**.


Fjalitë me të cilën pyesim, quhet **fjalitë pyetëse**.

Fjalitë pyetëse mbaron me **pikëpyetje**.

### Kujto

Ti ke mësuar se ka fjalitë me të cilat pyesim dhe fjalitë me të cilat tregojmë. Thuaj nga një fjalitë për secilin rast.

- Dallo fjalitë me të cilat tregojmë dhe fjalitë me të cilat pyesim.



Kur flasim, llojin e fjalisë e dallojmë nga **intonacioni**, pra nga mënyra si i shqiptojmë fjalët, si dhe nga **rendi**, mënyra si renditen fjalët në fjali.

Kur lexojmë ose shkruajmë, llojin e fjalisë e dallojmë nga shenja e pikësimit: pika ( . ) ose pikëpyetje ( ? ).



# USHTROHU

**1. Fjalitë e mëposhtme janë të njëjta. Nga se ndryshojnë ato? Lexoji me intonacionin e duhur.**

Ti e pe mbrëmë filmin e ri.  
Djemtë fituan garën.  
Vajzat kënduan të parat.

Ti e pe mbrëmë filmin e ri?  
Djemtë fituan garën?  
Vajzat kënduan të parat?

- Krijë tri fjali të këtij lloji dhe lexoji si fjali pyetësor dhe si fjali deklarativ.

**2. Dallo llojin e fjalisë. Shkruaj në kuti D për fjalitë deklarative dhe P për fjalitë pyetëse. Lexoji me intonacionin e duhur.**

- Lira dhe vëllai i saj i vogël i kanë shumë qejf përrallat.
- Çdo mbrëmje gjyshja u lexon atyre një përrallë.
- Ata e dëgjojnë gjyshen me vëmendje.
- Pastaj ata i bëjnë shumë pyetje.
- Gjyshe, si ishte Hirushja?
- Pse e kishte emrin Hirushe?  – Kush e ndihmoi Hirushe?
- Ku bëhej darka e princit?  – Si e njohu princi Hirushe?
- A u martuan bashkë ata?
- Gjyshja mezi u përgjigjet pyetjeve të shumta të fëmijëve.



**3. Lexo me intonacionin e duhur fjalitë. Vendos pikë (.) ose pikëpyetje (?) aty ku mungon.**

Atë verë xhaxhi shkrimtari ishte në plazh me familjen. Një ditë po i blinte djalit një akullorë  Aty pranë u afrua një vajzë e vogël

– Si je, Arbana  Kur ke ardhur  Si janë mami dhe babi

Vajza lëvizte kokën dhe përgjigjej me shenja  Xhaxhi shkrimtari e pyeti i habitur shitësen:

– Pse vajza flet me shenja

Shitësja i tha se ajo jeton në Itali  Ajo kupton shqip, por nuk flet dot

Xhaxhi shkrimtarit i erdhi shumë keq

**4. Duke parë figurën krijë katër fjali pyetësor. Shkruaj në fletore përgjigjet e pyetjeve me fjali deklarativ.**

Kush .....

Kur .....

Ku .....

Çfarë .....



# Fjalitë dëshirore dhe nxitëse

- Lexo fjalitë e mëposhtme.

## Kujto

Me anë të fjalive ne shprehim urime dhe dëshira, nxitim ose urdhërojmë dikë etj. Thuaj ndonjë shembull.

Ela, mendo për festën e mamit.



Urdhëro lulet.



Mami, u bëfsh 100 vjet!



Dy fjalitë e para janë nxitëse. Fjalja e tretë është dëshirore.

Fjalitë me të cilat shprehim kërkesë, urdhër, porosi, lutje quhen **fjali nxitëse**. Këto fjali shprehen me intonacion të veçantë, p.sh., lutës, urdhërues etj. Zakonisht, në fund të tyre vihet **pikë**. Po kur intonacioni është urdhërues, mund të vëmë edhe **pikëçuditje (!)**.

- Lexo fjalitë e mëposhtme me intonacionin e duhur.

- |   |         |
|---|---------|
| – Ela, thuaji tezes për festën e mamit.   | porosi  |
| – Babi, të lutem, më jep lekët për lulet. | kërkesë |
| – Joni, eja sa më shpejt në shtëpi!       | urdhër  |
| – Ela, zgjidh një buqetë të bukur.        | lutje   |

Fjalitë me të cilat shprehim dëshirë, urim apo mallkim, quhen **fjali dëshirore**. Këto fjali shprehen me një intonacion të veçantë. Në fund të tyre vëmë **pikëçuditje (!)**.

- Lexo fjalitë e mëposhtme me intonacionin e duhur.

- |  |         |
|--|---------|
| – E gëzofte mami ditëlindjen! – uroi shitësja. | urim    |
| – Mami, u bëfsh edhe 100 vjet!                 | urim    |
| – Qofshim gjithmonë të lumtur!                 | dëshirë |
| – T'u thaftë goja!                             | mallkim |



## ■ Dheu është flori

Një bujk plak para se të vdiste, thirri tre djemtë e tij dhe u tha:

- O bijtë e mi, arën para shtëpisë unë e kam punuar gjithë jetën time dhe me drithin e saj ju kam ushqyer e ju kam rritur deri tani. Tamam në këtë arë kam fshehur një qyp me florinj. Gërmoni thellë dhe kërkoni në të gjitha anët e saj për ta gjetur qypin. Dhe ju nuk do të jeni të varfër asnjëherë.

Pas vdekjes së babait, të tre bijtë e plakut, zunë ta gërmonin arën në të gjitha anët. Ata e gërmonin dheun dhe mot për mot e thellonin nga një pëllëmbë më tepër. Po qypin përsëri nuk e gjenin dot.

Sa më shumë që e punonin arën, aq më tepër prodhime jepte ajo. Nga prodhimet e saj vëllezërit jo vetëm që jetonin, por u tepronte shumë edhe për të shitur. Të hollat që merrnin nga prodhimet e shitura, i hidhnin në një qyp për t'i kursyer.

Për pesë vjet qypi u mbush plot me florinj. Vetëm atëherë vëllezërit e kuptuan se ku ishte qypi me florinj, që u tha i ati.

Sami Frashëri

### Pyetje rreth tekstit

1. Çfarë u tha babai djemve para se të vdiste?
2. A e mbajtën vëllezërit fjalën e babait?
3. A e gjetën vëllezërit qypin që u tha babai?
4. Si arritën ata të bëhen të pasur:

me punë

apo

gjetën thesarin e babait?

### Fjalorth

qyp – enë balte për ujë ose ushqime.

të hollat – paratë



## ■ Fjalë të urta

Fjalët e urta janë krijuar nga mësimet që dalin prej përvojës së jetës.  
Fjalët e urta kalojnë gojë më gojë e brez pas brezi.  
Mesazhet e tyre janë të rëndësishme për çdo kohë.

- Plotësoji me fjalë të tjera më të thjeshta këto fjalë të urta:

- Të vërtetën mbroje burrisht.

*Të vërtetën mbroje me këmbëngulje.*

- E vërteta nuk mbytet në ujë, as nuk digjet në zjarr.

.....

- Një bletë e vetmuar nuk bën dot shumë mjaltë.

.....

- Mendja e madhe, e keqja e vetes.

.....

- Gurë, gurë bëhet kalaja.

.....

- Gjuha ruhet atje ku shkruhet.

.....

- Besa e shqiptarit si purteka e arit.

.....

- Ai që di shumë, flet më pak.

.....

- Dita e mirë shihet qysh në mëngjes.

.....

- Dija është dritë, padituria është errësirë.

.....

- Zogun e zbukurojnë pendët, njeriun mësimi.

.....



- Shkruaj pesë fjalë të urta duke dhënë mesazhin e tyre.

# Fjalitë me të cilat shprehim emocion

## Kujto!

Thuaj një fjali që shpreh ndjenjën e gëzimit. Me çfarë shenje pikësimi mbaron ajo?  
Thuaj një fjali që shpreh zemërim. Me çfarë shenje pikësimi mbaron ajo?

- Shiko figurat dhe lexo fjalitë poshtë tyre.



Ç'qen i pabindur që je!  
Fjali dëftore që shpreh **zemërim**.



Sa ftohtë qenka jashtë!  
Fjali dëftore që shpreh **habi**.



Ç'ditë e bukur është sot!  
Fjali dëftore që shpreh **kënaqësi**.






E gjora vajzë, sa temperaturë që ka!  
Fjali dëftore që shpreh **keqardhje**.

Me fjali dëftore ne mund të tregojmë dhe të shprehim edhe ndjenja të ndryshme, si: *habi, kënaqësi, keqardhje, zemërim*. Në fund të tyre vendoset **pikëçuditje**.



# USHTROHU

1. Çfarë shprehin këto fytyra? Plotëso.



.....

.....

.....

.....

2. Lexo fjalitë dhe lidhi me shigjetë se çfarë shprehin.

Sa qenke rritur!  
 Sa bukur ke vizatuar!  
 Ç'djalë i padëgjuar që je!  
 S'ta fal veprimin që bëre!  
 Obobo, sa qenke vrarë!  
 Sa i mirë je, o Tori!  
 Ti s'paske ndryshuar fare!  
 S'ka si mësuesja jonë!  
 Ishin mbaruar biletat!

habi

kënaqësi

zemërim

keqardhje

3. Vendos shenjën e pikësimit që duhet.

- Si gjyshi im nuk ka në botë  Sa shumë gjëra di ai  Si nuk mërztet  
 një herë me mua  Ne të dy jemi shokë të mirë  Po një ditë gjyshi  
 u sëmur  Obobo, sa temperaturë kishte   
 – Do të shërohet gjyshi, moj mami   
 – Patjetër që do të shërohet   
 – Sa mirë  Përsëri do të luajmë bashkë

• Dallo fjalitë dëftore, pyetëse dhe ato që shprehin ndjenja të ndryshme.

4. Shiko figurën.

Krijo 4 fjali të ndryshme sipas shembujve të mësipërm.



# ■ Pjesët kryesore të fjalisë. Kryefjala

## Kujto!

Kryefjala është një nga pjesët kryesore të fjalisë. *Vajza (Kush?) lexon.*  
Kryefjala tregon për kë flitet.  
Kryefjala gjendet me pyetjet: *Kush?, Cili?...*

Lexo fjalitë:

1. **Princi** trokiti në pallatin mbretëror.  
**Kush** trokiti? Princi.
2. **Ai** i kërkoi mbretëreshës mollën.  
**Cili** ia kërkoi mollën mbretëreshës? Ai.
3. **Molla e kuqe** kishte brenda princeshën.  
**Cila** kishte brenda princeshën? Molla e kuqe.



Kryefjala mund të jetë:

- emër** — princi (Kush?)
- përemër** — ai (Kush?)
- grup fjalësh** — molla e kuqe (Cila?)

## Kujdes!

Pyetja *Kush?* përdoret vetëm kur pyesim për njerëz.  
Pyetjet: *Cili?, Cila?...* përdoren për gjithçka: njerëz, kafshë, sende etj.



## USHTROHU

1. Lidh me shigjetë kryefjalën me pjesën tjetër të fjalisë.

Njerka e keqe  
Shërbëtori besnik  
Ajo  
Halla  
Vashëza  
Princi  
Unë

u martua me princeshën-mollë.  
i kërkoi ndihmë hallës.  
e ndihmoi princin.  
e lexova me shumë kënaqësi këtë përrallë.  
doli nga molla.  
ishte magjistare.  
i dha nipit një pluhur magjik.



2. Plotëso fjalitë me kryefjalët që janë dhënë më poshtë:

..... jetonte në breg të një oqeani. .... kishte një  
ëndërr të madhe. .... donte të fluturonte mbi Detin e Delfinëve.  
..... i dha kurajë. .... guxoi. Ai arriti deri në Detin e  
Delfinëve. .... nuk e besuan. Por atë e besoi .....



shpendi      nëna      albatrosi      ai      shokët  
ky shpend detar      nëna e tij

3. Nënvizu me të kuqe kryefjalën emër, me të kaltër kryefjalën përemër dhe me të gjelbër kryefjalën me grup fjalësh.

Arta lexon shumë libra. Ajo ka qejf librat me tregime. Dritoni pëlqen tregimet fantastiko-shkencore. Piter Pani është një personazh magjik. Veprimet e tij janë të çuditshme. Ju lexuat një përrallë. Ti pe në televizor filmin "Pika e ujit". Personazhi i filmit ishte personazh fantastik. Librat janë shumë interesantë. Unë do të bëhem shkrimtare për fëmijë.

4. Formo fjali ku fjalët e mëposhtme të jenë kryefjalë.

Përralla .....  
Ne .....  
Librat .....  
Gjuha shqipe .....

5. Nënvizu kryefjalën në fjalitë e mëposhtme. Shkruaj pyetjen me të cilën e gjetë.

Ne mbollëm pemë në kopshtin e shkollës. Cilët mbollën pemë?  
Muzika e filmit ishte e bukur. ....  
Ajo më pëlqeu shumë. ....  
Vajzat e vogla luajnë me kukulla. ....  
Zogjtë fluturojnë ulët. ....  
Ata tregojnë afrimin e shiut. ....  
Unë isha i sëmurë. ....

(Kujdes! Kur të bësh pyetjen, mos e ndrysho kohën e foljes.)

6. Krijë gjashtë fjali ku kryefjala të jetë emër, përemër dhe grup fjalësh.

# Gjëegjëza

Pikturuar ngjyra-ngjyra,  
krahët ia ka bërë natyra.  
Mbi petla s'ndihet fare,  
si një mjeshtre kërcimtare.

(Flutura)

Një pusullë e dashur, e palosur  
më dysh. Adresa: një lule.

(Flutura)

Lodra që i pëlqen më tepër erës.

(Dallëndyshja)

Secila prej tyre i ngjet numrit  
3. Kur vihen në rresht janë  
333333333333... pa mbarim.

(Milingona)

Bredh ndër lule shkon e vjen,  
lodhje asnjëherë s'ndien,  
e pastaj kutizat mbush,  
t'ëmbëlsohesh vogëlush.  
A e gjen kush?

(Bleta)

Çfarë po ndodh? Ora  
nëntë e mbrëmjes dhe  
në shtëpinë e saj ka  
ende dritë.

(Xixëllonja)

Kush shëtiti pa  
dalë nga shtëpia?

(Breshka)

Shpendi që mban sqepin  
e vet në një përparëse.

(Pelikani)

Gjëegjëzat mund të  
shkruhen në vargje me  
rimë, por ato mund të jenë  
dhe vetëm një fjali.

- Përpiqu të gjesh që në leximin e parë gjëegjëzat.

## Bisedojmë së bashku

Ai që i gjen gjëegjëzat me të parën herë e ka të zhvilluar cilësinë e të vëzhguarit.

- Po ti a je një vëzhgues i mprehtë i gjërave?
- Pse është mirë të dish shumë gjëegjëza?

## Plotëso

- Në këto gjëegjëza vihet në dukje cilësia kryesore e secilës kafshë. Kjo është cilësi fizike shumë e dallueshme:

Flutura	me krahët ngjyra-ngjyra
Bleta	.....
Xixëllonja	.....
Milingona	.....
Dallëndyshja	.....
Pelikani	.....
Breshka	.....

- Cila prej këtyre kafshëve të pëlqen më shumë? Pse?

## ■ Liza në botën e çudirave

– Kush je ti?

Liza mbeti pa folur një çast. Të ishte ndonjë ditë tjetër, do të ishte përgjigjur menjëherë: “Jam Liza”. Por ndihej paksa e paqartë.

– Në fakt, nuk e di çfarë jam. Po të doni, ju them se çfarë isha sot në mëngjes. Ajo po, që më kujtohet, por që nga mëngjesi jam shndërruar disa herë dhe se çfarë jam tani, eh, mbetet një mister!

– Në ç’kuptim?

Liza u mendua.

– Ju jeni një Vemje, apo jo? Pra, ndonjë ditë do të shndërroheni në një larvë e më pas në një flutur. Atëherë as ju s’do të jeni më ju, dhe...

– Unë e di çfarë jam.

Krejt papritur Lizës iu duk vetja budallaqe.

– Më parë dhe unë e dija çfarë isha. Vetëm se tani s’më kujtohet.

– Përderisa s’të kujtohet, nga e di që më parë e dije?

Vajza kroi ballin.

– S’e kisha menduar. Por me siguri disa gjëra që di, zhduken kur zvogëlohesh. Hapësira në një kokë të vogël, nuk është njësoj si te një kokë e madhe dhe e bollshme. Vemja mbylli sytë, pastaj i hapi dhe e pyeti Lizën:

– Ndiresh e vogël?

– E vockël fare! – u përgjigj vogëlushja, duke drejtuar trupin.

– Unë jam tre gishta e gjatë dhe më duket një gjatësi e shkëlqyer!

Liza u skuq e turpëruar.

– Po ç’rëndësi ka? Unë s’jam mësuar kështu.

“Sa shpejt u ngelka hatri këtyre Vemjeve, – mendoi. – S’e kisha vënë re këtë gjë.”

Vajza priti që Vemja ta harronte fyerjen. Dhe iu desh pak kohë, sepse shumëkëmbëshat janë të ndjeshëm, kur



s'ua gjen anën. E meqë kurrë nuk kuptohet se nga e kanë kokën dhe nga bishtin, është shumë e vështirë t'ua gjesh anën e duhur. Më në fund Vemja u shtriq, zgjati trupin e butë dhe u drejtua si një çorap bosh. Pastaj zbriti nga kërpudha dhe u largua duke gjarpëruar nëpër bar.

– Gjithsesi, një anë të bën më të madhe, ndërsa ana tjetër të bën më të vogël, – tha teksa po zhdukej mes degëve.

Liza u drodh. “Një anë e çfarë gjëje?” – mendoi.

– E KËRPUDHËS! – thirri Vemja nga larg, sikur t'i kishte lexuar mendjen.

Vogëlushja vëzhgoi kërpudhën me vëmendje.

Hëm! Njëra anë do të më rritë..., por cila?

Ishte një pyetje e shkëlqyer. Sidomos ngaqë kapela e kërpudhës ishte rrethore dhe kishte anë gjithandej. Më në fund Liza u ul mbi të, i zgjati krahët sa mundi dhe këputi një copëz me dorën e majtë dhe një me të djathtën.

Pastaj kafshoi copën që kishte në dorën e djathtë për të parë efektin që do të shkaktonte. Menjëherë ndjeu se u shtyp për poshtë dhe përplasi mjekrën te njëri gju.

– Uh!

Por arriti ta mbyllte gojën, aq sa mund të kafshonte dhe copëzën

tjetër të kërpudhës që kishte në dorën e majtë,

kur e pa veten shumë të gjatë, me flokët e ngatërruar nëpër degët e pemëve, një fole zogjsh te hunda dhe këmbët i kishte aq larg, sa i dukeshin si milingona.

– Oh, nëna ime! S'po i bie hiç në të! Pas shumë përpjekjesh dhe kafshatash, i gjeti përmasat e saj normale. Ishte bërë kaq shumë herë e madhe dhe e vogël sa në fillim u çorodit, por shumë shpejt u mësua dhe vazhdoi rrugën me mënyrën e saj, që as nuk e njihte.

*"Liza në botën e çudirave", nga seria "Klasikët për të vegjël",*

*Ljuis Kerroll, përktheu L.Hyseni*





# KUPTO TEKSTIN

## Fjalorth

larvë - trajtë fillestare e kandrrave, e krimbave, e bretkosave etj.

u shtriq – e shtriu trupin, gjymtyrët; u shpi.

çorodit – ketu: u hutua dhe u ngatërrua keq.

## Pyetje rreth tekstit

1. Cilat personazhe bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin?  
Ku gjenden ato?
2. Pse Liza heshti një çast, kur e pyeti Vemja se cila ishte?
3. Çfarë kishte ndodhur me Lizën që prej mëngjesit?
4. Në kohën që po bisedon, Liza është e madhe apo e vogël?  
Nga e kuptove?
5. Çfarë bëri Liza pas këshillës së Vemjes?

## Po ti?

- Imagjinoje veten në vend të Lizës. Si do të ndiheshe?  
I/e hutuar apo shumë i/e qartë?
- Cilën anë të kërpuhdës do të zgjidhje për të ngrënë:

të djathtën apo  të majtën? Pse?

## Plotëso

Shëno **V** e vërtetë ose **G** e gabuar.

Kush i thotë këto fjalë:

Vemja , Liza  : – Unë jam tre gishta e gjatë dhe më duket një gjatësi e shkëlqyer!

Vemja , Liza  : – Sa shpejt u mbetka hatri këtyre...

Vemja , Liza  : – Hapësira në një kokë të vogël, nuk është njësoj si te një kokë e madhe...

Vemja , Liza  : – Unë e di çfarë jam.

- Si quhen:

bima fantastike .....

larva që flet .....

vajza që shndërrohet .....

## Punë në grup

- Lexojeni bukur pjesën duke e ndarë në role:  
autori, Vemja, Liza.



TEATRI I  
SHKOLLËS



# Kallëzuesi



## Kujto!

Kallëzuesi tregon se ç'bën kryefjala.  
Drini noton. Ç'bën Drini?

Anija kozmike **fluturon** për në Hënë. **Ç'bën** anija? Fluturon.  
Ajo **është e shpejtë**. **Si është** anija? Është e shpejtë.  
Hëna **është satelit**. **Çfarë është** Hëna? Është satelit.



Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë.  
Ai tregon ç'bën, si është dhe çfarë është kryefjala.

Kallëzuesi mund të jetë:

**folje** që tregon veprim ose gjendje: *fluturon, punoj, çuditëm* etj.

**folja jam + mbiemër** që tregon si është kryefjala: *jam i shpejtë, jam i bukur,*

**folja jam + emër** që tregon ç'është kryefjala: *është satelit, ishte kozmonaut*

Kallëzuesi që shprehet me folje, quhet kallëzues foljor.

Kallëzuesi që formohet nga folja *jam* + emër ose mbiemër, quhet kallëzues emëror.



## USHTROHU

### 1. Plotëso fjalitë me kallëzues.

Era ..... me tërbim.

Harabeli ..... në fole.

Gjethet ..... në tokë.

Degët ..... nga era.

### 2. Plotëso kallëzuesin me një emër ose mbiemër.

Përralla "Princeshë Ardita" është..... Princesha ishte ..... e pallatit.

Agimi nuk ishte ..... Ai ishte ..... me të gjithë.

### 3. Nënvizto kallëzuesit (kallëzuesit me folje dhe kallëzuesit me foljen *jam* + emër ose mbiemër).

Andi dhe Beni janë shokë. Ata luajnë gjithmonë bashkë. Beni është sportist. Ai është i zoti. Beni stërvitet çdo ditë në një shesh pranë shtëpisë. Sheshi është i madh. Trajneri stërvit futbollistët. Ai është i përgatitur. Fëmijët kënaqen me të.

# ■ Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën

Vër re si ndryshon kallëzuesi kur përshtatet me kryefjalën.

Unë shikoj garën.  
Ti shikon vrapuesit.  
Ajo shikon pistën.

Ne shikojmë garën.  
Ju shikoni vrapuesit.  
Ata shikojnë pistën.



Kallëzuesi (me folje) përshtatet me kryefjalën në *vetë* dhe në *numër*.  
Kallëzuesi (me foljen **jam** + **emër** ose **mbiemër**) përshtatet me kryefjalën në *vetë*, *numër* dhe *gjini*.

Folja **jam** + **emër**

Ajo është këngëtare.

Ai është këngëtar.

Ato janë këngëtare.

Ata janë këngëtarë.

Folja **jam** + **mbiemër**

Vajza është e shkathët.

Vajzat janë të shkathëta.

Andi është i shpejtë.

Jona është e shpejtë.



## USHTROHU

1. Zgjidh kallëzuesin e duhur dhe rrethoje me ngjyrë të kuqe.

Ylli (jam, është, janë) në qiell.

Ai (ndriçon, ndriçoj, ndriçojnë) më fort se të tjerët.

Ti (je, jeni, është) i kuq.

Udhëtarët (vështroj, vështrojnë, vështrojmë) gjithmonë yllin me admirim.

Ylli u (tregojnë, tregon, tregoj) drejtimin udhëtarëve natën.

2. Plotëso fjalitë. Përshtat kallëzuesin me kryefjalën.

Pema është e lartë.

Pemët janë .....

Skifteri është i fortë.

Shqiponjat .....

Unë jam këngëtare.

Ne .....

Ju jeni piktorë.

Ti .....

Majmunët janë të zgjuar.

Majmuni .....

3. Përshtat kallëzuesin me kryefjalën. Shkruaj si duhet kallëzuesin.

Një gjirafë (isha mburravec) ishte mburravece.

Unë (jam gjirafat) ..... më e gjatë.

Vëllezërit e motrat (ishin e pakënaqur) ..... me mburrjet e saj.


Edhe të tjerët (ishte të mërzitur) ..... prej saj.

Një majmun i (punove) ..... asaj një rreng.

Gjirafa (mora) ..... një mësim të mirë.

# Luani dhe dhelpira e mençur

Një ditë luani u ndie shumë keq. Ai i lajmëroi të gjitha kafshët se po vdiste dhe donte t'u thoshte dëshirat dhe porositë e tij të fundit. Erdhi dhia në guvën e luanit dhe ndenji të dëgjonte porositë e tij. Pastaj u fut delja. Para se të ikte ajo, mbërriti viçi që të dëgjonte edhe ai dëshirat e fundit të mbretit të kafshëve. Mirëpo pas pak, luani e ndjeu veten më mirë. U ngrit e shkoi në grykë të shpellës dhe pa aty jashtë dhelpren që po priste prej kohësh.



- Pse s'erdhe si gjithë të tjerët të tregoje respekt ndaj meje? – i tha luani dhelpres.  
- Të kërkoj ndjesë, Madhëri, - i tha dhelpira, - por i pashë gjurmët e kafshëve që erdhën te ju. Vura re gjurmë thundrash që hynin, por s'pashë as edhe një që të dilte. Derisa të dalin kafshët që hynë në guvën tuaj, po rri më mirë në ajër të pastër.

**Është më lehtë të hysh në kurthin e armikut, sesa të dalësh prej tij.**

Ezopi



## KUPTO TEKSTIN

### Pyetje rreth tekstit

1. Pse luani i thirri të gjitha kafshët në strofllin e tij?
2. Cilat kafshë shkuan të parat?  
....., ....., .....
3. Pse dhelpira nuk shkoi? Çfarë i tha ajo luanit?
4. Si e kupton ti fjalinë me të cilën mbyllet kjo fabul?

### Kthehu te teksti

Shëno **V** e vërtetë ose **G** e gabuar.

- Dhia doli e para nga guva e ujkut.
- Dhia u fut e dyta në guvën e luanit.
- Viçi doli i fundit nga guva e luanit.
- Luani u ndie mirë, se kafshët e respektuan.
- Luani u ndie mirë, se hëngri një drekë të shijshme.
- Dhelpira nuk hyri në guvë, se e kuptoi dredhinë e luanit.



### Fjalorth

*thundër* – pjesë e brittë që kanë në fund të këmbëve disa kafshë.



# Fabula

- Në këtë tekst mungojnë fjalët e personazheve. Plotësoji ti.

## DHELPA DHE LEJLEKU

Një ditë prej ditësh, dhelpra e ftoi për drekë lejlekun. Po dhelpra njihet që është dinake.

**Dhelpra:** *A do të vësh nesër për drekë te shtëpia ime?*

**Lejleku iu përgjigj:** .....

Në drekë dhelpra e hodhi supën në pjata të cekëta. Ajo hante me shumë lehtësi. Ndërsa lejleku arrinte të lagte vetëm majën e sqepit të gjatë. Pas drekës ata bënë këtë bisedë së bashku:

**Dhelpra:** .....

**Lejleku:** Ishte shumë e shijshme, po sot, ja që nuk paskam shumë uri.

Lejleku vendosi që t'i bënte edhe ai një rreng të ngjashëm dhelprës. Dhe kështu vendosën ditën kur dhelpra do t'i kthente vizitën për drekë lejlekut.

**Lejleku:** E dashur dhelpër, është radha ime .....

**Dhelpra:** .....

Lejleku e shërbeu ushqimin nëpër qypa të gjatë me qafë të hollë, në të cilët dhelpra e kishte të pamundur ta fuste turirin. Ajo arriti vetëm ta lëpinte nga jashtë qypin, ndërsa lejleku e zhyste sqepin në qyp dhe mernte prej andej gjellën e shijshme.

**Lejleku:** E dashur dhelpër, është radha ime .....

**Dhelpra:** .....



Në këtë mënyrë lejleku e vuri në lojë dhe i ktheu kështu përgjigjen e merituar dhelprës dinake.

# Shenjat e pikësimit

. ? ! " "

## Kujto

Në fund të fjalisë dëftore dhe nxitëse vihet **pikë**.

Në fund të fjalisë pyetëse vihet **pikëpyetje**.

Në fund të fjalisë dëshirore dhe fjalisë që shpreh emocion vihet **pikëçuditje**.

Emrat e përveçëm të rrugëve, shesheve, shkollave, titujt e librave etj., vendosen brenda **thonjëzave**.

## 1. Vendos shenjat e pikësimit që mungojnë.

Andi e do shumë zonjën Fink. Një të diel ai shkoi ta shihte. Po sa u çudit. Zonja Fink punonte pa ngritur kokën nga makina qepëse.

– E dini që sot është e diel – e pyeti i çuditur Andi.  
– E di, po më duhet t’i mbaroj së qepuri të gjitha këto përparëse.

– Po për drekë si do t’ia bëni.

– Sot s’kam drekë. S’kam kohë as për të gatuar.

– Sa keq – tha Andi. – Ju duhet të hani. Unë do të përgatis për ju diçka.

Andi vuri tenxheren në zjarr. Ai hodhi aty disa patate dhe qepë të njoma.

– Janë zier patatet tani – pyeti zonjën Fink.

– Prapë nuk qenkan bërë – u çudit Andi. – Sa shumë kohë u dashka për t’u zier ato.

Kur gjella ishte gati, Andi me zonjën Fink u ulën në tryezë.

– Të lumshin duart e vogla. Nuk kam ngrënë kurrë gjellë kaq të shijshme.



## 2. Vendos ku duhet shkronjën e madhe dhe shenjën e pikësimit.

Ishte natë. Pinoku po qante me zë të lartë kurthi i kishte zënë këmbën.

– t’u thaftë këmba, vjedhacak i keq! – e mallkoi fshatari. – Pse hyre në kopsht.

– Pse s’më beson. Nuk i kam marrë unë, – bërtiti pinoku i frikësuar. – unë kam marrë vetëm dy vile rushi.

– pse sillesh kështu, pse e turpëron baba, xhepeton, shko tani –

– Mirë u takofshim.



## 3. A janë vendosur pikat në vendin e duhur? Shkruaji si duhet fjalitë në fletore.

Bora ka rënë. Mbi drurët dhe çatitë e shtëpive fëmijët rrëshqasin. Në rrugët me borë vetëm brenda në shtëpi. Është ngrohtë, dielli shkëlqen. Në qiell, qirinj akulli varen nga çatitë e shtëpive.



# Shkronja e madhe (drejtshkrim)

## Kujto!

Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe. Fjalja fillon me shkronjë të madhe.

- Dalloni në tekst fjalët me shkronjë të madhe. Nënvizoni me të kuqe emrat e përveçëm dhe me të kaltër fjalët me të cilat fillojnë fjalitë.

Qyteti më i madh i Maqedonisë së Veriut është **Shkupi**. Ai shtrihet në të dyja anët e lumit Vardar. Në lashtësi njihej me emrin Scupi dhe ishte qendër administrative e Dardanisë. Në shekullin XV u ndërtua Ura e Gurit. Shkupi është kryeqyteti i Republikës së Maqedonisë së Veriut .



- Plotëso: emër shteti ....., emër lumi .....,  
emër qyteti ....., emër antik (i vjetër) .....,  
emër ure ....., qendra administrative .....



## USHTROHU

### 1. Shkruaj emrat e përveçëm të pjesëtarëve të familjes.

mami .....	babi .....
gjyshi nga mami .....	gjyshi nga babi .....
gjyshja nga mami .....	gjyshja nga babi .....
vëllai .....	motra .....

### 2. Shkruaj disa emra të përveçëm për emrat e përgjithshëm të mëposhtëm:

mace .....	shesh .....	makinë .....
skadër sportive .....	kinema .....	shkollë .....
restorant .....	stadium .....	

### 3. Shkruaj ku duhet shkronjën e madhe. Korrigjo emrat e shkruar gabim.

fçinjët e mi, drita dhe Ilir shkëmbi, janë nga fshati. ata kanë tre fëmijë: vjollcën, drinin dhe dëshirën. Kur u shpërngulën në tetovë, ata në fillim banuan në rrugën e prizrenit. Tani banojnë në bulevardin "iliria", pranë sheshit "dëshmorët e lirisë". Vjollca mëson në shkollën "naim frashëri", drini mëson në shkollën "bashkimi", kurse dëshira shkon në kopshtin reze drite.

**Kujdes!** Emrat e rrugëve, shesheve, shkollave etj., futen në thonjëza (" ").

## ■ Çfarë i ndodhi kameleoni?

Në këtë histori mungon pjesa kryesore. Krijoje ti me fantazinë tënde.



### KAMELEONI QË DONTE TË NDRYSHONTE

Një ditë, kameleoni u ngjit duke u zvarritur në një kodër të lartë. Prej aty, ai pa një kopsht zoologjik. Nuk kishte parë deri atëherë kafshë aq të bukura.

Kështu që vendosi .....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Tani kishte marrë pak nga të gjithë. Ishte bërë lara-lara, me ngjyrat që ia falën kafshët. Por, kur pranë tij fluturoi një mizë, ai nuk arriti ta kapte. Dhe ishte kaq i uritur.  
– Ah, – tha me vete kameleoni laraman, – do të doja të kthehesha edhe një herë siç isha. Dhe filloi të dridhej nga frika se mos e dallonin grabitqarët.

## ■ Princesha-mollë

Na ishin njëherë një mbret dhe një mbretëreshë, të cilët nuk kishin fëmijë.

- Pse të mos bëj edhe unë fëmijë, ashtu si pema e mollës bën mollë? – thoshte e pikëlluar mbretëresha.

Një ditë prej ditësh mbretëresha bëri një mollë kuqalashë të mrekullueshme në vend të fëmijës. Mbreti e vuri mollën në një tabaka të artë dhe e vendosi në tarracën e tij.

Përballë kështjellës së mbretit jetonte një princ. Një ditë të bukur ai pa në tarracën përballë një vashëz të bukur, të bardhë e të kuqe si një mollë, e cila po krihej në diell. Princi mbeti gojëhapur nga bukuria e vajzës. Por vajza, kur e pa princin, hyri me nxitim brenda në mollë dhe u zhduk.

Që atë ditë princi ra në dashuri me vajzën e mollës. Mendoi e mendoi dhe një mëngjes trokiti në pallatin mbretëror. Ai iu lut me gjithë shpirt mbretëreshës që t'ia jepte atij mollën e kuqe.

- Ç'thoni kështu?! - i tha mbretëresha. - Nuk e dini që e kam dëshiruar me shpirt atë.

Po princi iu lut kaq shumë dhe kaq shumë iu betua se do ta ruante si sytë e ballit, sa mbretëresha më në fund pranoi. Çdo ditë princi mezi priste agimin, kur vashëza dilte nga molla dhe krihte flokët e mrekullueshëm.

Princi jetonte me njerken, e cila filloi të dyshonte, se përse ai mbyllej vazhdimisht në dhomën e tij.

Një ditë, kur princi u largua nga pallati, ia besoi mollën shërbëtorit të tij më besnik. Njerka e vuri në gjumë shërbëtorin dhe s'la vend pa kërkuar. Më në fund gjeti një mollë të hijshme në një shportëz të artë.

- A thua kjo mollë të jetë e fshehta e tij?!

Mori një biçak dhe filloi ta qëronte mollën.

Kur shërbëtori u zgjua, e gjeti mollën të mbytur në gjak. Vrapoi te halla e tij, e cila ishte magjistare, dhe iu lut t'ia jepte një nga pluhurat e saj magjike. Shërbëtori u kthye te molla dhe e spërkati atë me pluhurin çudibërës.



Molla u ça dhe prej andej doli vashëza e rrethuar me fasha.

Kur u kthye princi, vajza i foli për herë të parë:

- Jam 18 vjeçe dhe sapo u çlirova nga magjia. Nëse vërtet më do, duhet të kërkosh dorën time te prindërit e mi.

- Natyrisht që të dua! – u hodh princi i lumtur.

Dhe u bë një dasmë madhështore dhe e hareshme mu në mes të dy kështjellave mbretërore. Mungonte vetëm njerka, e cila ia mbathi dhe nuk u duk më kurrë.

Italo Kalvino



## KUPTO TEKSTIN



### Fjalorth

*mbeti gojëhapur* – u shtang; këtu: u habit shumë nga bukuria e vajzës.

*biçak* – thikë e vogël xhepi, që futet në një këllëf druri ose plastike.

*fashë* - rrip prej pëlhure të hollë, që përdoret për të lidhur plagët.

### Pyetje rreth tekstit

1. Pse mbreti dhe mbretëresha nuk ishin të lumtur? Çka dëshironin ata?
2. Me kë ra në dashuri princi:  
me mollën apo me vajzën brenda mollës?
3. Si arriti njerka t'i bënte keq vajzës së mollës?
4. Trego me fjalët e tua mënyrën se si u prish magjia.
5. Pse autori e titullon përrallën *Princesha-mollë*?

### Plotëso

6. Cilët e shpëtuan *Princeshën-mollë*?

molla  pluhuri  magjistaria  shërbëtori  fashat

7. Si përfundon përralla:

Vashëza-mollë dhe princi u martuan dhe jetuan përgjithmonë të lumtur.

Vashëza u kthye përgjithmonë në mollë dhe princi nuk e pa më kurrë.

Njerka nuk u kthye më kurrë në pallat.

- Pra, përralla përfundon:  mirë apo  keq? Pse?

### Detyrë

- Mëso ta tregosh bukur këtë përrallë.

## ■ Rosaku i vogël i shëmtuar



Një zog i vogël i sapolindur rrinte strukur pranë nënës së tij. Gjithë zogjtë e tjerë dolën për të notuar në përrua. Nëna e detyroi më në fund rosakun të dilte jashtë. Por, kur e panë rosat e rosakët e tjerë, filluan ta shajnë:

- Iiiii, sa i shëmtuar! Ti nuk e meriton të rrish me ne. Largohu dhe shko diku tjetër!

Ngaqë ishte i shëmtuar dhe ngjyrë kafe, zogjtë e tjerë nuk donin të rrinin me të. Askush nuk e mbrojti rosakun e mjerë. Ai nuk dinte ç'të bënte dhe as ku të fshihej. I vinte turp nga vetja. Çdo ditë që kalonte, ishte dhe më e keqe për rosakun e vogël.

Më në fund vendosi të notonte përpjetë përroit. Iu mbush mendja se askush nga anëtarët e grupit nuk donte të kishte një shok të shëmtuar.

Një ditë ai arriti pranë një shtëpie ku jetonte një grua, e cila kishte një mace dhe një pulë. Më në fund dikush u bë i mirë për të dhe i hapi derën.

Një mëngjes, në oborrin e shtëpisë fluturoi një grup mjellmash të mrekullueshme. Ato e pranuan rosakun e vogël në shoqërinë e tyre. Po rosaku vazhdonte të ishte i mërzitur. Ai mendonte se ishte i shëmtuar dhe nuk e meritonte shoqërinë e tyre.

Në mëngjesin e parë të pranverës ndodhi një gjë e çuditshme. Rosaku i trishtuar shihte mjellmat e bukura dhe mendonte se ishte më mirë të vdiste sesa ta tallnin, ngaqë ishte i shëmtuar. Fluturoi drejt e në ujë dhe u drejtua nga mjellmat duke thirrur:

- Vritmëni, - dhe uli kokën. Por ç'të shihte?! Rosaku nuk arriti ta njihte veten e



tij, kur e pa të pasqyruar në ujë. Nga një shpend i dobët dhe i shëmtuar ai ishte shndërruar në një shpend të mrekullueshëm me pupla të bardha, që shkëlqenin në rrezet e diellit.

Mjellmat e tjera e rrethuan duke thirrur:

- Ua, paska ardhur një mjellmë e re! Sa e mrekullueshme qenka!

Mjellmës së re i rrodhën lot nga gëzimi. Kurrë nuk e kishte menduar se një mëngjes të bukur pranvere do të zgjohej një mjellmë e re dhe e bukur.

*Kujt i intereson se ke lindur në pulari, nëse ke dalë nga veza e mjellmës.*

Hans K. Andersen



## KUPTO TEKSTIN



### Fjalorth

*përrua* - rrjedhë uji më e vogël se lumi

*ishte shndërruar* - kishte marrë një pamje krejt të ndryshme nga e para

### Pyetje rreth tekstit

1. Pse rosaku i vogël nuk dilte të luante me rosakët e tjerë?
2. Çka i thanë atij anëtarët e grupit ?
3. Ku shkoi më pas rosaku i vogël?
4. Pse rosaku u ndje keq me mjellmat:  
sepse e shanë;  
sepse e përbuzën;  
sepse nuk ndihej mirë me veten?
5. Pse në mëngjesin e parë të pranverës shpendi u ndje i lumtur?
6. Çka kishte ndodhur?
7. Si i kupton fjalët në fund të përrallës?

- Gjej në tekst sa herë është përmendur fjala *i shëmtuar*.
- Gjej në tekst sa herë është përmendur fjala *i mrekullueshëm*.
- Gjej dhe lexo fjalitë thirrmore.
- Gjej dhe lexo dy fjalitë që tregojnë se rosakut i vjen turp nga vetja.
- Gjej dhe lexo fjalinë ku shprehet se dikush nuk e përzuri rosakun.
- Gjej dhe lexo fjalinë që tregon se veza e mjellmës ishte ngatërruar me vezët e rosave.

### Plotëso cilësitë e jashtme

<i>Rosaku i vogël</i> i shëmtuar	<i>Mjellma e rritur</i> e bukur
.....	.....
.....	.....

# Shenjat e pikësimit në dialog

Dialogu është një bisedë ndërmjet dy a më shumë njerëzve, që bëhet me pyetje dhe me përgjigje.



• Dallo shenjat e veçanta të pikësimit në dialogun e mëposhtëm:

- (vizë) Shpresa e pyeti Dianën **:** (dy pika)  
– Çfarë po bën **?** (pikëpyetje)  
– Po shkruaj një artikull për gazetën e klasës **,** (presje) – iu përgjigj Diana **.** (vizë) (pikë)  
– Sa bukur e paske shkruar **!** (pikëçuditje) – tha Shpresa, pasi e lexoi **.** (pikë) – Mos shto gjë tjetër.

Kur një bisedë, diskutim a dialog e paraqitim me shkrim, përdorim shenja të veçanta pikësimi. Këto janë **:** dhe **-**.



## USHTROHU

1. Rretho shenjat e pikësimit që përdoren vetëm në dialog.

Sa hyri në klasë, mësuesja tha:

- Sot do të zhvillojmë një diskutim interesant.
- Për çfarë do të diskutojmë? – pyeti Dritoni.
- Do të diskutojmë për jetën në fshat e në qytet, – u përgjigj mësuesja.
- Po ne nuk e njohim fshatin, – tha Elona. – Ne jemi të gjithë nga qyteti.
- S’është e vërtetë, – kundërshtoi Dritoni. – Ermali sapo ka ardhur nga fshati. Edhe prindërit e mamit tim jetojnë në fshat.
- Edhe unë nga fshati e kam babin, – tha me ndrojtje Vera.

2. Vendos ku duhet shenjat e pikësimit.

Të gjithë nxënësit po shkruanin për pushimet verore. Shpendi nuk po shkruante.

Besimi e pyeti

Pse nuk po shkruan

– Nuk di se çfarë të shkruaj, – u përgjigj Shpendi. Të lutem, ma shkruaj ti

Duke shpërndarë hartimet mësuesja tha

Hartimet i keni bërë mjaft të bukura, por më i bukuri është hartimi i Shpendit

Të lumtë, Shpendi, tha mësuesja tani do të lexoj hartimin më të dobët.

Mësuesja lexoi hartimin e Besit.

Më mërzi shumë, Besi Nuk u besojta syve për hartimin tënd tha mësuesja

Po belbëzoi Besi, kurse Shpendi u skuq dhe uli kokën

3. Shkruaj një dialog duke përdorur shenjat e pikësimit.

# Shenjat e pikësimit në fjali



## Kujto

Në fund të fjalisë vihet **pikë, pikëpyetje** ose **pikëçuditje** sipas tipit të fjalisë.

Dialogu ka shenja të veçanta pikësimi.

**Fjalja dëftore** mbaron me pikë (.).  
*Zonja Poli u plas praptas në karrige.*

**Fjalja pyetëse** mbaron me pikëpyetje (?).  
*– Poliana, çfarë do të thuash me këtë?*

**Fjalja nxitëse** mbaron me pikë (.).  
*– Mjaft me kaq, Poliana.*

**Fjalja dëshirore** mbaron me pikëçuditje (!).  
*– Rrofsh, Poliana!*

**Fjalja dëftore–thirrmore** mbaron me pikëçuditje (!).  
*– Sa e çuditshme është Poliana! – mendoj ajo.*

**Fjalja pyetëse–thirrmore** mbaron me pikëpyetje dhe pikëçuditje (?!).  
*– Cili na qenka ky djalosh i prapë?! Pastaj, ku vajte dhe e gjete?!*

**Fjalja nxitëse–thirrmore** mbaron me pikëçuditje (!).  
*– Shko tani drejt e në shtrat!*

**Fjalja dëshirore** është gjithmonë thirrmore.  
*– Të uroj gjithë të mirat e botës!*



## USHTROHU

### 1. Korigjio shenjat e pikësimit në tekstin e mëposhtëm.

– Unë qenkam lypës. Lypës s'jam, moj zonjë, Unë s'dua gjë nga ju? Kisha ndër mend të punoj? Dua të fitoj strehën?! Morët vesh.

Pastaj doli nga dhoma me një dinjitet qesharak. Sa pa vend ishte kjo krekosje.

Poliana e arriti djalin para se ky të shkonte në fund të rruginës së oborrit?

– Xhimi! Xhimi. Pse po ikën. Xhim Fasulja, sa keq më vjen për ty?

– S'është faji yt? Por lypës s'jam!

– Mos hiq dorë. Më dëgjon!

### 2. Vendos shenjat e pikësimit aty ku mungojnë.

**a** Me të mbërritur në breg, Pinoku hodhi sytë përreth, po nuk pa peshkaqen gjëkund.

– Po peshkaqeni ku na qenka – pyeti Pinoku shokët.

– Do të ketë vajtur të hajë bukë – iu përgjigj njëri duke u zgërdhirë.

Pinoku e mori vesh se shokët i kishin punuar një rreng. I hidhëruar ai u tha:

– E ç'fituat që më sollët deri këtu

– Të lamë pa shkollë. Pse mëson aq shumë

– E ç'keni ju që mësoj unë

– Sa naiv je Kështu ne dalim në dritë të keqe para mësuesit!

**b** – Oh, baba! Të gjeta më në fund Tani nuk do të të lë më kurrë, kurrë!

– Nuk më gënjekan sytë – ia priti plaku. – Ti qenke vërtet, Pinok

– Po, po, unë jam! – tha i gëzuar Pinoku

– Mirë se erdhe, biri im Po ku ke qenë për kaq kohë S'të mori

malli për mua

Pinoku filloi t'i tregonte aventurat e tij



# Vjersha

Kjo është një vjershë që ka shkruar shoku juaj për Skënderbeun.


Skënderbeu  
Marrim një **S** si skifteri i fortë.  
Marrim një **K** si krenaria jonë.  
Marrim një **Ë** si ëndrrat.  
Marrim një **N** si nata e errët.  
Marrim një **D** si dielli i nxehtë.  
Marrim një **E** si era e fortë.  
Marrim një **R** si retë në qiell.  
I shtojmë **BE** në fund  
dhe ja ku del  
madhështori **SKËNDERBE**.

Elsid Halili



## Pyetje rreth tekstit

1. Shkruaj një vjershë për **atdheun** sipas shembullit të shokut.



2. Shkruaj një vjershë për mësuesen, sipas shembullit të mësipërm.

Marrim një **M** si mjalt,  
Marrim një **Ë** si .....  
.....  
.....  
.....  
.....

### Mbaj mend

Vjersha shkruhet në vargje.  
Vargjet organizohen në strofa.  
Më shpesh strofat kanë 4 vargje.




## ■ Në panairin e librit

Atë ditë klasa e Amantias shkoi në panairin e librit. Një ditë më parë mësuesja i kishte lajmëruar që të merrnin lekë me vete, për të blerë libra. Sa shumë libra kishte atje! Secili nga fëmijët zgjodhi librin, që mendonte se ishte më i miri. Ja se çfarë pëlqejnë ata:



Mua më pëlqen shumë poezia, vargu dhe rima. Disa rima janë të forta dhe disa të lehta, disa janë të ëmbla, disa fare të qeta. Ndiqeni ritmin, kapeni kuptimin se ikën, fluturon, tashmë poezia në kokë lulëzon.

Mua më pëlqejnë përrallat me princa dhe princesha, me kështjella e fortesa, me natë në pyjet e magjepsura. Më pëlqejnë shumë historitë me aventura dhe anijet me vela, që lundrojnë nga i çon era.



Më pëlqejnë librat që flasin për mua; për ndjenjat e mia dhe çdo "Pse?" që kam. Si një prind i mirë më këshillojnë ta dua natyrën, veten edhe shokun, vendin ku jetoj.

Mua më pëlqejnë tregimet me figura, me pamje të bukura dhe fjalë të pakta. Më pëlqejnë zhurmat, kërcitjet dhe tingujt, që pikturohen me shkronja. Vetëm këta libra do të doja të lexoja!







# KUPTO TEKSTIN

## Plotëso fjalitë me emrat e fëmijëve.

..... i pëlqejnë librat me tregime nga jeta e përditshme.  
 ..... i pëlqejnë librat me poezi.  
 ..... i pëlqejnë librat me tregime fantastike.  
 ..... i pëlqejnë librat me ilustrime.

- Shkruaj llojet e librave që të pëlqejnë ty.  
 Thuaj arsyen pse të pëlqejnë këta libra.

.....  
 .....

## Plotëso vargjet me fjalët e dhura.

### Një fëmijë që lexon

.....që lexon  
 mençurohet .....,  
 sytë i shkëlqejnë  
 si dy.....

Një fëmijë.....,  
 shumë ..... do të shkojë  
 nuk ka nevojë për askënd,  
 që .....ta çojë.

A. Petrosino

shkëndija

larg

nga dija

Një fëmijë

që lexon

për dore

## Titujt e librave

- Të gjithë librat kanë një titull. Titulli fillon me shkronjë të madhe dhe me ngjyra të dukshme.



- Duke u nisur nga titujt, thuaj çfarë lloj librash janë këta.

# ■ Libri elektronik dhe enciklopedia

## BISEDOJMË

Si mund të informohemi dhe të marrim njohuri edhe pa librin letër?

Cilat mënyra përdor më shpesh?

A ke kujdes për sigurinë e faqeve ueb të internetit, prej ku i merr informacionet?

## MENDOJMË

LIBRI ELEKTRONIK – E-libri është një libër që mund ta lexoni prej aparatesh, si: kompjuteri, tableti, telefoni i mençur ose ndonjë mjet tjetër i posaçëm për lexim. Në këta libra mund të ketë vjegëza (linqe) rreth përmbajtjeve audio e video dhe komunikim me lexuesit si dhe vend për komente. Këta quhen libra digjitalë.



ENCIKLOPEDIA është një pasqyrim i shkruar njohurish të provuara e të vërtetuara, të radhitura sipas rendit alfabetik. Ka edhe enciklopedi të veçanta, tematike për një lëmë shkencor dhe enciklopedi interneti ose online.

Në kohën më të re informacionet i kërkojmë me internet, duke shënuar konceptin që kërkojmë. E provojmë në disa faqe ueb-i dhe bëjmë zgjedhjen. Mirëpo, nuk jemi të sigurt se të dhënat e secilës faqe janë të sigurta. Prandaj duhet të kërkonim ndihmën dhe lejen e prindërve.

Çdo 8 shkurt bota shënon Ditën e sigurisë së internetit. Shumë e rëndësishme është t'i dini rregullat e sjelljes në rrjete sociale kur të komunikoni dhe kur të hulumtoni e kërkonit informacione. Çdoherë kërkonit ndihmë nga prindërit dhe njoftoni ata, nëse ju paraqitet ndonjë situatë e pakëndshme gjatë komunikimit. Mos jepni të dhënat personale dhe përdoreni internetin për mësim.

# Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit

Motra dhe vëllai po përshkruajnë njëri-tjetrin. Si i kanë ndarë ata fjalët në fund të rreshtit?



- Cilat fjalë i kanë ndarë mirë fëmijët? Ngjyrosi. Po fjalët e tjera pse nuk i kanë ndarë mirë?

**Mbaj mend!** Kur nuk ka vend në fund të rreshtit, fjalën e ndajmë në dy pjesë.  
Ka disa rregulla se si ndahen fjalët në fund të rreshtit.

- Fjalët ndahen sipas rrokjeve.

Rrokja formohet nga një zanore dhe një ose disa bashkëtingëllore që shqiptohen bashkë.

**di-ta; pe-ma; li-moni** ose **limo-ni; dri-tare** ose **drita-re; trënda-fili** ose **trë-ndafili**

- Shkronjat e bashkëtingëlloreve dyshe **th, dh, sh, ll, gj** etj., nuk ndahen asnjëherë nga njëra-tjetra:

~~tha-hë ma-li pas-hë~~, por **tha-shë, ma-lli, pa-shë**

- Fjalët njërokshe nuk ndahen asnjëherë në fund të rreshtit:

~~li-s, de-t, n-ën, m-bi~~ etj.

- Në fund e në fillim të rreshtit tjetër nuk lihet asnjëherë një shkronjë e vetme, qoftë kjo edhe zanore:

~~la-u, er-ë, e-rë, shko-i, mi-u, u-në, ur-ë~~ etj.



# USHTROHU

## 1. Ndaji fjalët në rrokje, siç do t'i ndaje në fund të rreshtit.

shkumës	.....	kukull	.....
pema	.....	lisi	.....
peshku	.....	breshka	.....

## 2. Ndaji në dy mënyra fjalët në fund të rreshtit.

peshkatar	pe-shkatar	peshka-tar
përrallë	.....	.....
tekniku	.....	.....

## 3. Ndaji në tri mënyra fjalët në fund të rreshtit.

televizori	televizo-ri	televi-zori	tele-vizori
xixëllonja	.....	.....	.....
portokalli	.....	.....	.....

## 4. Shëno me ✓ fjalët e ndara mirë dhe me ✗ fjalët e ndara gabim.

<input type="checkbox"/> limo – ni	<input type="checkbox"/> shko - lla	<input type="checkbox"/> shar - ra
<input type="checkbox"/> u - ra	<input type="checkbox"/> mac - ja	<input type="checkbox"/> më - suesi
<input type="checkbox"/> pël - lumbi	<input type="checkbox"/> lo - pata	<input type="checkbox"/> sheg - a

## 5. Plotëso rrokjet që mungojnë te fjalët e mëposhtme. Në kutitë bosh vendos numrin e rrokjeve.

<input type="checkbox"/> ma - ....	<input type="checkbox"/> ba - .... - ne	<input type="checkbox"/> xi - .... - llo - ....
<input type="checkbox"/> do - .....	<input type="checkbox"/> ma - ki - .....	<input type="checkbox"/> mi - .... - ngo - .....
<input type="checkbox"/> mje - .....	<input type="checkbox"/> fla - ..... - ri	<input type="checkbox"/> te - le - .... - ni

**Detyrë.** Ndaj në fund të rreshtit fjalët: aeroplani, gorrilla, shqiponja, enciklopedia, lis.





